2. VEPRIMTARIA E BANKËS SË SHQIPËRISË

2.1. POLITIKA MONETARE

Në përputhje me ligjin "Për Bankën e Shqipërisë", objektivi kryesor i politikës sonë monetare është arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve. Në terma sasiorë, stabiliteti i çmimeve përkufizohet si mbajtja e një norme inflacioni vjetor, i matur nëpërmjet ndryshimit vjetor të Indeksit të Çmimeve të Konsumit, rreth nivelit 3% në afatin e mesëm.

Banka e Shqipërisë synon ta përmbushë këtë objektiv nëpërmjet zbatimit të regjimit të inflacionit të shënjestruar dhe regjimit të lirë të kursit të këmbimit.

Kuadri i politikës monetare, parimet për hartimin, si dhe instrumentet për zbatimin e saj, përcaktohen e shpjegohen në Dokumentin e Politikës Monetare. Në përputhje me të, Banka e Shqipërisë zbaton një politikë monetare të orientuar nga e ardhmja, konsistente, të balancuar, të kujdesshme dhe transparente.

Prej disa vitesh, Banka e Shqipërisë ka vijuar të ndjekë një politikë monetare stimuluese, në prani të vlerave nën objektiv të inflacionit, si dhe në prani të një kërkese agregate ende të pamjaftueshme për të siguruar përdorimin e plotë të kapaciteteve prodhuese, si në tregun e punës dhe në atë të kapitalit. Stimuli monetar është transmetuar nëpërmjet niveleve të ulëta të normës bazë të interesit, nëpërmjet furnizimit me likuiditet të sektorit bankar, si dhe nëpërmjet orientimit mbi kahun e pritur të politikës monetare në të ardhmen. Ky stimul ka synuar e ka arritur të krijojë kushte të favorshme financimi, të reduktojë pasiguritë e agjentëve të tregut financiar dhe luhatjet e treguesve të këtij tregu, si dhe të nxitë zgjerimin e konsumit dhe të investimeve. Nëpërmjet këtyre kanaleve, politika monetare ka ndihmuar forcimin e rritjes ekonomike të vendit dhe ka krijuar premisat e nevojshme për kthimin e inflacionit në objektiv.

2.1.1 POLITIKA MONETARE GJATË VITIT 2018

Ekonomia shqiptare pati një ecuri pozitive gjatë vitit 2018. Kërkesa agregate erdhi në zgjerim, duke mundësuar rritjen e mëtejshme të prodhimit, të punësimit e të pagave, si dhe duke ndihmuar në përmirësimin e balancave kryesore ekonomike e financiare të vendit. Paralelisht me këto zhvillime, presionet inflacioniste të gjeneruara në vend erdhën në rritje, por efekti i tyre në rritjen e inflacionit u kompensua nga forcimi i kursit të këmbimit.

Kjo dinamikë pasqyroi ruajtjen, e madje forcimin, e kahut stimulues të politikës monetare gjatë vitit 2018.

Sipas të dhënave të INSTAT-it, rritja ekonomike e nëntë muajve të parë të vitit 2018 shënoi vlerën 4.3%, duke vijuar trendin përshpejtues të vënë re gjatë tre viteve paraardhëse.[1] Rritja ekonomike pati një bazë të gjerë; ajo pasqyroi kontribute pozitive nga zgjerimi i konsumit familjar, i investimeve të biznesit dhe i eksporteve. Paralelisht me faktorët e mësipërm të kërkesës, një kontribut të ndjeshëm në rritje pati dhe rritja e shpejtë e prodhimit të energjisë elektrike.

Zgjerimi i kërkesës agregate mundësoi rritjen e punësimit dhe rënien e mëtejshme të papunësisë. Sipas informacionit të disponuar, numri i të punësuarve shënoi një rritje vjetore prej 3.5% gjatë nëntë muajve të parë të vitit, ndërsa norma e papunësisë zbriti në 12.2%. Po ashtu, të dhënat e përftuara nga vrojtimet sugjerojnë se bizneset kanë rritur shkallën e shfrytëzimit të kapaciteteve. Këto tendenca tregojnë se ekonomia shqiptare po lëviz gradualisht drejt potencialit të saj.

Rritja ekonomike ka ndihmuar në përmirësimin e përgjithshëm të ekuilibrave ekonomikë dhe financiarë të vendit. Në veçanti:

- pozicioni i jashtëm i vendit është përmirësuar, i reflektuar si në ngushtimin e deficitit të llogarisë korrente ashtu dhe në përmirësimin e treguesve të qëndrueshmërisë së borxhit të huaj. Deficiti i llogarisë korrente zbriti në një nivel mesatar prej 5.2% të PBB-së gjatë nëntë muajve të parë të vitit, kundrejt nivelit 7.5% të regjistruar një vit më parë;
- deficiti buxhetor dhe borxhi publik vijuan të shënojnë një tendencë rënëse, duke pasqyruar si kursin konsolidues të politikës fiskale ashtu dhe rritjen ekonomike dhe forcimin e kursit të këmbimit;
- treguesit kryesorë të shëndetit të sektorit bankar, e në veçanti ai i likuiditetit, i përfitueshmërisë dhe i kapitalizimit, mbetën në nivele të kënaqshme. Në veçanti, përmirësim i ndjeshëm u vu re në treguesin e kredive me probleme, i cili zbriti në nivelin 11.1% në fund të vitit.

Tendenca e përmirësimit të aktivitetit ekonomik u pasqyrua dhe në ecurinë e inflacionit, por rritja e tij drejt objektivit u frenua nga forcimi i kursit të këmbimit. Rritja e pagave dhe e kostove të prodhimit solli rritjen e inflacionit të artikujve të shportës së konsumit të prodhuar në vend. Nga ana tjetër, forcimi i kursit të këmbimit të lekut kundrejt euros solli reduktimin e inflacionit të artikujve të importit. Për rrjedhojë, inflacioni mesatar vjetor rezultoi 2.0%, duke qëndruar në të njëjtin nivel me vitin 2017.

Kursi i këmbimit të lekut shënoi një mbiçmim të shpejtë gjatë vitit 2018, pas një trendi gradual mbiçmimi të nisur nga viti 2015. Ky trend pasqyron përmirësimin e pozicionit të jashtëm të ekonomisë, reduktimin e primeve të rrezikut në tregjet

[1] *Të dhënat indirekte të disponuara, sugjerojnë se tremujori i katërt nuk do të sjellë shmangie të qenësishme në dinamikat vjetore të rritjes.*

financiare, si dhe preferencën e shtuar të agjentëve për të mbajtur dhe investuar kursimet e tyre në instrumente financiare në lekë. Ndonëse këto tendenca ishin të pranishme dhe gjatë vitit 2018, mbiçmimi i kursit në këtë periudhë u nxit, gjithashtu, nga faktorë specifikë të tregut valutor, si zhbalancimi i përkohshëm i kërkesës dhe ofertës për valutë në tremujorin e dytë dhe krijimi i pritjeve për mbiçmim të mëtejshëm të kursit.[2] Këta faktorë iniciuan një spirale të shpejtë mbiçmuese të kursit në tremujorin e dytë, dhe u shoqëruan me çrregullim të funksionimit të tregut të brendshëm valutor. Rezultatet e analizave tona sugjerojnë se forcimi i kursit gjatë vitit 2018 shkoi përtej trendit të tij afatmesëm e afatgjatë.

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë gjykoi se ritmi i shpejtë i mbiçmimit të kursit rrezikonte përmbushjen e objektivit të inflacionit në afatin e mesëm. Rrjedhimisht, në mbledhjen e datës 6 qershor 2018,[3] ai vendosi:

- reduktimin e normës bazë të interesit, nga niveli 1.25% në nivelin 1.00%. Paralelisht me të, normat e interesit të depozitës dhe kredisë njëditore u reduktuan, nga respektivisht 0.25% dhe 2.25%, në 0.1% dhe 1.9%. Ulja e normës bazë të interesit synoi reduktimin e mëtejshëm të normave të kostove të financimit në lekë dhe zbutjen e presioneve forcuese mbi kursin e këmbimit;
- fillimin e një programi të blerjes së valutës në tregun e brendshëm, me synim frenimin e ritmit të forcimit të kursit të këmbimit dhe krijimin e premisave për një aktivitet normal tregtimi në tregun e brendshëm valutor. Përdorimi i kursit të këmbimit si instrument i përkohshëm dhe i jashtëzakonshëm i politikës monetare ishte i nevojshëm, në kushtet kur hapësirat për reduktimin e mëtejshëm të normës bazë të interesit ishin të vogla.

Ndërhyrja e Bankës së Shqipërisë frenoi mbiçmimin e kursit të këmbimit dhe ndihmoi në kthimin në normalitet të tregtimit në tregun valutor. Pas përfundimit të flukseve sezonale të verës, raportet e kërkesës e ofertës për valutë u paraqitën të balancuara, edhe në mungesë të ndërhyrjes së Bankës së Shqipërisë. Po ashtu, rreziku i kursit të këmbimit në përmbushjen e objektivit erdhi në rënie.

Në përputhje me këto zhvillime, Banka e Shqipërisë ruajti të pandryshuar kahun dhe intensitetin e stimulit monetar, gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit. Norma bazë e interesit mbeti e pandryshuar në nivelin 1.0%, ndërkohë që tregu financiar u furnizua me likuiditetin e nevojshëm dhe u orientua për qëndrimin e politikës monetare në të ardhmen.

---

[2] *Për më shumë informacion, shih Hapësirën Informuese 1: "Mbiçmimi i lekut në vitin 2018: një sintezë e faktorëve, implikimeve dhe reagimit të Bankës së Shqipërisë".*

[3] *Gjatë vitit 2018 pati 8 mbledhje për vendimmarrjen e politikës monetare; në 7 prej tyre, norma bazë e interesit dhe interesat e lehtësive njëditore u mbajtën të pandryshuara.*

Grafik 1. Ecuria e normës bazë të interesit në lekë dhe injektimet e likuiditetit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

HAPËSIRË INFORMUESE 1: MBIÇMIMI I LEKUT NË VITIN 2018: FAKTORËT, IMPLIKIMET DHE REAGIMI I BANKËS SË SHQIPËRISË

Kursi i këmbimit të lekut kundrejt euros ndoqi një trend gradual mbiçmimi deri në fund të vitit 2017. Ky trend u përshpejtua ndjeshëm në vitin 2018 dhe ritmi i mbiçmimit arriti në 4.9% nga 2% në vit gjatë viteve të mëparshme.

Mbiçmimi i kursit të këmbimit në vitin 2018 u analizua gjerësisht nga Banka e Shqipërisë. Në përputhje me regjimin e lirë të kursit të këmbimit të zbatuar në vend, niveli i tij nuk është objektiv eksplicit apo implicit i Bankës së Shqipërisë. Megjithatë, shmangiet e ndjeshme dhe të zgjatura në kohë të kursit nga nivelet e diktuara nga faktorët fondamentalë, kanë implikime për ecurinë e ekonomisë dhe të inflacionit, dhe, rrjedhimisht, edhe për qëndrimin e politikës monetare. Duke u bazuar në këto konsiderata, analizat tona kanë synuar në vazhdimësi të përcaktojnë faktorët e këtij mbiçmimi dhe të vlerësojnë ndikimin e tij në ekonomi, për të informuar reagimin e Bankës së Shqipërisë.

Hapësira informuese në vijim përmbledh shkurtimisht konkluzionet e analizës sonë, të cilat janë komunikuar në vazhdimësi dhe në raportet periodike të politikës monetare.

(i) Faktorë shpjegues të mbiçmimit të kursit të këmbimit

Faktorët përcaktues të ecurisë së kursit të këmbimit studiohen me anë të modeleve dhe studimeve empirike, të cilat janë në përputhje me teorinë ekonomike dhe praktikat më të mira[I]. Këto studime mundësojnë identifikimin e trendit afatmesëm e afatgjatë të kursit të këmbimit dhe të efektit të goditjeve të ndryshme që ndikojnë mbi të.

Mbi bazën e tyre rezulton se trendi mbiçmues afatmesëm e afatgjatë i kursit të këmbimit shpjegohet nga përmirësimi i pozicionit me jashtë të ekonomisë shqiptare dhe nga rritja e interesit për të investuar në instrumente financiare në lekë[II]. Këto tendenca ilsutrohen më në detaje më poshtë.

- *Deficiti i llogarisë korrente ra nga 8.6% e PBB-së në vitin 2015, në 5.2% të PBB-së për nëntë muajt e parë të vitit 2018. Ky zhvillim ka ardhur në masën më të madhe nga rritja e eksporteve.*

- *Flukset hyrëse të investimeve të huaja direkte kanë ardhur në rritje, duke qëndruar mbi 8.0% të PBB-së. Në përgjigje të tyre, bilanci i pagesave ka rezultuar me suficit, duke nënkuptuar se flukset hyrëse të valutës në vend kanë qenë më të larta se ato dalëse.*
- *Normat e interesit për instrumentet financiare në lekë, ndonëse në nivele të ulëta, sigurojnë kthime pozitive investimesh në kushtet kur normat e interesit për depozitat në monedhën euro janë pranë zeros.*

Po ashtu, studimet tregojnë se mbiçmimi i kursit të lekut kundrejt euros gjatë vitit 2018 shkoi përtej ritmit të përmirësimit të faktorëve fondamentalë[III]. Ai pasqyroi zhvillime specifike në tregun e brendshëm valutor. Të tilla ishin:

- *konvertimi i kapitalit të disa bankave të sistemit, në reflektim të politikave të tyre të brendshme;*
- *informacioni i qarkulluar në treg për hyrjen e kredisë nga BERZH-i për KESH-in; dhe*
- *krijimi i pritjeve të njëanshme për mbiçmimin e mëtejshëm të kursit të këmbimit, çka u shoqërua me ndryshimin e sjelljes së agjentëve ekonomikë dhe rritjen e ofertës valutore në treg.*

Këta faktorë sollën rritjen e ofertës valutore dhe çrregullimin e funksionimit të tregut valutor në muajt prill e maj. Mbiçmimi i kursit të këmbimit me ritme të shpejta e largoi atë nga nivelet e sugjeruara nga faktorët fondamentalë. Zgjatja në kohë e këtij fenomeni u vlerësua të prodhonte efekte negative në inflacion në afatin e mesëm.

(ii) Reagimi i Bankës së Shqipërisë

Konstatimi se forcimi i shpejtë i kursit të këmbimit rrezikonte përmbushjen e objektivit të inflacionit, solli reagimin e politikës monetare. Ky reagim konsistoi në:

- *uljen e normës bazë të interesit në muajin qershor në 1.00%, nga 1.25%;*
- *fillimin e një programi të përkohshëm për blerje të valutës. Ky program kishte për qëllim të kontrollonte shpejtësinë e mbiçmimit të kursit të këmbimit dhe shmangien e rreziqeve ndaj përmbushjes së objektivit të inflacionit. Vendimmarrja për ndërhyrjen e Bankës së Shqipërisë në tregun valutor u bë e nevojshme në kushtet kur hapësira për uljen e normës bazë të interesit ishte e pakët.*

Ndërhyrja e Bankës së Shqipërisë ishte më intensive në periudhën e verës, periudhë e cila korrespondon me hyrje të larta valute, si pasojë e sezonit turistik. Më tej, Banka e Shqipërisë nuk ishte e pranishme në tregun valutor në kuadër të këtij programi.

(iii) Ndikimi i mbiçmimit të kursit të këmbimit në ekonominë shqiptare

Për të vlerësuar ndikimin e kursit të këmbimit në ekonominë shqiptare janë përdorur modele strukturore, të cilat e zbërthejnë ndikimin e tij sipas kanaleve të mëposhtme.

- ***Kanali i konkurrencës,*** *i cili kap ndikimin negativ që mbiçmimi përtej fondamenteve i kursit të këmbimit sjell në ecurinë e eksporteve dhe në rritjen ekonomike. Nisur nga intensiteti i lartë importues i ekonomisë shqiptare, ky ndikimi zbutet disi nga rritja e fuqisë blerëse të importuesve e konsumatorëve.*
- ***Kanali i bilancit financiar të agjentëve ekonomikë,*** *i cili kap ndikimin pozitiv që mbiçmimi i kursit të këmbimit sjell tek bilancet e huamarrësve të valutës, nëpërmjet uljes së pagesave të kësteve të huave në euro. Në një ekonomi me nivel të lartë euroizimi, ky është një kanal i rëndësishëm.*
- ***Kanali i normave të interesit,*** *i cili kap ndikimin pozitiv që mbiçmimi i kursit të këmbimit jep në reduktimin e primeve të rrezikut për kreditë në valutë,*

duke ndikuar në uljen e kostove të financimit të ekonomisë.

- ***Kanali i çmimeve,*** *i cili kap ndikimin e kursit në inflacion. Ky kanal është i dyfishtë: kursi i ndikon çmimet drejtpërdrejt, nëpërmjet shportës së mallrave të importuar, dhe jodrejtpërdrejt, nëpërmjet kërkesës agregate (kanalet e mësipërme).*

Vlerësimet për efektin e kursit të këmbimit paraqiten në grafikët më poshtë.[IV] *Ato tregojnë se ndikimi i mbiçmimit të kursit të këmbimit përtej fondamenteve në rritjen ekonomike është marxhinalisht negativ. Ky ndikim pasqyron reduktimin e konkurrencës së eksporteve shqiptare, por ai është neutralizuar pjesërisht nga rritja e fuqisë blerëse të kredimarrësve në euro dhe, pjesërisht, nga ulja e primeve të rrezikut të kredisë në monedhën euro.*

Mbiçmimi i kursit të këmbimit ka reduktuar inflacionin mesatarisht me 0.2 pikë përqindjeje në vitin 2018. Ky efekt ka ardhur në rritje gjatë tremujorëve dhe, në tremujorin e fundit, ai vlerësohet në 0.3 pikë përqindjeje. Në përputhje me kohëvonesat e përcjelljes së luhatjeve të kursit të këmbimit në çmime, ky ndikim pritet të jetë i pranishëm edhe gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2019, dhe të vijë drejt shuarjes në tremujorët në vijim.

Grafik 2. Ndikimi i mbiçmimit të kursit real të këmbimit në rritjen ekonomike (majtas) dhe në inflacion (në pikë përqindje)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Vlerësimet e këtyre efekteve pasqyrojnë, ndër të tjera, edhe masat e marra nga Banka e Shqipërisë. Rezultatet e deritanishme tregojnë se ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun valutor kanë përmbushur objektivat e këtij programi[V]*. Ritmi i mbiçmimit të kursit të këmbimit është zbutur dhe aktiviteti i tregut valutor është kthyer në parametra normalë. Po ashtu, parashikimet dhe komunikimet tona konfirmojnë se inflacioni do të kthehet në objektiv në vitin 2020.*

I *Rezultatet e disa prej studimeve të Bankës së Shqipërisë janë publikuar dhe diskutuar si materiale të dedikuara për kursin, apo edhe si pjesë e materialeve që e trajtojnë kursin e këmbimit si element integral të modelimit.*

II *Një analizë më e detajuar gjendet tek hapësira informuese "Mbiçmimi i kursit të këmbimit: faktorët përcaktues dhe implikimet", pjesë e Raportit Vjetor të Bankës së Shqipërisë për vitin 2017.*

III *Një analizë më e detajuar gjendet tek hapësira informuese "Mbi ecurinë e kursit të këmbimit gjatë gjashtëmujorit të parë 2018", pjesë e Raportit Tremujor të Politikës Monetare 2018/ III.*

IV *Një analizë më e detajuar gjendet në Hapësirën Informuese "Kursi i këmbimit dhe ndikimi në ekonomi", pjesë e Raportit Tremujor të Politikës Monetare 2019/I.*

V *Një analizë më e detajuar për ecurinë e programit të ndërhyrjeve gjendet tek Hapësira Informuese "Efektet e ndërhyrjeve në tregun valutor", pjesë e Raportit Tremujor të Politikës Monetare 2018 IV.*

Ashtu si në vitet e mëparshme, politika monetare e Bankës së Shqipërisë kontribuoi në ecurinë pozitive të ekonomisë, afrimin e saj me potencialin dhe rritjen e presioneve inflacioniste në ekonomi. Përcjellja e stimulit monetar vërehet në disa drejtime.

Së pari, politika monetare lehtësuese ka gjeneruar kushte të favorshme financimi për familjet dhe bizneset shqiptare. Normat e interesit kanë vijuar të mbeten pranë minimumeve historike, në të gjithë harkun e instrumenteve financiare në lekë. Tregjet financiare janë karakterizuar nga likuiditet i bollshëm dhe nga prime të ulëta rreziku. Injektimi mesatar i likuiditetit nga Banka e Shqipërisë ishte rreth nivelit 39 miliardë lekë, një vlerë kjo në rritje kundrejt nivelit 34 miliardë lekë të injektuar një vit më parë. Orientimi i tregut për ruajtjen e kahut lehtësues të politikës monetare në të ardhmen, ka ndihmuar në sheshimin e kurbës së normave të interesit dhe ka shtrirë efektin e saj në një horizont më të gjatë kohor. Po ashtu, zbatimi i programit të masave për reduktimin e kredive me probleme ka ndihmuar në uljen e rrezikut të kreditit.

Së bashku, këto instrumente kanë diktuar reduktimin e normave të interesit të kredisë, të bonove 12-mujore të thesarit dhe të depozitave në lekë, përkatësisht me 1.5, 1.2 dhe 0.5 pikë përqindjeje nga viti 2015.

Grafik 3. Ecuria e normave të interesit në lekë dhe kursi i këmbimit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Së dyti, politika monetare lehtësuese ka sjellë rritjen e financimit në lekë dhe uljen e kostos së shërbimit të borxhit ekzistues. Përmirësimet e vazhdueshme në kushtet e financimit u pasqyruan jo vetëm në rënien e normave të interesit, por edhe në rritjen e vëllimit të portofolit të kredisë për sektorin privat. Kështu, kredia në lekë u rrit mesatarisht me 6.7% gjatë vitit 2018, ndërkohë që pesha e këtij portofoli ndaj kredisë totale u rrit 47.2%, ose 2.5 pikë përqindje më shumë se një vit më parë.

Reduktimi i normave të interesit ul koston e financimit me kredi bankare dhe koston e shërbimit të kredive ekzistuese, duke krijuar kështu një kursim financiar që ndihmon rritjen e konsumit dhe të investimeve.

Grafik 4. Ecuria e kredisë në vite (sipas monedhave, indeks) dhe sipas klientëve (ndryshim vjetor, %)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Së treti, politika monetare lehtësuese ka mbështetur stabilitetin financiar të vendit. Normat e ulëta të interesit dhe kushtet e favorshme të financimit kanë ndihmuar në përmirësimin e pozicionit financiar të huamarrësve, duke ulur kostot e shërbimit të borxhit dhe inkurajuar ristrukturimin e kredive ekzistuese. Orientimi i kredidhënies drejt monedhës vendase ka rritur peshën e saj në kredinë totale dhe ka ulur ekspozimin e sistemit financiar ndaj rreziqeve nga luhatjet e kursit të këmbimit.

Masat e politikës monetare të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë kanë kontribuuar në rritjen e konsumit të familjeve dhe të investimeve të biznesit, duke mbështetur kështu rritjen ekonomike. Vlerësimet tona sugjerojnë se politika monetare lehtësuese ka kontribuuar pozitivisht, mesatarisht me 0.5 pikë përqindje, në rritjen ekonomike të dy viteve të fundit.

Nëpërmjet nxitjes së kërkesës agregate, politika monetare lehtësuese ka kontribuuar në rritjen e punësimit dhe në shfrytëzimin më të mirë të kapaciteteve prodhuese. Paralelisht me to, pritjet e agjentëve ekonomikë për inflacionin kanë ardhur në rritje në krahasim me një vit më parë. Në përgjigje të tyre, pagat dhe inflacioni bazë kanë shfaqur një prirje të lehtë rritëse, duke krijuar premisa për kthimin e inflacionit në objektiv në afatin e mesëm.

Banka e Shqipërisë do të vijojë të ndjekë një politikë monetare të kujdesshme, në përputhje me objektivin e saj të stabilitetit të çmimeve dhe në interes të mbështetjes së stabilitetit të përgjithshëm ekonomik e financiar të vendit. Paralelisht me të, Banka e Shqipërisë gjykon se vendi duhet të vazhdojë të ecë

përpara me axhendën e reformave strukturore. Këto reforma duhet të synojnë përshpejtimin e ritmit të rritjes ekonomike, si dhe rritjen e qëndrueshmërisë dhe shpërndarjen e fryteve të saj në shtresa sa më të gjera shoqërore.

HAPËSIRË INFORMUESE 2: VENDIMMARRJA E POLITIKËS MONETARE

Gjatë vitit 2018, Këshilli Mbikëqyrës ka marrë në shqyrtim dhe ka rivlerësuar përshtatshmërinë e qëndrimit të politikës monetare në tetë raste. Në kuadër të këtyre diskutimeve, ai ka miratuar 8 raporte të politikës monetare (4 tremujore dhe 4 të ndërmjetme), si dhe një set analizash periodike.

*Vendimet e politikës monetare bazohen në një kuadër bashkëkohor analize e parashikimi, i cili mundëson formulimin e një politike monetare konsistente me përmbushjen e objektivit të inflacionit. Ky kuadër ushqehet me të gjithë gamën e informacionit të disponuar, si dhe mbështetet në modele të testuara ekonometrike dhe në praktikat më të mira të bankingut qendror.**

Gjatë vitit 2018 ka vazhduar puna për:

- ***Përmirësimin e përditësimin e modeleve të parashikimit dhe analizës** së politikës monetare, aplikimin e teknikave bashkëkohore në fushën e modelimit, si dhe përditësimin e njohurive të stafit me të rejat më të fundit. Puna në këtë drejtim është mbështetur nga asistenca teknike e FMN-së, Sekretariatit të Shtetit Zviceran për Çështje Ekonomike (SECO) dhe Institutit të Gjenevës;*
- ***Hulumtimin e vazhduar të mekanizmit të transmetimit të politikës monetare dhe efektivitetit të saj.** Një fokus të veçantë në punët studimore të vitit 2018 pati mbiçmimi i kursit të këmbimit. Objektivi i studimeve tona ka qenë gjetja e arsyeve që qëndrojnë pas forcimit të kursit të këmbimit, vlerësimi i ndikimit të pritur të këtij forcimi, si dhe identifikimi i reagimit të Bankës së Shqipërisë, në përputhje me mandatin tonë ligjor. Paralelisht me të, u studiuan faktorët strukturorë e ciklikë të ecurisë së inflacionit, si dhe ka vijuar monitorimi i zhvillimeve në sistemin bankar, për të vlerësuar fortësinë e mekanizmit të transmetimit të politikës monetare dhe identifikuar efektet e masave të politikës monetare në këta tregues;*
- ***Komunikimin intensiv të politikës monetare** për të rritur kuptueshmërinë, parashikueshmërinë dhe efektivitetin e saj. Banka e Shqipërisë ka vijuar të përdorë komunikimin e kursit të politikës monetare në të ardhmen, si instrument të politikës monetare. Ai ka synuar të reduktojë pasigurinë në treg, nëpërmjet informimit të publikut mbi periudhën e parashikuar për arritjen e objektivit dhe kahun e ardhshëm të politikës monetare. Po ashtu, gjatë vitit 2018, komunikimi i politikës monetare është intensifikuar për të shpjeguar pozicionin e Bankës së Shqipërisë kundrejt zhvillimeve në kursin e këmbimit. Për këtë qëllim janë shfrytëzuar jo vetëm deklaratat e politikës monetare, por edhe intervista dhe artikuj në media. Për informimin e publikut të gjerë, në raportet periodike janë përgatitur dhe hapësira specifike informuese.*
- ***Bashkëpunimin me partnerët e brendshëm dhe të huaj,** duke synuar rritjen e sinergjisë së politikave ekonomike brenda vendit dhe duke mbështetur procesin e integrimit evropian. Miksi aktual i politikave, i karakterizuar nga stimuli monetar dhe konsolidimi fiskal, vazhdon të mbetet një kombinim i përshtatshëm. Ky miks adreson nevojat e nxitjes së kërkesës agregate dhe përmirëson shëndetin e financave publike. Banka*

e Shqipërisë ka vazhduar dialogun me Fondin Monetar Ndërkombëtar në kuadër të Artikullit IV dhe me partnerët tanë evropianë në drejtim të: (i) njohjes dhe implementimit të direktivave përkatëse në fushën e politikës monetare; dhe (ii) të përmbushjes së raportimeve periodike në procesin e integrimit.

Për vitin në vazhdim, prioritetet e punës janë rritja e efektivitetit, fleksibilitetit dhe transparencës së politikës monetare, duke garantuar përshtatshmërinë e saj në një mjedis ekonomik e financiar dinamik e kompleks.

* *Për më shumë informacion shih:*
Hapësirë informuese 1: "Proceset mbështetëse të vendimmarrjes së politikës monetare në Bankën e Shqipërisë", Raporti Vjetor 2015;
Hapësirë informuese 2: "Procesi i hartimit, zbatimit dhe komunikimit të politikës monetare", Raporti Vjetor 2016.

2.1.2 INFLACIONI DHE FAKTORËT PËRCAKTUES TË TIJ

Presionet e brendshme inflacioniste shënuan rritje gjatë vitit 2018. Përmirësimi i pozicionit ciklik, i shprehur në rritjen e kërkesës agregate dhe në shfrytëzimin më të mirë të kapaciteteve prodhuese, ka mundësuar rritjen e pagave dhe të kostove të prodhimit. Nga ana tjetër, forcimi i kursit të këmbimit solli reduktimin e inflacionit të artikujve të importuar të konsumit, duke kompensuar efektin e përmirësimit të pozicionit ciklik të ekonomisë.

Inflacioni vjetor rezultoi rreth një vlere mesatare prej 2.0% në vitin 2018, duke mbetur në një nivel pothuajse të njëjtë me atë të vitit paraardhës. Në terma të profilit kohor, inflacioni: shënoi vlerën mesatare 1.9% në tremujorin e parë; u rrit në 2.2% në tremujorin e dytë dhe të tretë; dhe, zbriti në nivelin 1.8% në tremujorin e fundit.

Në këndvështrimin makroekonomik, ecuria e inflacionit pasqyroi veprimin me kah të kundërt të dy faktorëve: përmirësimin e pozicionit ciklik të ekonomisë shqiptare dhe mbiçmimin e shpejtë të kursit të këmbimit. Faktori i parë, përmirësimi i pozicionit ciklik të vendit – apo, me fjalë të tjera, rritja e shkallës së shfrytëzimit të kapaciteteve prodhuese – është shoqëruar me rritje të punësimit e të pagave, çka ka sjellë rritjen e kostove të prodhimit dhe të çmimeve të artikujve të prodhuar në vend. Nga ana tjetër, forcimi i kursit të këmbimit, gjatë vitit 2018, ka frenuar rritjen e çmimit të artikujve të importit, duke kompensuar efektin e faktorit të brendshëm. Efekte të tjera janë gjeneruar nga faktorë kalimtarë, duke përfshirë luhatjet e çmimit të naftës dhe të inflacionit të ushqimeve.

Grafik 5. Inflacioni vjetor dhe objektivi (majtas). Inflacioni në vendet e rajonit dhe në BE (djathtas)



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Kontribuuesit kryesorë në formimin e inflacionit total mbeten artikujt ushqimorë. Ecuria e çmimeve të konsumit gjatë vitit 2018 pasqyroi, në një masë të madhe, ndikimin e kategorisë "Ushqime të papërpunuara". Inflacioni i artikujve të kësaj kategorie shënoi rënie krahasuar me vitin paraardhës, kryesisht si pasojë e rritjes së ofertës vendase, por ai vijoi të mbetet gjeneruesi kryesor i inflacionit. Kategoria "Ushqime të përpunuara" regjistroi rënie të çmimeve gjatë vitit, duke manifestuar një ecuri krejtësisht të ndryshme krahasuar me një vit më parë. Çmimet në këtë kategori u ndikuan nga mbiçmimi i lekut dhe rënia e çmimeve në tregjet ndërkombëtare, e në veçanti e atyre të drithërave.

Kategoritë e tjera kanë rritur kontributet e tyre në inflacionin total. Kategoritë "Strehim-qira", "Mallra me çmime të rregulluara" dhe "Mallra të konsumit joushqimor" formuan rreth 40% të inflacionit total, krahasuar me 20% një vit më parë. Çmimi i qirasë ka ruajtur një prirje rritëse gjatë vitit 2018, prirje kjo e nisur nga fundi i vitit 2017. Maksimumi i kontributit të kategorisë "Strehim-qira" u arrit në muajin tetor, me 0.5 pikë përqindje. Kategoria e artikujve me "Çmime të rregulluara" pati kontribut pozitiv në inflacionin total (0.2 pikë përqindje), si pasojë e rritjes së çmimit të ujit. Çmimet e naftës pësuan luhatje të ndjeshme gjatë vitit, duke kaluar nga rritjet gjatë muajve të verës në trajektoren rënëse në fundin e vitit. Kjo ecuri ka pasqyruar rënien e çmimeve të naftës në tregjet e huaja.

*Tabelë 1. Kontributi i kategorive kryesore në inflacionin vjetor (në pikë përqindje)**

	T1-17	T2-17	T3-17	T4-17	T1-18	T2-18	T3-18	T4- 18
Ushqime të përpunuara	0.6	0.5	0.2	0.0	0.1	0.2	0.2	0.1
Bukë dhe drithëra	0.1	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	-0.1
Alkool dhe duhan	0.1	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1
Ushqime të papërpunuara	1.3	1.1	1.2	1.3	0.9	1.1	1.0	0.9
Fruta	0.3	0.3	0.5	0.6	0.6	0.1	0.0	-0.1
Perime	0.9	0.7	0.7	0.6	0.2	0.9	0.9	0.9
Shërbime	0.2	0.2	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
Mallra me çmime të rregullluara	0.0	0.0	0.0	0.0	0.2	0.2	0.2	0.2
Furnizim me ujë	0.0	0.0	0.0	0.0	0.2	0.2	0.2	0.2
Strehim (qira)	0.0	0.1	0.1	0.2	0.3	0.4	0.4	0.3
Mallra konsumi joushqimor	0.3	0.2	0.2	0.2	0.3	0.3	0.3	0.2
Karburant	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.2	0.2
Mallra konsumi afatgjatë	0.0	-0.1	-0.1	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Inflacioni vjetor (%)	2.4	2.0	1.7	1.8	1.9	2.2	2.2	1.8

Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.
**Në tabelë janë paraqitur disa nga grupet kryesore të kategorive.*

Përmirësimi i pozicionit ciklik të ekonomisë solli forcimin e presioneve të brendshme inflacioniste.

Zgjerimi i kërkesës agregate, gjatë vitit 2018, solli përmirësimin e pozicionit ciklik të vendit, të vërejtur në ngushtimin e hendekut negativ të prodhimit. Tregu i punës u karakterizua nga rritja e punësimit dhe nga rënia e vazhduar e shkallës së papunësisë, çka u pasqyrua më tej në rritje të pagave në ekonomi. Po ashtu, shkalla e shfrytëzimit të kapaciteteve ka ndjekur një prirje të ngadaltë rritëse, ndonëse vijon të mbetet nën mesataren historike të saj.

Grafik 6. Tregues të gjendjes ciklike të ekonomisë*



Burimi: INSTAT dhe vlerësime të Bankës së Shqipërisë.
*Hendeku i prodhimit është mesatare e disa matjeve mbi të cilën është aplikuar metoda e mesatares lëvizëse. Hendeku i normës së shfrytëzimit të kapaciteteve është llogaritur si devijim i vlerës aktuale nga mesatarja përkatëse historike për secilin prej sektorëve të Vrojtimit të Besimit të Biznesit. Më pas, hendeqet e sektorëve janë peshuar me peshat e tyre si në treguesin e ndjesisë ekonomike, dhe së fundmi është zbatuar metoda e mesatares lëvizëse me katër terma. Në grafik paraqitet hendeku i rezultuar për sektorin prodhues. Sektorët e shërbimeve janë përjashtuar, për shkak të pranisë së luhatjeve të shumta afatshkurtra.

Në pasqyrim të tyre, presionet e brendshme inflacioniste rezultuan në rritje gjatë vitit 2018. Inflacioni bazë dhe inflacioni neto i artikujve të patregtueshëm shënuan përkatësisht 0.9% dhe 1.4% në terma mesatarë vjetorë. Për rrjedhojë, kontributi i inflacionit të brendshëm erdhi në rritje, nga 0.9 pikë përqindje gjatë gjysmës së parë të vitit, në 1.3 pikë përqindje në të dytën.

Forcimi i kursit të këmbimit reduktoi inflacionin e importuar.

Mbiçmimi i kursit të këmbimit gjatë vitit 2018 pengoi përcjelljen e plotë të përmirësimit të pozicionit ciklik të vendit në inflacion. Mbiçmimi me 8.1% i kursit nominal efektiv të këmbimit (KNEK) solli reduktimin e presioneve të huaja inflacioniste, ndonëse treguesi i "Çmimeve të huaja" u rrit me 7.4%, gjatë vitit në analizë.

Grafik 7. TPHI dhe kontributet e përbërësve të tij (majtas); kontributi i inflacionit të importuar dhe të brendshëm (djathtas)



Burimi: INSTAT dhe llogaritje të BSh.

Si rezultat, treguesi i presioneve të huaja inflacioniste (TPHI)[4] ra me 0.7% në terma mesatarë vjetorë. Kjo ecuri u materializua në reduktimin e kontributit të inflacionit të importuar, nga 1.1 pikë përqindje në gjashtëmujorin e parë, në 0.7 pikë përqindje në të dytin.

2.1.3 ECURIA E AKTIVITETIT EKONOMIK

Ekonomia shqiptare shënoi rritje gjatë vitit 2018, në pasqyrim të zgjerimit të konsumit, investimeve private dhe eksporteve. Rritja ekonomike u materializua në rritje të shpejtë të sektorit të industrisë dhe të shërbimeve, ndërkohë që sektorët e tjerë të ekonomisë shënuan një zgjerim më të ngadaltë.

Zgjerimi i kërkesës së brendshme krijoi premisa për rritje të punësimit dhe rënie të normës së papunësisë, duke sugjeruar se ekonomia shqiptare po lëviz gradualisht drejt potencialit. Po ashtu, rritja ekonomike u shoqërua me reduktimin e deficitit të llogarisë korrente dhe ndihmoi në reduktimin e borxhit publik.

Sipas të dhënave të INSTAT-it, rritja ekonomike e nëntë muajve të parë të vitit shënoi vlerën 4.3%, duke u përshpejtuar krahasuar me rritjen e regjistruar gjatë vitit paraardhës.[5] Të dhënat e disponuara sugjerojnë se rritja ka vijuar të jetë e pranishme edhe në tremujorin e katërt.

---

4 *TPHI-ja llogaritet si rritja vjetore e indeksit të çmimeve të huaja dhe indeksit NEER për muajin përkatës.*

5 *Informacioni i publikuar nga INSTAT-i për Produktin e Brendshëm Bruto, sipas metodës së prodhimit dhe të shpenzimeve, mbulon zhvillimet deri në tremujorin e tretë të vitit 2018, të publikuar në datën 28 dhjetor 2018. Sipas kalendarit të botimeve të INSTAT-it, të dhënat për Produktin e Brendshëm Bruto në tremujorin e katërt të vitit 2018 do të publikohen më 29 mars 2019.*

Zgjerimi i PBB-së reflektoi kryesisht ecurinë pozitive të sektorit prodhues, i cili kontribuoi me 2.6 pikë përqindje në rritje. Zhvillimet në sektorin prodhues pasqyruan rritjen e aktivitetit në industri, të përkthyer në një kontribut prej rreth 2.2 pikësh përqindje në rritjen vjetore të PBB-së. Aktiviteti në industri u drejtua kryesisht nga rritja e prodhimit të energjisë elektrike. Ndërkohë, sektori bujqësor kontribuoi me rreth 0.3 pikë përqindje në rritjen ekonomike, ndërsa kontributi i sektorit të ndërtimit u pakësua në 0.2 pikë përqindje.[6]

Grafik 8. Rritja vjetore e PBB-së reale (në %) dhe kontributet e komponentëve të vlerësuar nga ana e prodhimit (në pikë përqindje). Tendenca e vlerës së shtuar reale bruto në ekonomi dhe në sektorë



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.
*Të dhënat janë gjysmë përfundimtare. ** Një vlerësim i parë.
Shënim: Indekset e vlerës së shtuar reale bruto për ekonominë dhe sektorët e saj janë llogaritur si shumë lëvizëse e vlerave tremujore për katër tremujorë dhe janë bazuar në tremujorin e katërt të vitit 2010.

Sektori i shërbimeve[7] kontribuoi me 1.4 pikë përqindje në rritjen e PBB-së. E ndikuar kryesisht nga rritja e turizmit, dega e "Tregtisë, transportit, akomodimit dhe shërbimit ushqimor" dha kontributin më të lartë, prej rreth 0.8 pikë përqindjeje, në rritjen vjetore të PBB-së. Po ashtu, dega e "Aktiviteteve profesionale dhe shërbimeve administrative" shtoi në 0.4 pikë përqindje ndikimin e saj në rritjen ekonomike, ndërkohë që kontributet e aktiviteteve të tjera të shërbimeve llogariten të ulëta.

Kërkesa e brendshme ka qenë kontribuuesi kryesor i rritjes ekonomike gjatë tre tremujorëve të parë të vitit 2018, e mbështetur nga rritja e konsumit dhe e investimeve private.

Kërkesa e brendshme u zgjerua me 3.1% gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2018.[8] Ndikimi kryesor ka buruar nga konsumi i popullatës, por kontribut

[6] *Kjo dinamikë u ndikua në një masë edhe nga krahasimi me një bazë më të lartë një vit më parë, kur sektori i ndërtimit shënoi edhe rritjen më të lartë vjetore, rreth 9.6%, për periudhën 2010–2017.*

[7] *Degët kryesore të shërbimeve janë: "Tregti, transport, akomodim dhe shërbim ushqimor", "Informacion dhe komunikacion", "Aktivitete financiare dhe të sigurimit", "Aktivitete të pasurive të paluajtshme", "Aktivitete profesionale dhe shërbime administrative", "Administrata publike, arsimi dhe shëndetësia", "Arte, argëtim dhe çlodhje dhe aktivitete të tjera shërbimi".*

[8] *Kërkesa e brendshme përbëhet nga konsumi final dhe formimi bruto i kapitalit fiks. Në terma të llogarive kombëtare, konsumi privat në këtë raport i referohet konsumit final të popullatës, ndërsa investimet janë ekuivalente me formimin bruto të kapitalit fiks.*

pozitiv ka ardhur edhe nga rritja e investimeve private. Ndërkohë, shpenzimet publike kanë ardhur në rënie gjatë vitit, si në terma të shpenzimeve korrente dhe në terma të shpenzimeve kapitale.

Grafik 9. Ecuria e kërkesës së brendshme, kontributet nga komponentët formues dhe treguesi i ndjesisë ekonomike (TNE)



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Konsumi privat ishte kontribuuesi kryesor i rritjes gjatë vitit 2018.

Konsumi privat u rrit me 3.4% gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2018. Kjo përbën normën më të lartë të rritjes së tij që pas vitit 2008. Rritja e konsumit u mbështet nga rritja e punësimit dhe e pagave, nga politika monetare stimuluese, si dhe nga kushtet e lehtësuara të kreditimit. Treguesit e tërthortë sugjerojnë se, gjatë vitit 2018, konsumi privat u rrit kryesisht në kategoritë e mallrave të konsumit të përditshëm dhe më pak në kategorinë e mallrave të konsumit afatgjatë dhe shërbimeve.[9]

Grafik 10. Ecuria e konsumit privat (majtas); treguesi i besimit konsumator dhe shkalla e punësimit (djathtas)



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

[9] *Bazuar në treguesit e dezagreguar të indeksit të tregtisë me pakicë dhe PBB-së nga ana e prodhimit.*

Rritja e investimeve vijoi gjatë vitit 2018, ndonëse shfaqi norma më të ulëta rritjeje.

Investimet u rritën me 4.2% gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2018, në krahasim me rritjen prej 6.5% gjatë vitit 2017. Sipas vlerësimeve tona, ndikimi kryesor në rritje erdhi nga zgjerimi i investimeve të sektorit privat, ndërkohë që kontributi i investimeve publike ishte ndjeshëm më i ulët. Të dhëna indirekte tregojnë se investimet private u zgjeruan në dy kategoritë kryesore përbërëse: investime në ndërtim dhe investime në makineri dhe pajisje të reja.[10] Rritja e investimeve pasqyroi rritjen e shkallës së shfrytëzimit të kapaciteteve, si dhe u ndihmua nga kushtet e favorshme të financimit.

Grafik 11. Ecuria e investimeve në ekonomi (majtas); importi i makinerive e pajisjeve dhe norma e shfrytëzimit të kapaciteteve (djathtas)



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Grafik 12. Natyra e politikës fiskale*



*Për detajet metodologjike, referojuni hapësirës informuese "Politika fiskale dhe ciklet e biznesit" në raportin vjetor të Bankës së Shqipërisë për vitin 2017.

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, INSTAT dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

Politika fiskale pati një prirje konsoliduese gjatë vitit 2018.

Politika fiskale shfaqi një prirje konsoliduese gjatë vitit 2018, ndonëse plani buxhetor parashikonte një qëndrim thuajse neutral të saj gjatë vitit. Kështu, suficiti primar rezultoi rreth 0.6 pikë përqindjeje të PBB-së më i lartë se ai i një viti më parë. Ndonëse prociklik, konsolidimi fiskal është pasqyruar në reduktimin e borxhit publik dhe ka zgjeruar hapësirat fiskale për përballimin e goditjeve të mundshme në të ardhmen.

Deficiti buxhetor për vitin 2018 rezultoi rreth 26.5 miliardë lekë, duke u vlerësuar në rreth 1.6% të PBB-së. Në ngjashmëri me tre vitet e mëparshme, financimi i deficitit u mbizotërua nga burimet e huaja. Instrumenti kryesor i financimit të huaj, gjatë vitit 2018, ka qenë emetimi i Eurobondit 7-vjeçar,

[10] *Bazuar në treguesit e importit sipas zërave, si dhe në matjen e PBB-së nga ana e prodhimit.*

në shumën 500 milionë euro. Ky instrument, në përputhje dhe me skedulin e rishikuar të huamarrjes së qeverisë për vitin 2018, u përdor pjesërisht për reduktimin e borxhit të huaj ekzistues (për rreth 200 milionë euro) dhe të atij të brendshëm (për rreth 10 miliardë lekë)[11]. Huamarrja në tregun e brendshëm u shtua vetëm me instrumente borxhi afatgjatë, emetimi i të cilave kompensoi në të njëjtën kohë reduktimin e atyre afatshkurtra.

Grafik 13. Deficiti buxhetor dhe financimi (majtas); dhe borxhi publik (djathtas), ndaj PBB-së



Burimi: INSTAT, MFE dhe llogaritje të stafit të BSH-së.

Sipas të dhënave të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, stoku i **borxhit publik** vlerësohet të jetë reduktuar në 67.1% të PBB-së në vitin 2018, nga 70.1% në vitin 2017.[12] Rënia e borxhit i detyrohet natyrës konsoliduese të politikës fiskale, mbiçmimit të monedhës vendase, si dhe vijimit të rritjes ekonomike.

Shpenzimet buxhetore për vitin 2018 ishin rreth 475.9 miliardë lekë, ose rreth 3.1% më të larta në terma vjetorë. Profili i rritjes së shpenzimeve u përcaktua nga shpenzimet kapitale, ato për sigurime sociale, si edhe pagesat e interesave mbi borxhin e marrë në vitet e mëparshme. Në kah të kundërt me to ndikoi mungesa e transfertave të ndryshme gjatë vitit 2018.[13] Madhësia e sektorit publik, e shprehur si raport i shpenzimeve publike ndaj PBB-së, u vlerësua në rreth 29.1%, raporti më i ulët i regjistruar në pesë vitet e fundit. Në terma të kompozimit, struktura e shpenzimeve buxhetore shënoi përmirësim

[11] *Në fillim të vitit, qeveria kishte planifikuar që huamarrja e brendshme përgjatë vitit të shtohej me rreth 30 miliardë lekë, e ajo e huaj të pakësohej me 9 miliardë lekë. Megjithatë, nisur nga kushtet e favorshme në tregjet ndërkombëtare, nëpërmjet një akti normativ, plani për huamarrjen e huaj u rishikua në 32.6 miliardë lekë, nëpërmjet emetimit të Eurobondit 7-vjeçar, e ai për huamarrjen e brendshme u reduktua në 20 miliardë lekë.*

[12] *Të dhënat për borxhin publik i përkasin publikimit të MoFE për tremujorin e katërt 2018.*

[13] *Në vitin 2017, këto transferta ishin në formën e huadhënies për KESH-in. Gjatë vitit 2018 nuk pati transaksione të kësaj natyre.*

gjatë vitit 2018, duke rritur peshën relative të shpenzimeve për investime ndaj shpenzimeve totale.

Të ardhurat buxhetore për vitin 2018 ishin rreth 449.4 miliardë lekë, ose rreth 4.4% më të larta nga një vit më parë. Të ardhurat tatimore u vlerësuan në rreth 25.6% të PBB-së, nivel ky i ngjashëm me një vit më parë. Politika tatimore ka qenë pothuajse e njëjtë me atë të një viti më parë. Për këtë arsye, profili i rritjes së të ardhurave tatimore gjatë vitit 2018, ka reflektuar gjallërim të konsumit privat, aktivitet ekonomik të shtuar, si edhe dinamikën e përmirësuar të treguesve të tregut të punës. Nga ana tjetër, rritja e të ardhurave tatimore gjatë këtij viti u frenua nga mbiçmimi i kursit të këmbimit.

Grafik 14. Të ardhurat dhe shpenzimet



Burimi: INSTAT, MFE dhe llogaritje të stafit të BSH-së.

HAPËSIRË INFORMUESE 3: FAKTORËT PËRCAKTUES TË DINAMIKËS SË BORXHIT PUBLIK NË SHQIPËRI

Kjo hapësirë informuese ka si qëllim të paraqesë faktorët makroekonomikë e fiskalë që kanë përcaktuar dinamikën në kohë të borxhit publik.[1] Analiza mbështetet në përqasjen e ndjekur nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (2013), për vlerësimin e qëndrueshmërisë së borxhit publik për vendet që kanë akses në tregjet ndërkombëtare. Pjesë e këtij aparati analizues të propozuar nga FMN-ja është edhe shqyrtimi i dinamikës së borxhit publik në kohë, të dekompozuar sipas faktorëve që e përcaktojnë atë: balancës primare, rritjes reale ekonomike, normës reale të interesit, kursit real të këmbimit, balancës primare, flukseve të tjera borxhkrijuese dhe një komponenti rezidual.

Sipas të dhënave të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, borxhi publik në Shqipëri ka njohur rritje në vitet që pasuan krizën globale, duke kulmuar në nivelin 72.7% të PBB-së në vitin 2015. Pas kësaj periudhe, borxhi është pozicionuar në një trajektore rënëse, duke zbritur në 67.1% të PBB-së në fundin e vitit 2018. Më në detaje:

- *raporti i borxhit publik ndaj PBB-së u rrit me 19.1 pikë përqindje në periudhën 2008-2015 (Grafiku 15). Pjesa më e madhe e rritjes i detyrohet normave reale të interesit të paguara mbi borxhin dhe deficiteve primare që karakterizuan politikën fiskale gjatë kësaj periudhe. Nga ana tjetër, rritja ekonomike ka vepruar në kah të kundërt, duke sjellë uljen e raportit të borxhit publik ndaj PBB-së;*
- *Raporti i borxhit publik ndaj PBB-së ra me rreth 5.6 pikë përqindje në periudhën 2016–2018. Rënia e tij ka vijuar të mbështetet nga ritmet e rritjes ekonomike, por ajo është favorizuar dhe nga mbiçmimi i kursit të këmbimit dhe konsolidimi fiskal, i shprehur në suficite primare, i ndërmarrë gjatë kësaj periudhe.*

Grafik 15. Ndryshimi i borxhit publik, dekompozuar sipas faktorëve përcaktues, 2007 – 2018



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, INSTAT dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

Dekompozimi i dinamikës së borxhit publik vë në pah rëndësinë që ka rritja ekonomike në përmirësimin e trajektores së borxhit. Sikundër ilustrohet në Grafikun 16, aftësia e ekonomisë për të përmirësuar shëndetin e financave publike varet nga pozicioni i saj në ciklin e biznesit. Në periudha bumi ekonomik, kur prodhimi është mbi potencialin e tij (siç është rasti i viteve 2007 e 2008), rritja reale ekonomike ndikon në masë më të lartë rënien e raportit të borxhit publik. Në të kundërt, kur hendeku i prodhimit është negativ e drejt zgjerimit, kontributi i rritjes ekonomike në reduktimin e borxhit është më i ulët. Ndikimi i cikleve të biznesit në dinamikën e borxhit publik, nënvizon se ndjekja sistematike e politikave fiskale kundërciklike ndihmon kontrollin e borxhit dhe krijon hapësira fiskale për përballimin e goditjeve të mundshme në të ardhmen.

Grafik 16. Kontributi i rritjes reale ekonomike në dinamikën e borxhit publik, si edhe hendeku i prodhimit në ekonomi*



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, INSTAT dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

*Hendeku i prodhimit është mesatare e disa matjeve mbi të cilën është aplikuar metoda e mesatares lëvizëse. Për vitin 2018, vlerësimi i takon tremujorit të tretë të këtij viti.

Përtej nivelit, rëndësi të veçantë në analizën e qëndrueshmërisë së borxhit publik mbart dhe profili i strukturës së financimit të tij. Dimensionet kryesore të kësaj strukture janë: (i) maturiteti; (ii) monedha; dhe, (iii) zotëruesit. Një strukturë optimale financimi duhet të minimizojë koston e përgjithshme të borxhit publik, duke mbajtur njëkohësisht nën kontroll rreziqet që vijnë nga dimensionet e mësipërme.

Sa i takon strukturës së financimit të borxhit në Shqipëri mund të konkludojmë si më poshtë:

- *maturiteti i borxhit publik është zgjatur gjatë viteve të fundit, duke reduktuar rrezikun e rifinancimit të tij. (Grafiku 17, majtas). Ky objektiv është arritur nëpërmjet emetimit të Eurobondeve (5-vjeçar në vitin 2015, dhe 7-vjeçar në vitin 2018) dhe nëpërmjet rritjes së peshës së instrumenteve afatgjata në tregun e brendshëm;*
- *struktura e borxhit sipas monedhës tregon një rritje të peshës së borxhit në monedhë të huaj, duke rritur ekspozimin e tij ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit. Në vitin 2018, borxhi i huaj zë rreth 49% të borxhit totalit, ose 32.8% të PBB-së (Grafiku 17, djathtas).*
- *Struktura e borxhit sipas zotëruesve tregon një bazë më të diversifikuar investitorësh (Grafiku 18). Masat për të nxitur zhvillimin e tregut primar dhe sekondar të letrave me vlerë të qeverisë - zgjerimi i gamës së instrumenteve të borxhit, apo rregullimet ligjore që nxisin pjesëmarrjen e individëve dhe institucioneve të tjera - ka ulur ekspozimin e qeverisë ndaj sistemit bankar, nga rreth 68% e borxhit të brendshëm në vitin 2008, në 58% në vitin 2018.*

Grafik 17. Profili i borxhit publik, 2010 - 2018



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, INSTAT dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

Grafik 18. Zotëruesit e borxhit të brendshëm*



*Struktura e borxhit të brendshëm krahas operacioneve të letrave me vlerë në treg primar, përfshin edhe transaksionet në treg sekondar.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

Pavarësisht tendencave pozitive, përmirësimi i mëtejshëm i qëndrueshmërisë së borxhit publik kërkon dhe vëmendje të mëtejshme ndaj përmirësimit të strukturës së financimit të tij.

[1] *Mbështetet në materialin studimor "Qëndrueshmëria fiskale dhe vlerësimi i vulnerabiliteteve fiskale në Shqipëri", Jahaj (Gazidede), A. dhe Metani, I. (2016), i papublikuar.*

Deficiti i llogarisë korrente ka shfaqur një tendencë ngushtimi gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2018.

Deficiti i llogarisë korrente zbriti në nivelin 5.2% të PBB-së gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2018, duke u reduktuar ndjeshëm ndaj nivelit 7.5% të shënuar gjatë vitit paraardhës. Në terma nominalë, deficiti shënoi një ngushtim vjetor prej rreth 11.3%.

Ky reduktim pasqyron kryesisht rritjen me 8% të remitancave neto, si dhe zgjerimin me rreth 3.0% të suficitit të bilancit të tregtisë në shërbime, ku përfshihen dhe të ardhurat nga turizmi. Nga ana tjetër, deficiti i tregtisë së mallrave është ngushtuar me vetëm 0.2% në terma vjetorë, gjatë tre tremujorëve të parë të vitit. Rritja e eksporteve me rreth 25.7%, në një masë të madhe e shtyrë nga rritja e eksportit të energjisë elektrike, është kompensuar nga rritja me rreth 5.8% e importeve.

Deficiti i përgjithshëm tregtar (në mallra dhe shërbime) u ngushtua me 1.9% për 9-mujorin e parë të vitit 2018, kryesisht si pasojë e përmirësimit të bilancit të shkëmbimeve të shërbimeve. Ky ngushtim pasqyron përmirësimin e hendekut kursime-investime, veçanërisht si pasojë e rritjes së kursimeve të sektorit publik. Paralelisht me të, edhe hendeku kursime-investime i sektorit privat është ngushtuar, megjithëse në këtë rast ky ngushtim pasqyron rritjen më të shpejtë të kursimeve në raport me investimet e këtij sektori.

Grafik 19. Struktura e eksporteve (majtas) dhe importeve (djathtas) për mallrat në vitin 2018



Burimi: INSTAT.

Me gjithë rritjen e vëllimit të përgjithshëm, struktura e eksporteve shqiptare mbetet relativisht pak e diversifikuar, sidomos në drejtim të produkteve me vlerë të shtuar të lartë. Nga ana tjetër, struktura e importeve është më e larmishme.

Vendet e Bashkimit Evropian, dhe kryesisht Italia, mbeten partnerët tanë kryesorë tregtarë. Gjatë vitit 2018, është vënë re një rritje relative e peshave të disa vendeve ku eksportohet kryesisht lëndë djegëse dhe energji elektrike, si Zvicra dhe Spanja. Paralelisht, është vënë re një rritje e përpjesës së Kosovës, kryesisht si pasojë e eksporteve më të larta të kategorisë "Materiale ndërtimi dhe metale" drejt këtij destinacioni. Sa i përket vendeve të origjinës, Italia mbetet partneri kryesor dhe me një larmi të gjerë produktesh të importuara.

Grafik 20. Struktura e destinacioneve eksportuese (majtas) dhe origjinave importuese (djathtas) për mallrat në vitin 2018 (% ndaj totalit)



Burimi: INSTAT.

Financimi i deficitit të llogarisë korrente mbështetet në flukse valutore joborxhkrijuese.

Flukset e Investimeve të Huaja Direkte kanë luajtur rolin kryesor në financimin e deficitit korrent. Flukset hyrëse të IHD-ve janë zgjeruar me rreth 11.6% gjatë nëntë muajve të parë të vitit, me burim kryesor investimet në sektorin energjetik. Si rrjedhojë, sektori energjetik renditet i pari në terma të stokut të përgjithshëm të Investimeve të Huaja Direkte, me rreth 26.9% të totalit, në fund të 9-mujorit të parë 2018. Po ashtu, si pasojë e këtyre zhvillimeve, Zvicra është ngjitur në vendin e dytë sa i përket vendeve të origjinës.

Flukset e larta hyrëse kanë gjeneruar edhe norma të larta të financimit të deficitit korrent. Si rrjedhojë, në fund të vitit 2018, stoku i mjeteve të rezervës valutore arriti në nivelin 3.4 miliardë euro. Ky nivel është i mjaftueshëm për të mbuluar 7.2 muaj importi mallrash e shërbimesh ose 170% të borxhit të jashtëm afatshkurtër.

Grafik 21. Struktura sektoriale (majtas) dhe sipas origjinave importuese për stokun e Investimeve të Huaja Direkte në vitin 2018 (% ndaj totalit)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Treguesit e qëndrueshmërisë së borxhit të jashtëm kanë vazhduar të përmirësohen gjatë vitit 2018.

Stoku i borxhit të huaj ka shënuar vlerën 8.04 miliardë euro në tremujorin e tretë 2018, me një zgjerim prej 2.7% krahasuar me një vit më parë. Stoku vlerësohet në nivelin 64.5% ndaj PBB-së nominale të vjetorizuar. Nga pikëpamja strukturore mbizotëron borxhi qeveritar me rreth 43.8% të totalit, pasuar nga borxhi i bankave tregtare (17.6%) dhe ai i lidhur me investimet direkte (16.7%). Në terma të maturitetit, mbizotëron borxhi afatgjatë me rreth 79.6%. Për sa i përket instrumenteve, huatë dhe investimet në monedha dhe depozita përbëjnë rreth 71.7%. Pesha e investimeve të portofolit mbetet mjaft e ulët.

Në terma të qëndrueshmërisë, është vënë re një përmirësim i treguesve të aftësisë ripaguese afatgjatë, gjatë vitit 2018. Raporti i stokut të borxhit ndaj eksportit të mallrave dhe shërbimeve ka rezultuar 161.3%, në tremujorin e tretë të vitit 2018. Ndërkohë një vit më parë, ky raport ishte 174.0%. Në të njëjtën kohë, raporti i stokut të borxhit ndaj të ardhurave fiskale shënoi 237.5% krahasuar me 246.3% një vit më parë.

2.1.4 TREGU I PUNËS

Rritja e kërkesës agregate dhe zgjerimi i prodhimit janë shoqëruar me rritje të punësimit. Punësimi u rrit mesatarisht me 3.5%, gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2018.[14] Kjo rritje është më e lartë se rritja me 2.9% e shënuar në të njëjtën periudhë një vit më parë. Ecuria e punësimit në ekonomi pasqyroi rritjen e numrit të të punësuarve si në sektorin prodhues, ashtu edhe në atë të shërbimeve. Rritja e punësimit është shoqëruar me rënien e vazhduar të shkallës së papunësisë, e cila qëndroi në 12.2%, në tremujorin e tretë të vitit 2018. Kjo normë rezulton

[14] *Analiza e punësimit dhe e papunësisë mbështetet në të dhënat e Anketës tremujore të Forcave të Punës për grup-moshën 15 vjeç e lart.*

rreth 1.4 pikë përqindje më poshtë vlerës së shënuar të njëjtin tremujor një vit më parë. Së fundi, rënia e normës së papunësisë ka krijuar premisa për rritjen me 3% të pagës mesatare gjatë tre tremujorëve të parë të vitit 2018.

Tabelë 2. Tregues të tregut të punës (në %)

	2014	2015	2016	2017	2018		
					T1	T2	T3
Punësimi (15 vjeç e lart, ndryshime vjetore)	1.6	4.9	6.5	3.3	4.9	3.3	2.3
- Në bujqësi	-3.4	1.4	3.9	-2.0	1.2	1.2	1.2
- Në industri (përfshirë ndërtimin)	7.4	11.5	11.0	3.4	8.6	7.1	3.9
- Në shërbime	5.1	6.2	7.8	8.4	6.7	3.4	2.5
Shkalla e punësimit (15–64 vjeç)	50.5	52.9	55.9	57.4	59.2	59.2	59.7
Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës (15–64 vjeç)	61.5	64.2	66.2	66.8	68.0	68.0	68.3
Shkalla e papunësisë (15 vjeç e lart)	17.5	17.1	15.2	13.8	12.5	12.4	12.2
Paga mesatare mujore për një të punësuar (ndryshime vjetore nominale)		5.2	-0.8	3.0	4.2	2.5	2.4
Paga mesatare mujore në sektorin shtetëror (ndryshime vjetore nominale)	1.7	1.8	0.9	9.8	5.7	0.2	-0.3

Burimi: INSTAT (Anketa e Forcave të Punës, të dhëna të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve) dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.
Shënim: Vlerat e paraqitura janë mesatare të ndryshimeve vjetore apo vlerave të treguesve për katër tremujorët e viteve përkatëse.
** Ndryshimet vjetore të pagave në terma realë janë llogaritur duke mbajtur parasysh inflacionin vjetor.*

2.1.5 TREGJET FINANCIARE DHE TREGUESIT MONETARË

Tregjet financiare kanë qenë përgjithësisht të qeta gjatë vitit 2018, të karakterizuara nga norma të ulëta interesi dhe prime në rënie rreziku. Përjashtim nga kjo tablo bën ecuria e tregut valutor. Në gjysmën e parë të vitit, ky treg u karakterizua nga goditje, të cilat dëmtuan parametrat e funksionimit të tij dhe sollën presione të forta mbiçmuese mbi kursin e këmbimit. Reagimi i Bankës së Shqipërisë nëpërmjet reduktimit të normës bazë të interesit dhe ndërhyrjeve të përkohshme në tregun valutor, qetësoi funksionimin dhe frenoi ritmin e mbiçmimit të kursit të këmbimit.

Kredia për sektorin privat ka vijuar të rritet me ritme të moderuara gjatë vitit 2018. Kjo ecuri ka pasqyruar si kërkesën ende të ulët për kredi, ashtu edhe politikat konservatore të kreditimit të zbatuara nga sektori bankar. Në terma të strukturës, kreditimi shfaq ritme më të shpejta rritjeje në segmentin e kredisë në lekë, si dhe në atë të kreditimit të familjeve e individëve.

Nga këndvështrimi i pasivit, instrumentet e kursimit dhe investimit vijojnë të karakterizohen nga tendenca e zhvendosjes drejt ekstremeve të spektrit të likuiditetit: afateve të shkurtra apo të gjata të maturimit.

Normat e interesit në tregun ndërbankar janë luhatur pranë normës bazë, në linjë me objektivin operacional të politikës monetare.
Banka e Shqipërisë ka vijuar t'u ofrojë likuiditet bankave me anë të instrumentit të saj kryesor, repos së anasjellë njëjavore. Likuiditeti i injektuar ka qenë lehtësisht më i lartë se vitin e kaluar, si pasojë e rritjes së kërkesës për financim

nga sektori bankar. Normat e interesit në tregun ndërbankar kanë qëndruar afër normës bazë dhe kanë shfaqur luhatje më të ulëta, ndërkohë që vëllimet e tregtimit kanë mbetur të njëjta me nivelet e vitit 2017.

Grafik 22. Ecuria e tregut ndërbankar (majtas) dhe tregut primar (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Yield-et e letrave me vlerë të qeverisë janë ulur gjatë vitit 2018.

Yield-et e letrave të borxhit të qeverisë kanë shfaqur ecuri rënëse, të ndikuara si nga lehtësimi i politikës monetare ashtu dhe nga reduktimi i huamarrjes në tregun e brendshëm. Pasi regjistruan ulje marxhinale në muajt e parë të vitit, rënia e *yield*-eve u përshpejtua në tremujorët në vazhdim. Pas emetimit të Eurobondit në muajin tetor, kërkesa për financim e qeverisë në tregun e brendshëm është zvogëluar, duke përforcuar prirjen rënëse të *yield*-eve. *Yield*-i 12-mujor rezultoi mesatarisht 2.0% gjatë vitit, nga 2.4% që shënoi një vit më parë. Gjatë vitit 2018, filloi implementimi i projektit pilot për emetimin e obligacionit referencë me maturitet 5-vjeçar, nëpërmjet bankave zhvilluese të

Grafik 23. Ecuria e normave të interesit në lekë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

tregut. Tregtimi dhe kuotimi i përditshëm i këtij obligacioni ka ndikuar në uljen e primeve në maturitetet afatgjata dhe zbutjen e diferencave midis *yield*-eve të këtyre maturiteteve. Kurba e *yield*-eve në fund të vitit paraqitet me pjerrësi të zbutur, kryesisht në spektrin afatmesëm dhe afatgjatë.

HAPËSIRË INFORMUESE 4: RISITË NË TREGUN FINANCIAR GJATË VITIT 2018

Sistemi financiar në Shqipëri mbizotërohet nga sektori bankar, ndërkohë që institucionet financiare jobanka kanë një peshë modeste, ndonëse me një tendencë rritjeje në pesë vitet e fundit[1]. Spektri i instrumenteve të kursimit në ekonominë shqiptare është i kufizuar, ndërsa plotësimi i nevojave për financim të bizneseve realizohet kryesisht nga bankat.

Gjatë vitit 2018, tregu financiar në Shqipëri njohu progres në disa aspekte.

- ***Volumi i tregtuar në tregun sekondar të titujve të qeverisë ka shënuar rritje*** *(shih Grafikun 24, majtas). Prej muajit korrik 2018, në kuadër të nismës së përbashkët të qeverisë dhe Bankës së Shqipërisë për të zhvilluar tregjet financiare, ka filluar të emetohet obligacioni 5-vjeçar referencë. Ky obligacion kuotohet në vazhdimësi, duke rritur likuiditetin e këtij instrumenti, si dhe duke krijuar një normë referencë për interesat e letrave të borxhit qeveritar dhe për interesat e produkteve të tjera të tregut financiar. Kjo praktikë synohet të ndiqet edhe me maturitete të tjera, në mënyrë që të shtohen pikat referencë përgjatë kurbës së yield-eve.*

- ***Kreditimi nga institucionet jobanka ka njohur rritje në dy vitet e fundit****, si në drejtim të portofolit të kredisë (shih Grafikun 24, djathtas) ashtu edhe të numrit të kredimarrësve. Të dhënat financiare të këtyre institucioneve tregojnë se portofoli i kredisë është rritur me 4.3 miliardë lekë në vitin 2018, ose 18% krahasuar me një vit më parë. (Megjithatë, portofoli i kredisë së këtyre institucioneve përbën rreth 6% të totalit të financimit të bankave për sektorin privat, duke treguar peshën e vogël të tyre në financimin e bizneseve.)*

Grafik 24. Zhvillimet në tregun sekondar të letrave me vlerë dhe në institucionet jobanka (mld lekë)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

- ***Në muajin shkurt 2018 nisi aktivitetin Bursa Shqiptare e Titujve ALSE sh.a.****, me qëllim krijimin e një platforme elektronike tregtimi që të bëjë të mundur përputhjen e ofertës dhe kërkesës për letra me vlerë në Shqipëri. Kjo platformë elektronike synon të plotësojë mungesën e tregut të organizuar (bursës), ku biznesi vendas mund të mbledhë fonde, si një alternativë e financimit nga sektori bankar. Në vitin e parë të saj, kjo platformë është përdorur për tregtimin e letrave me vlerë të qeverisë.*

- ***Një zhvillim pozitiv në tregun e kapitaleve është emetimi i obligacioneve nga biznesi privat.*** *Këto emetime, si praktikë, kanë filluar që në vitin 2012, por kanë pasur kryesisht emetues institucione financiare (banka, fonde). Në vitin 2018, është kryer për herë të parë emetimi i obligacionit nga një biznes, në formën e një oferte private. Zgjerimi i numrit të kompanive që përdorin këto instrumente rrit likuiditetin në këtë treg. Kjo do të sjellë zhvillimin e tregut të kapitaleve edhe përdorimin e tij si mundësi investimi dhe rritje të kapitalit nga bizneset.*

[1] *Për më shumë referoju https:/www.bankofalbania.org/Stabiliteti_Financiar/Raportet_e_stabilitetit_financiar/.*

Normat e interesit të kredive dhe depozitave në lekë kanë mbetur në nivele të ulëta.

Norma mesatare e interesit për kreditë e reja në lekë rezultoi 7.0% gjatë vitit 2018, duke mbetur pranë niveleve mesatare të vitit paraardhës (7.1%). Normat e interesit të kredisë për individët janë ulur gjatë vitit 2018, ndërsa normat e interesit të kredisë për biznese janë shfaqur afërsisht të njëjta me një vit më parë. Reduktimi i interesave të kredisë për individë është vërejtur kryesisht tek ato të financimit për blerjen e banesave[15]. Normat e interesit të depozitave luhaten në nivele minimale, duke ruajtur të ulëta kostot e financimit të bankave.

Leku është mbiçmuar gjatë vitit 2018.

Tregu valutor është karakterizuar nga një mbiçmim i fortë i lekut gjatë vitit 2018. Pas një trendi gradual mbiçmimi gjatë viteve 2016 e 2017, kursi i këmbimit të lekut kundrejt euros u mbiçmua me rreth 4.9% gjatë këtij viti. Forcimi i lekut kulmoi në tremujorin e dytë të vitit, në reflektim të goditjeve që pësoi tregu valutor në këtë periudhë (për më shumë informacion, shiko Hapësirën Informuese 1).

Ndërhyrja e Bankës së Shqipërisë në tregun valutor frenoi ritmin e shpejtë të mbiçmimit të kursit të këmbimit dhe riktheu aktivitetin e tregut valutor brenda parametrave normalë. Kjo ndërhyrje ishte e përqendruar kryesisht në tremujorin e tretë, i cili karakterizohet nga flukse të shtuara valutore, si pasojë e sezonit turistik. Në muajt në vazhdim, kursi i këmbimit të lekut ka vazhduar të mbiçmohet, por me ritme të moderuara, në linjë me sjelljen sezonale të tij. Kërkesa dhe oferta për valutë ishin më të balancuara dhe luhatjet ditore të kursit të këmbimit

[15] *Norma mesatare e interesit për individë për vitin 2018 zbriti në 7%, nga 7.3% në 2017. Interesi i kredisë për blerje banese rezultoi 3.7% këtë vit, nga 4.1% një vit më parë.*

Grafik 25. Zhvillimet në kursin e këmbimit*



*Në grafikun e ndryshimeve vjetore, vlera negative tregon mbiçmim të kursit të lekut ndaj monedhave të huaja.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

ishin të dyanshme. Mbiçmimi i lekut është vënë re edhe ndaj dollarit amerikan. Një dollar amerikan u këmbye mesatarisht me 108 lekë, ose 9.3% më pak se një vit më parë.

Aktiviteti kreditues shfaqet lehtësisht i përmirësuar, i mbështetur nga rritja e qëndrueshme e kredisë në monedhë vendase.

Kredia për sektorin privat shënoi një rritje mesatare vjetore prej rreth 2%, duke arritur në nivelin 35.2% të PBB-së.[16] Ritmi i rritjes së kredisë vijon të mbetet i moderuar, i ndikuar nga kërkesa ende e dobët për kredi e sektorit privat, nga politikat konservatore të kreditimit të bankave, si dhe nga efekti kontabël i mbiçmimit të kursit të këmbimit. Duke përjashtuar këtë efekt të fundit, norma mesatare vjetore e zgjerimit të kredisë për sektorin privat është luhatur rreth vlerës 5%.[17]

Kursi stimulues i politikës monetare ka vijuar të ruajë norma të ulëta interesi dhe kushte të favorshme kreditimi. Portofoli i kredisë në lekë vazhdoi të japë kontributin më të lartë në zgjerimin e kredisë për sektorin privat. Norma mesatare vjetore e rritjes së këtij portofoli shënoi 6.6%. Kredia në lekë është e kanalizuar kryesisht në segmentin e individëve. Ky portofol është rritur me ritme të qëndrueshme gjatë vitit, duke shënuar një normë mesatare vjetore prej 8%. Zgjerimi i kredisë për individë është mbështetur si nga rritja e kredisë hipotekare, ashtu edhe nga rritja e kredisë për konsum. Kërkesa e qëndrueshme dhe kushtet e lehtësuara të kreditimit në segmentin e individëve mbeten faktorë me ndikim pozitiv në rritjen e këtij portofoli.

[16] *Të dhënat e kredisë janë të rregulluara për kreditë e nxjerra jashtë bilancit të bankave.*
[17] *Të dhënat e kredisë të raportuara në vijim janë gjithashtu të rregulluara për këtë efekt.*

Grafik 26. Ecuria e kredisë për sektorin privat (ndryshime vjetore në %)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kredia në valutë shfaq një dinamikë në përmirësim, duke shënuar një rritje vjetore mesatare prej 4%. Zgjerimi i kredisë në valutë mbështet kryesisht financimin e bizneseve. Ky portofol ka shënuar rritje mesatare vjetore rreth vlerës 4%, duke shfaqur qëndrueshmëri më të madhe në segmentin e kredisë për investime dhe ecuri të luhatshme në atë të kredisë për likuiditete. Kredia për biznese vijon të reflektojë kërkesë ende jo të qëndrueshme dhe kushte relativisht të shtrënguara të ofertës bankare për këtë segment.

HAPËSIRË INFORMUESE 5: ECURIA E FAKTORËVE TË OFERTËS DHE KËRKESËS PËR KREDI

Ecuria e kredisë është objekt i analizave të vazhdueshme të Bankës së Shqipërisë, për vetë rolin e saj në mekanizmin e transmetimit të politikës monetare, në rritjen ekonomike dhe në inflacion.

Gjatë dy viteve të fundit, vihet re një përmirësim i moderuar i aktivitetit kreditues, ndonëse ritmi i rritjes së kredisë nuk ka pasqyruar plotësisht rritjen e aktivitetit ekonomik dhe uljen e primeve të rrezikut në tregjet financiare. Studimet empirike[i] sugjerojnë se rimëkëmbja e aktivitetit kreditues është e ngadaltë dhe rikuperimi i tij zgjat më shumë në kohë, dhe në veçanti pas krizave financiare që kanë origjinuar nga rritja e shpejtë e kredisë.

Në këtë hapësirë informuese pasqyrojmë ecurinë e faktorëve të ofertës dhe kërkesës që kanë ndikuar aktivitetin kreditues në Shqipëri, në vitet 2017 - 2018.

Për të gjykuar mbi ecurinë e ofertës dhe të kërkesës për kredi gjatë kësaj periudhe, kemi përditësuar modelin empirik të studimit mbi përcaktuesit e kreditimit në vendet e rajonit[ii]. Duke u bazuar në marrëdhënien e gjetur ndërmjet faktorëve të kërkesës dhe ofertës me kredinë, është llogaritur ndikimi relativ i këtyre faktorëve në rritjen reale të kredisë. Grafiku 27 pasqyron ecurinë e përmbledhur të faktorëve të kërkesës dhe ofertës në tre periudha kohore: periudha e parë, ajo menjëherë pas krizës, i referohet viteve 2009-2012; periudha e dytë mbulon vitet 2013-2016; dhe periudha e tretë është ajo me të dhënat më të fundit për vitet 2017-2018.

Grafik 27. Ndikimi i faktorëve të kërkesë ofertës në rritjen e kredisë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Rezultatet e modelit tregojnë se faktorët e kërkesës dhe të ofertës kanë ardhur në përmirësim gjatë dy viteve të fundit. Megjithatë, kërkesa për kredi ka një përmirësim relativ mjaft më të shpejtë se oferta për kredi.

- *Përmirësimi i kërkesës është mbështetur nga rimëkëmbja e aktivitetit ekonomik në vend, i cili ka shfaqur përshpejtim të normave të rritjes, duke dhënë kontribut pozitiv në ecurinë e kredisë.*
- *Nga ana tjetër, përmirësimi marxhinal i ofertës ka reflektuar ndikimin pozitiv që ka dhënë ulja e raportit të kredive me probleme ndaj totalit, si përafrues i rrezikut të kredisë.*

Nga analiza e rezultateve të këtij ushtrimi vihet re se rikuperimi i faktorëve të kërkesës për kredi është më i shpejtë se ai i faktorëve të ofertës. Kjo ecuri konfirmohet edhe nga rezultatet e vrojtimit të aktivitetit kreditues pranë bankave. Bankat shprehen se kanë shtrënguar standardet për kredinë e bizneseve dhe kanë lehtësuar ato për individët, ndërkohë që kërkesa për kredi është në rritje në të dy segmentet për periudhën 2017-2018.

Sipas bankave, faktorët që ndikojnë në shtrëngimin e standardeve të bizneseve janë perceptimi i rrezikut për këtë segment, kufizimet nga bilanci dhe toleranca e bankës ndaj rrezikut.[III] Një panoramë e ndryshme vihet re tek ecuria e standardeve të kreditimit për individët. Të dhënat e Vrojtimit të Aktivitetit Kredites tregojnë se që prej vitit 2012, bankat kanë lehtësuar në mënyrë të vazhdueshme standardet e kreditimit. Bankat pohojnë se pothuajse të gjithë faktorët kanë ndikuar pozitivisht në lehtësimin e standardeve për individët.

[I] *Si për shembull Antoshin S. et al. 2017: "Credit Growth and Economic Recovery in Europe After the Global Financial Crisis"- IMF Working paper WP/17/256.*

[II] *Ky model është i vlerësuar për periudhat 2004-2016 dhe shpjegon rritjen e kredisë për sektorin privat, nëpërmjet faktorëve të kërkesës (rritjes ekonomike, shkallës së ndërmjetësimit të sistemit bankar) dhe faktorëve të ofertës (raportit të kredive me probleme, depozitave, huamarrjes së huaj të bankave, normës së interesit të kredisë) dhe kursit të këmbimit. Modeli përshkruhet në materialin studimor "Vlerësimi i përcaktuesve të kredisë bankare në vendet e Evropës Qendrore dhe Juglindore" përgatitur nga S. Note dhe E. Suljoti – material studimor, Banka e Shqipërisë 2017.*

[III] *Ky faktor është prezantuar për herë të parë në qershor të vitit 2018, në kuadër të rishikimit që iu bë Vrojtimit të Aktivitetit Kredites. Për më shumë shiko: https:www.bankofalbania.org/Politika_Monetare/Vrojtimet/Vrojtimi_i_aktivitetit_kredites/*

Oferta monetare është zgjeruar me ritme të moderuara gjatë vitit, duke reflektuar financimin e ulët me mjete monetare të ekonomisë, si dhe ndryshimet strukturore në mbajtjen e parasë.

Ecuria e parasë së gjerë, gjatë vitit 2018, reflektoi nivelin e ulët të krijimit të parasë në ekonomi, ndryshimet strukturore si pasojë e zhvendosjes së depozitave të agjentëve ekonomikë në maturitete mbi dy vjet[18], si dhe efektin e mbiçmimit të kursit të këmbimit. Treguesi i parasë së gjerë, agregati M3, shënoi një reduktim mesatar vjetor prej 0.4%, gjatë vitit 2018. Ndryshimet strukturore të parasë reflektojnë jo vetëm zhvendosjet drejt maturiteteve afatgjata, por edhe drejt komponentit likuid, në trajtën e depozitave pa afat dhe parasë jashtë bankave. Raporti i kësaj të fundit ndaj treguesit të parasë në lekë, agregatit M2, ka rezultuar në nivelin mesatar prej rreth 36.3% gjatë vitit, ose 1.6 pikë përqindje më e lartë se një vit më parë.

Stoku i depozitave në sistemin bankar është zgjeruar me rreth 1.1% mesatarisht në terma vjetorë, gjatë vitit. Në fund të periudhës, depozitat totale të rezidentëve vlerësohen në nivelin 68.4% të PBB-së. Kontributin më të madh në rritjen e depozitave e kanë dhënë depozitat në valutë, të mbështetura nga flukset e larta valutore gjatë vitit. Depozitat në lekë kanë kontribuuar në një masë më të ulët, pasi një pjesë e kursimeve në monedhë vendase kanalizohet në letra me vlerë të qeverisë. Njëkohësisht me të, ka vijuar zhvendosja nga depozita me afat maturimi nën dy vjet, drejt depozitave pa afat dhe atyre me afat mbi dy vjet. Këto kategori përbëjnë përkatësisht 44% dhe 12% të stokut total të depozitave. Ecuria sipas agjentëve ekonomikë konfirmon rritje si të depozitave të individëve, ashtu edhe të depozitave të biznesit.

Grafik 28. Përbërësit e ofertës monetare dhe depozitat në sistemin bankar



Treguesit përfaqësojnë mesataren vjetore të balancave neto të tremujorëve.
Burimi: Vrojtimi i aktivitetit kreditues - Banka e Shqipërisë.

[18] *Bazuar në Metodologjinë e Hartimit të Statistikave Monetare, treguesi i parasë së gjerë përfshin paranë jashtë bankave dhe depozitat (në të gjitha monedhat) me maturitet deri në dy vjet.*

Tabelë 3. Tregues kryesorë makroekonomikë dhe financiarë

	2014	2015	2016	2017	2018*
Inflacioni (mesatar)					
Inflacioni total (në %)	1.6	1.9	1.3	2.0	2.0
Inflacioni bazë (në %)	0.1	-0.2	0.2	0.8	0.9
Rritja ekonomike					
Rritja reale e PBB-së (vjetore në %)	1.8	2.2	3.4	3.9	4.3
PBB/Frymë (në euro)	3,443	3,556	4,043		
Tregu i punës[1]					
Shkalla e pjesëmarrjes në forcën e punës (15-64 vjeç)	61.5	64.2	66.2	66.6	68.1
Norma e papunësisë (15-64 vjeç)	17.5	17.1	15.2	13.9	12.4
Sektori fiskal					
Balanca buxhetore (me grantet, % të PBB-së)	-5.2	-4.1	-1.8	-2.0	-1.6
Të ardhurat buxhetore (në % të PBB-së)	26.3	26.4	27.6	27.7	27.4
Shpenzimet buxhetore (në % të PBB-së)	31.5	30.5	29.4	29.7	29.0
Borxhi publik (në % të PBB-së)**	70.0	72.7	72.2	70.0	67.2
Sektori i jashtëm					
Llogaria korrente (përjashtuar transfertat zyrtare, në % të PBB-së)	-10.9	-8.7	-8.0	-8.1	-5.7
Importet në mallra (fob, në % të PBB-së)	31.6	29.9	30.9	31.3	29.4
Eksportet në mallra (fob, në % të PBB-së)	9.3	7.5	6.7	6.9	7.7
Investimet e huaja direkte (% PBB-së)	8.7	8.7	8.8	7.7	8.0
Mjetet e rezervës valutore (milionë euro, fund periudhe)	2,192	2,880	2,945	2,996	3,399
Sektori monetar e financiar					
Norma e repo-s (fund periudhe)	2.25	1.75	1.25	1.25	1.00
Agregati M3 (rritje vjetore, fund periudhe)	4.0	1.8	3.9	0.3	-0.2
Kredia për sektorin privat (rritje vjetore, fund periudhe)[2]	2.0	2.4	3.1	3.3	2.0
Depozita/PBB-së[3]	73.0	72.6	74.1	71.3	69.0
Kredi/PBB-së[3]	37.1	37.0	37.1	36.4	35.2
Yield-i 12-mujor (mesatar)	3.4	3.3	1.8	2.4	2.0
Kursi i këmbimit, lek/usd (mesatar)	105.5	126	126.0	119.1	108.0
Kursi i këmbimit, lek/euro (mesatar)	140.0	139.7	136.1	134.2	127.6
Kursi nominal efektiv, NEER	112.1	113.8	110.2	105.2	96.8
Sektori bankar					
Raporti i kredive me probleme/kredi total (%)	22.8	18.2	18.2	13.2	11.1

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë.
**Të dhënat për rritjen ekonomike, për tregun e punës dhe për sektorin e jashtëm, i përkasin 9-mujorit të parë të vitit 2018.*
***Buletini i MFE, tremujori i katërt 2018. [1]/ "Rezultate të Anketës së Forcave të Punës", publikim i INSTAT. [2]/ Të dhënat janë të rregulluara për kreditë e nxjerra jashtë bilancit. [3]/ Vlerësim i PBB-së për vitin 2018.*

2.2. OPERACIONET MONETARE

Operacionet e tregut të hapur përdoren për administrimin afatshkurtër dhe afatgjatë të likuiditetit në tregun e parasë, me qëllim kryesor përmbushjen e objektivit operacional të Bankës së Shqipërisë. Ky objektiv përkufizohet në Dokumentin e Politikës Monetare dhe synon orientimin e normave afatshkurtra të interesit të tregut ndërbankar pranë normës bazë të interesit të Bankës së Shqipërisë dhe minimizimin e luhatjeve të tyre.

Gjatë vitit 2018, normat e interesit në tregun ndërbankar kanë qëndruar pranë normës bazë të interesit dhe kanë shfaqur luhatshmëri të ulët. Normat e interesit njëditore dhe njëjavore të tregtuara në tregun ndërbankar rezultuan mesatarisht 0.02 pikë përqindje më lart se norma bazë e interesit. Në dallim me vitet e kaluara, presionet për shmangien në kahun e sipërm të objektivit të normave të interesit ishin më të larta, si pasojë e rritjes së mungesës së likuiditetit në sistemin bankar. Kjo mungesë arriti vlerën maksimale prej 50 miliardë lekësh gjatë tremujorit të dytë, dhe u luhat në intervalin 28-46 miliardë lekë në tremujorin e tretë dhe të katërt të vitit, duke qenë prezente në një numër më të madh bankash. Po ashtu, përqendrimi i likuiditetit të tepërt në 1-2 banka të sistemit, megjithëse më pak i dallueshëm se në vitet e kaluara, ka ulur presionet për tregtim nën normën bazë të interesit.

Karakteristikë tjetër e vitit 2018 ka qenë tendenca për rritjen relative të huadhënies së kolateralizuar kundrejt asaj të pakolateralizuar. Tregtimet në tregun ndërbankar me afat më të gjatë se një javë kanë qenë mjaft të rralla edhe gjatë këtij viti.

Në përgjigje të nevojës së sistemit bankar për likuiditet, Banka e Shqipërisë ka rritur likuiditetin mesatar të injektuar nëpërmjet operacioneve në tregun e hapur në rreth 39 miliardë lekë në vitin 2018, nga 24-34 miliardë lekë dy vitet e kaluara. Rritjes së mungesës së likuiditetit, Banka e Shqipërisë i është përgjigjur me rritje të peshës së injektimeve afatgjata deri në 46%, vlerë kjo në rritje nga 19.3% dhe 39.4% në vitet 2016 e 2017.

Tabelë 4. Struktura e operacioneve injektuese të likuiditetit nga Banka e Shqipërisë

	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Mungesa mesatare vjetore e likuiditetit (në miliardë lekë)	-14.2	-11.5	-17.3	-23.5	-27.1	-21.0	-32.5	-36.3
Instrumenti kryesor	74%	55%	60%	64%	55%	80.7%	61.6%	54%
Injektimet afatgjata	26%	45%	40%	36%	45%	19.3%	39.4%	46%

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gjatë vitit 2018, Banka e Shqipërisë ka kryer operacione strukturore, duke blerë dhe shitur bono thesari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, me synim uljen e përqendrimit të emetimeve 6-mujore.

Në aktivitetin e menaxhimit të portofolit të letrave me vlerë - nëpërmjet operacioneve strukturore – dhe menaxhimit të likuiditetit të sistemit bankar, Banka e Shqipërisë ka synuar dhe ka arritur të rrisë peshën e kryerjes së veprimeve në tregun sekondar kundrejt tregut primar. Gjatë vitit 2018, janë blerë në tregun sekondar rreth 11.5 miliardë lekë bono thesari ose rreth 20% e portofolit të letrave me vlerë. Kjo shifër ka ardhur në rritje, nga 9.3 miliardë lekë në vitin 2017.

LEHTËSITË E PËRHERSHME

Lehtësitë e përhershme – depozita njëditore dhe kredia njëditore pranë Bankës së Shqipërisë – i shërbejnë bankave të nivelit të dytë për të administruar likuiditetin

në bazë ditore, si dhe përcaktojnë një korridor në të cilin mund të luhaten normat e interesit në tregun ndërbankar. Ky korridor u ngushtua gjatë vitit 2018 në 1.8 pikë përqindje, nga 2.0 pikë përqindje në 2017. Aktualisht, norma e depozitës njëditore qëndron në 0.1% dhe norma e kredisë njëditore në 1.9%.

Instrumenti i depozitës njëditore është përdorur çdo ditë gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit, ndërkohë vëllimi mesatar për vitin ishte 4.55 miliardë lekë. Përdorimi i kredisë njëditore është dyfishuar gjatë vitit 2018 në 42 raste, kundrejt 20 rasteve të një viti më parë. Rritja e numrit të rasteve të kredisë njëditore lidhet kryesisht me mangësitë strukturore në tregun ndërbankar, ku shkëmbimi i likuiditetit kufizohet nga limitet e tregtimit që bankat kanë me njëratjetrën. Pavarësisht rasteve më të shumta, shuma mesatare e përdorur ka rënë në 450 milionë lekë, kundrejt mesatarisht 1.1 miliardë lekë në vitin 2017.

REZERVA E DETYRUAR

Rezerva e detyruar në lekë është instrument i politikës monetare që synon rregullimin e likuiditetit në sistemin bankar dhe stabilizimin e normave të interesit rreth normës bazë të Bankës së Shqipërisë.

Në kuadër të masave të deeuroizimit, Banka e Shqipërisë ndryshoi, gjatë vitit 2018, normën e rezervës së detyruar. Ndryshimet synonin lehtësimin e barrës së rezervës për monedhën vendase Norma e rezervës për monedhën vendase u ul nga 10% uniform për të gjitha llojet e detyrimeve, në 5.0% për llogaritë me maturim deri 12 muaj dhe 7.5% për llogaritë me maturim nga 12 muaj deri në 2 vjet. Për valutat e huaja, norma u rrit në 12.5% dhe 20%, në varësi të shkallës së ekspozimit të bankave kundrejt detyrimeve në valutë, duke aplikuar një normë më të lartë për bankat me një ekspozim më të madh. Banka e Shqipërisë vendosi që fondet shtesë që bankat e nivelit të dytë duhet të bllokonin në valutë, të mbaheshin si kundravleftë në lekë, deri në qershor 2019.

Po ashtu, Banka e Shqipërisë rriti normën e përdorimit ditor të rezervës së detyruar në lekë në 70%, nga 40%, duke rritur mundësitë e bankave për administrimin e likuiditetit në lekë. Ky limit i ri është përdorur mesatarisht nga 4 banka, që prej hyrjes në fuqi të vendimit në muajin shkurt 2018.

Për të rritur shkallën e transmetimit të politikës monetare dhe në përputhje me standardin e Bankës Qendrore Evropiane, norma e remunerimit të rezervës së detyruar në lekë është rritur në 100% të normës bazë, nga 70%.

Remunerimi i llogarive të rezervës së detyrueshme në valutë dhe e tepricave të bankave në Bankën e Shqipërisë, nuk ka pësuar ndryshime rregullative. Duke filluar nga muaji shtator 2016, bankat paguajnë për rezervën e detyruar në euro një normë interesi të barabartë me normën e depozitës njëditore të Bankës Qendrore Evropiane, e cila, edhe gjatë vitit 2018, nuk ka ndryshuar dhe ka qenë negative në -0.40%. Norma e remunerimit të rezervës së detyruar në USD është 0%, që prej vitit 2011.

Normat e interesit të remunerimit të rezervave të tepërta në lekë dhe dollarë amerikanë kanë vijuar të jenë 0% gjatë vitit 2018, sikurse një vit më parë. Nga ana tjetër, norma e interesit të remunerimit të tepricave të gjendjes në euro ka mbetur në nivelin e caktuar në vitin 2016, në nivelin 0.25 pikë përqindje më e ulët se norma e interesit të depozitës së Bankës Qendrore Evropiane.

2.3. STABILITETI FINANCIAR DHE POLITIKAT MAKROPRUDENCIALE

Banka e Shqipërisë ka një rol parësor në arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit të sistemit financiar në vend. Këtë objektiv Banka e Shqipërisë e përmbush nëpërmjet ushtrimit, në mënyrë paralele, të tre funksioneve të rëndësishme: funksionit mbikëqyrës që përfshin licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e bankave dhe institucioneve të tjera financiare jobankare[19]; funksionit të hartimit dhe zbatimit të politikave makroprudenciale; dhe funksionit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme në banka.

Funksioni mbikëqyrës kujdeset që institucionet e veçanta të jenë të mirërregulluara, të administrojnë rrezikun në mënyrë të përshtatshme dhe të kryejnë aktivitetin e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ndërsa funksioni i ndërhyrjes së jashtëzakonshme synon vijueshmërinë e funksioneve kritike të bankave në vështirësi financiare, me kosto sa më të ulëta për stabilitetin financiar dhe financat publike.

Si autoritet kryesor për zbatimin e politikës makroprudenciale, nëpërmjet përdorimit të instrumenteve makroprudenciale, Banka e Shqipërisë kujdeset që të parandalojë rreziqet sistemike për sistemin financiar dhe të rrisë rezistencën e sektorit bankar ndaj këtyre rreziqeve. Në këtë mënyrë, sistemi financiar mbetet i qëndrueshëm dhe i aftë të kryejë rolin e tij të ndërmjetësimit financiar midis agjentëve ekonomikë, duke mbështetur kështu rritjen ekonomike të vendit.

2.3.1. VEPRIMET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË KUADËR TË ZBATIMIT TË POLITIKËS MAKROPRUDENCIALE

Në muajin gusht të vitit 2017, Banka e Shqipërisë miratoi Strategjinë e Politikës Makroprudenciale, e cila synon ndërmarrjen e veprimeve për parandalimin dhe zbutjen e rrezikut sistemik, në funksion të garantimit të një sistemi financiar të qëndrueshëm dhe eficient. Në këtë dokument përcaktohen objektivat kryesorë dhe të ndërmjetëm të politikës makroprudenciale, instrumentet e politikës makroprudenciale dhe treguesit më të rëndësishëm, që mund të përdoren për monitorimin e secilit prej objektivave. Dokumenti i Strategjisë përcakton ciklin e politikës makroprudenciale dhe rolin e strukturave të Bankës së Shqipërisë në

[19] *Sipas përkufizimit në ligjin "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".*

ndjekjen e tij. Ky dokument njeh Bankën e Shqipërisë si autoritet me rol parësor, por jo ekskluziv, në hartimin dhe zbatimin e politikës makroprudenciale. Në funksion të zbatimit të Strategjisë, gjatë vitit 2018, Banka e Shqipërisë është përqendruar në: a) zhvillimin e instrumenteve të politikës makroprudenciale; b) ndërtimin e sistemeve të paralajmërimit të hershëm për rreziqet sistemike; dhe c) përmirësimin e transparencës dhe komunikimit me industrinë bankare dhe publikun.

a) Zhvillimi i instrumenteve të politikës makroprudenciale

Paketa e masave për fuqizimin e përdorimit të monedhës vendase

Gjatë vitit 2018, Banka e Shqipërisë ka punuar për rishikimin e bazës rregullative dhe zbatimin e detyrimeve të institucionit, në kuadër të Memorandumit të Bashkëpunimit me Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë dhe me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare (prill 2017), për fuqizimin e përdorimit të monedhës vendase në sistemin financiar dhe ekonominë shqiptare (e njohur ndryshe si paketa e deeuroizimit). Një përdorim më i lartë i monedhës vendase në ekonominë shqiptare, sjell përparësi të ndjeshme në efektivitetin e politikave ekonomike dhe në uljen e rreziqeve financiare. Në përputhje me këto përfundime dhe në zbatim të politikës "Për zgjerimin e përdorimit të monedhës kombëtare në veprimtarinë e bankave dhe të institucioneve financiare" të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë[20], gjatë vitit 2018, Banka e Shqipërisë ka miratuar[21] disa ndryshime rregullative. Këto ndryshime përfshijnë: (i) uljen e normës së rezervës së detyrueshme për depozitat në lekë dhe rritjen e asaj për depozitat në valutë, (ii) rritjen e nivelit minimal të kërkuar për raportin e aktiveve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra në valutë, dhe (iii) vendosjen e kërkesave për rritjen e transparencës për kredinë në valutë, lidhur me rreziqet për huamarrësin. Masat kanë hyrë në zbatim në kohë të diferencuar, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2018. Dukuria e euroizimit shtrihet në të gjithë ekonominë shqiptare, ndaj trajtimi i saj kërkon përpjekje të koordinuara, shumëdimensionale, në nivel ndërinstitucional.

Shtesat makroprudenciale të kapitalit

Në hartimin dhe zbatimin e politikës makroprudenciale, Banka e Shqipërisë udhëhiqet nga standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare. Një nga blloqet më të rëndësishme të instrumenteve makroprudenciale që ka gjetur zbatim në mjaft vende, përfshirë ato të Bashkimit Evropian dhe të rajonit të Ballkanit, është ai i krijimit të rezervave/shtesave makroprudenciale të kapitalit. Këto shtesa kapitali, synojnë të zbusin rreziqet sistemike ciklike dhe strukturore

[20] *Vendim i Këshillit Mbikëqyrës i datës 07.02.2018, nr. 9, "Për miratimin e politikës "Për zgjerimin e përdorimit të monedhës kombëtare në veprimtarinë e bankave dhe të institucioneve financiare"".*

[21] *Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës të datës 07.02.2018 me nr.10, nr.14 dhe nr.15: "Për miratimin e disa ndryshimeve në rregulloren "Mbi minimumin e rezervës se detyrueshme të mbajtur në Bankën e Shqipërisë nga bankat""; "Për një ndryshim në rregulloren "Për administrimin e rrezikut të likuiditetit""; "Për disa ndryshime në rregulloren "Mbi transparencën për produktet bankare e financiare"", dhe vendimi i datës 04.04.2018, nr.27 "Për disa ndryshime në rregulloren për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekare".*

të veprimtarisë bankare dhe përfshijnë shtesën konservuese të kapitalit, shtesën kundërciklike të kapitalit, shtesën e kapitalit për bankat me rëndësi sistemike dhe shtesën e kapitalit për rrezikun strukturor sistemik. Gjatë vitit 2018, Banka e Shqipërisë ka përgatitur projektrregulloren për zbatimin e shtesave makroprudenciale të kapitalit, ka përgatitur metodologjitë që detajojnë zbatimin e disave prej tyre, i ka konsultuar këto dokumente gjerësisht me bankat dhe i ka publikuar ato në faqen e internetit, për të mbledhur një opinion më të gjerë publik. Projektrregullorja pritet të shqyrtohet nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë brenda gjashtëmujorit të parë të vitit 2019.

Duke adoptuar paketën rregullative dhe metodologjike për shtesat makroprudenciale të kapitalit, Banka e Shqipërisë adreson njëherësh tre nga objektivat e ndërmjetëm të politikës makroprudenciale të prezantuar në Strategjinë e Politikës Makroprudenciale, që janë: zbutja dhe parandalimi i rritjes së shpejtë të kreditimit dhe borxhmarrjes; kufizimi i përqendrimeve të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të ekspozimeve; dhe kufizimi i sipërmarrjes së tepërt të rrezikut nga institucionet financiare me rëndësi sistemike.

Tabelë 5. Objektivat e ndërmjetëm dhe efektet e pritura nga zbatimi i shtesave makroprudenciale të kapitalit

Objektivi i ndërmjetëm	Instrumentet	Kanalet e transmetimit / Efekti i pritur i instrumentit/masës
Zbutja dhe parandalimi i rritjes së shpejtë të kreditimit dhe të borxhmarrjes	Vendosja e rezervave të kapitalit kundërciklik (shtesa kundërciklike e kapitalit)	Rrit rezistencën e bankave; mund të ulë normën e rritjes së kredisë për shkak të kostove më të larta të financimit
Kufizimi i përqendrimeve të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të ekspozimeve	Vendosja e rezervave të kapitalit për rrezikun sistemik (shtesa e kapitalit për rrezikun sistemik)	Rrit kapacitetin e bankave për të përthithur humbjet; rrit koston e financimit dhe kufizon përqendrimet
Kufizimi i sipërmarrjes së tepërt të rrezikut nga institucionet financiare me rëndësi sistemike	Vendosja e rezervave të kapitalit për bankat me rëndësi sistemike (shtesa e kapitalit për rrezikun sistemik)	Ul probabilitetin dhe madhësinë e ndikimit të dështimit të bankave me rëndësi sistemike; forcon rezistencën e bankave

Aplikimi i njëkohshëm i këtyre kërkesave ndaj bankave pritet të rezultojë në rritje të rezistencës së tyre ndaj goditjeve potenciale, rritje të kapacitetit të bankave për të përthithur humbjet dhe ulje të probabilitetit të dështimit dhe të madhësisë së ndikimit të dështimit të bankave me rëndësi sistemike. Shtesat makroprudenciale të kapitalit përfaqësojnë një hap themelor në drejtim të përafrimit me standardin përkatës të Bashkimit Evropian, që janë Direktiva 2013/36/EU "Për kërkesat e kapitalit"; standardet përkatëse teknike të publikuara nga Autoriteti Bankar Evropian; dhe rekomandimet e Bordit Evropian të Rrezikut Sistemik.

b) Ndërtimi i sistemeve të paralajmërimit të hershëm

Një kusht i rëndësishëm për suksesin e politikave makroprudenciale është përdorimi i sistemeve të paralajmërimit të hershëm për rreziqet sistemike në sistemin financiar dhe sektorin bankar. Ky proces nënkupton ndërtimin dhe përdorimin e një numri treguesish të rëndësishëm të aktivitetit makroekonomik dhe financiar të klasifikuar sipas objektivave të ndërmjetëm të politikës makroprudenciale dhe monitorimin e ecurisë së këtyre treguesve ndaj vlerave kritike, tejkalimi i të cilave sinjalizon akumulim të rreziqeve sistemike. Kjo paketë analitike njihet si Harta Makroprudenciale. Edhe pse Banka e Shqipërisë ka përdorur në vazhdimësi Tregues të Shëndetit Financiar të hartuar sipas metodologjive ndërkombëtare, për të monitoruar aspekte të ndryshme të aktivitetit bankar dhe financiar dhe për të identifikuar rreziqet sistemike, Harta Makroprudenciale përfaqëson një vlerë të shtuar për analizat e stabilitetit financiar, për identifikimin e rreziqeve sistemike dhe për monitorimin e efektit të masave makroprudenciale. Monitorimi i treguesve të Hartës Makroprudenciale ka filluar në tremujorin e parë të vitit 2018, ndërsa prezantimi i Hartës dhe varianti paraprak i analizës, janë realizuar gjatë gjysmës së dytë të vitit. Pas testimit të kapaciteteve sinjalizuese të treguesve do të shikohet mundësia e publikimit të Hartës Makroprudenciale dhe analizës shoqëruese në një formë të përshtatshme. Ndërtimi dhe analizimi i Hartës Makroprudenciale i shërben hapit të parë të ciklit të politikës makroprudenciale: identifikimit të rrezikut dhe vlerësimit të tij.

c) Transparenca dhe komunikimi

Banka e Shqipërisë, në përputhje me detyrimet ligjore, vizionin, vlerat dhe parimet që ndjek, synon të ofrojë nivelin më të lartë të transparencës dhe të komunikimit edhe në drejtim të hartimit dhe zbatimit të politikës makroprudenciale. Gjatë vitit 2018, është punuar për përmirësimin e komunikimit me publikun, lidhur me metodat dhe instrumentet që përdoren nga Banka e Shqipërisë për vlerësimin dhe adresimin e rreziqeve sistemike. Një nga blloqet e informacionit që përdoren nga Banka e Shqipërisë për analizat e stabilitetit financiar dhe monitorimin e rreziqeve sistemike është baza e të dhënave nga vrojtimet mbi gjendjen financiare dhe ngarkesën me borxh të familjeve dhe ndërmarrjeve. Publikimi i Raportit të Stabilitetit Financiar për gjashtëmujorin e parë të vitit 2018 u shoqërua nga publikimi për herë të parë i analizës dhe të dhënave të këtyre vrojtimeve.

2.3.2. ZHVILLIMET KRYESORE NË SEKTORIN BANKAR DHE SISTEMIN FINANCIAR

Veprimtaria e sektorit bankar dhe e sistemit financiar, gjatë vitit 2018, ka qenë e qëndrueshme dhe është zhvilluar në kushte të favorshme makroekonomike. Politika monetare vijoi të ruante kahun lehtësues gjatë vitit 2018, duke ndihmuar

rënien e mëtejshme të normave të interesit të depozitave, kredive dhe letrave me vlerë të qeverisë. Mbështetja e sektorit publik në huamarrjen e jashtme ka krijuar kushte për zgjerim të kredisë nga bankat vendase për sektorin privat.

Në fund të tremujorit të tretë të vitit 2018, për shkak të rritjes më të shpejtë të ekonomisë në krahasim me rritjen e aktivitetit financiar, pesha e aktiveve të sistemit financiar ndaj PBB-së ra në rreth 97% nga 99.5% në fund të vitit 2017. Bilanci i agreguar i institucioneve financiare jobanka, i shoqërive të sigurimit, i shoqërive të kursim-kreditit dhe i fondeve të pensioneve private suplementare u zgjerua në terma vjetorë; bilanci i sektorit bankar shënoi një rritje shumë të lehtë, ndërsa bilanci i fondeve të investimit u zvogëlua, për shkak të rënies së vëllimit të investimeve të këtyre fondeve në letra me vlerë të qeverisë. Sektori bankar, i cili ka mbi 90% të aktiveve të sistemit financiar, e mbylli vitin 2018 me një rezultat financiar pozitiv, me një nivel të mirë kapitalizimi, me likuditet të bollshëm dhe në nivele më të larta se ato të kërkuara nga rregullorja përkatëse, dhe me një cilësi kredie më të mirë në krahasim me një vit më parë.

Gjatë vitit 2018, bankat vendase kanë zgjeruar veprimtarinë në transaksionet me letrat me vlerë, ndërkohë që veprimet me klientët (kredia) dhe veprimet me thesarin dhe ato ndërbankare kanë ardhur duke u tkurrur. Pavarësisht rritjes së ngadaltë të kredisë, sektori bankar e mbylli vitin 2018 me një rezultat financiar pozitiv prej rreth 18 miliardë lekësh, vlerë kjo disi më e ulët në krahasim me atë të vitit paraardhës. Të ardhurat neto nga interesat kanë vijuar të përfaqësojnë burimin kryesor (rreth 70%) të të ardhurave të sektorit bankar. Këto të ardhura ishin pothuajse të njëjta me ato të vitit 2017, duke qenë se të ardhurat dhe shpenzimet për interesa ruajtën nivelet e një viti më parë. Burimet e tjera të të ardhurave kanë qenë gjobat dhe komisionet, si edhe rimarrjet e provigjioneve për investime në mjete të tjera financiare. Treguesit e përfitueshmërisë kanë rënë lehtë, por vijojnë të mbeten në nivele të kënaqshme.

Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit të sektorit bankar u rrit në 18.2%, nga 17% një vit më parë. Pjesa më e madhe e bankave kanë një normë mjaftueshmërie më të lartë se 15%. Rritja në nivelin e kapitalizimit erdhi kryesisht nga rënia në vëllimin e aktiveve të peshuara me rrezik, si pasojë e ndryshimeve rregullatore të ndërmarra gjatë vitit, ndërkohë që kapitali rregullator i bankave ka regjistruar një rënie të lehtë. Situata e likuiditetit të sektorit bankar ka vijuar të jetë e qëndrueshme dhe treguesit e likuiditetit si për Lekun, ashtu edhe për valutën, në vlera dukshëm më të larta nga minimumet e përcaktuara në rregullore. Në fund të vitit 2018, teprica e depozitave të mbajtura nga sektori bankar ishte rreth 2 herë më e lartë në krahasim me kredinë e dhënë nga sektori bankar për individët dhe për korporatat jofinanciare publike dhe private.

Në fund të vitit 2018, teprica e përgjithshme e kredisë ishte rreth 3% më e vogël ndaj një viti më parë. Rënia në stokun e kredisë ka ardhur si pasojë e largimit nga bilanci (si rezultat i fshirjeve dhe shitjeve) dhe shlyerjes së një pjese të kredive me probleme, si pasojë e ecurisë së moderuar të kredisë së re, dhe mbiçmimit të monedhës vendase, i cili ka dhënë një efekt të dukshëm statistikor

në tkurrjen e vlerës së raportuar të kredisë në valutë. Kjo e fundit shënoi rënie me 4%, ndërkohë që kredia në monedhën origjinale euro (që zë mbi 90% të kredisë në valutë), u rrit me rreth 5%. Nëse nuk do të merrej në konsideratë vlera e kredive të fshira dhe efekti i kursit të këmbimit, rritja vjetore e tepricës së kredisë do të ishte rreth 2%. Sasia e kredisë së re për individët, gjatë vitit 2018, ishte e krahasueshme me atë të një viti më parë, ndërsa kredia e re për bizneset ishte rreth 5% më e ulët.

Rreziku i kredisë vijon të përfaqësojë rrezikun kryesor të aktivitetit të sektorit bankar dhe financiar në tërësi, por ky rrezik ka ardhur duke u zbutur gjatë vitit 2018, si pasojë e masave të marra nga bankat për të fshirë dhe ristrukturuar kreditë me probleme dhe si rezultat i forcimit të monitorimit të rrezikut për kreditimin e bizneseve gjatë viteve të fundit. Mbulimi i kredive me probleme me fonde rezervë dhe kapital dhe i tepricës së kredisë me kolateral ka vijuar të jetë në nivele të përshtatshme. Në fund të vitit 2018, raporti i kredive me probleme (RKP) shënonte 11.1% nga 13.2% një vit më parë, ndërkohë që teprica e kredive me probleme u zvogëlua me 20%. Përmirësimi më i madh në cilësinë e kredisë është regjistruar në kredinë në lekë, kredinë për bizneset, kredinë afatgjatë dhe kredinë për sektorin e tregtisë. Kredia për bizneset dhe kredia në valutë vijojnë të kenë cilësi më të dobët në krahasim me përkatësisht kredinë për individët dhe kredinë në monedhën vendase. Sektori i bujqësisë ka RKP më të ulët, ndërsa ai i industrisë RKP më të lartë. Pesha e kredisë së pambrojtur në valutë ndaj kredisë në valutë dhe totalit të kredisë ka mbetur pothuajse e pandryshuar, por cilësia e kësaj kredie është përmirësuar ndjeshëm gjatë vitit 2018. Ky përmirësim ka ardhur për shkak të fshirjeve dhe ristrukturimeve, ndërkohë që forcimi i monedhës vendase mund të ketë dhënë ndikim pozitiv në aftësinë paguese të huamarrësve në valutë me të ardhura në lekë.

Rreziku i likuiditetit vijon të mbetet i ulët dhe i kontrolluar. Normat minimale të likuiditetit sipas monedhave rregullohen me akte rregullative të Bankës së Shqipërisë dhe raportet e likuiditetit sipas valutave, si për sektorin, ashtu edhe për bankat individuale, kanë vijuar të qëndrojnë ndjeshëm mbi nivelet minimale të përcaktuara nga rregullorja përkatëse. Prova e rezistencës së likuiditetit, që realizohet një herë në vit, tregon se sektori bankar dhe bankat individuale kanë rezerva të mjaftueshme në tërësi dhe në secilën nga tri monedhat kryesore (Lek, Euro, USD) për të përballuar goditje ekstreme ndaj likuiditetit, gjatë një horizonti kohor dyvjeçar. Burimi kryesor i financimit të aktivitetit kreditues përfaqësohet nga depozitat e publikut, të cilat janë rreth dy herë më të larta nga teprica e kredisë, si për monedhën vendase ashtu edhe për valutën. Gjatë dy viteve të fundit, pesha e depozitave pa afat dhe llogarive rrjedhëse ndaj totalit të depozitave u rrit nga 40% në 44%. Pesha dhe vëllimi i depozitave me afat kanë vijuar të bien, në përgjigje të normave të ulëta të interesit. Pesha e konsiderueshme e llogarive rrjedhëse dhe depozitave pa afat i detyron bankat nga njëra anë të mbajnë nivele të larta aktivesh likuide, dhe nga ana tjetër, të nxiten drejt investimeve afatgjata ose me koeficient të lartë rreziku për të siguruar kthime më të larta. Të dhënat tregojnë që rritja e aktiveve të peshuara me koeficientët e rrezikut ka qenë e ndjeshme në periudhën 2008-2016,

por ato kanë rënë gjatë dy viteve të fundit. Nga ana tjetër, ndonëse pesha e kredisë afatgjatë ndaj tepricës së kredisë është rritur me 4 pikë përqindje, në nivelin 44%, afati i mbetur i maturimit për tërësinë e aktiveve financiare të sektorit bankar nuk ka treguar ndryshime të ndjeshme gjatë dy viteve të fundit.

Rreziqet e tregut të përfaqësuara nga rreziku që vjen nga ndryshimi i normave të interesit dhe nga rreziku i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë që vjen nga ndryshimet në kursin e këmbimit vijojnë të mbeten të ulëta, por të pranishme. Gjatë gjithë vitit 2018, sektori bankar ka mbajtur më shumë mjete sesa detyrime të ndjeshme ndaj ndryshimit të normës së interesit. Mbajtja e një diference pozitive midis mjeteve dhe detyrimeve me norma të ndryshueshme interesi i ekspozon bankat ndaj rrezikut të normave të interesit, në rast se normat bien në mënyrë të menjëhershme. Në kushtet kur pozicioni neto në raport me kapitalin rregullator është i vogël dhe ka ardhur duke u zvogëluar gjatë gjysmës së dytë të vitit 2018, dhe në kushtet kur normat e interesit vijojnë të qëndrojnë në nivele të ulëta historike, ekspozimi ndaj goditjeve të mundshme nga normat e interesit vlerësohet të jetë i kufizuar. Rreziku i drejtpërdrejtë nga luhatjet e kursit të këmbimit në bilancin e sektorit bankar vijon të mbetet i ulët, duke qenë se pozicioni i hapur neto valutor (në blerje) në raport me kapitalin rregullator mbetet mjaft i vogël dhe dukshëm nën kufirin e sipërm rregullator prej 30% për të gjitha monedhat dhe 20% për monedhat e veçanta. Por rreziku i tërthortë i kursit të këmbimit është i ndjeshëm. Kanali i transmetimit të këtij rreziku mbetet prania e lartë e kredisë në valutë ku huamarrësi i ka të ardhurat në lekë. Në fund të vitit 2018, teprica e kësaj kredie nuk tregoi ndryshime dhe mbeti pranë niveleve më të ulëta historike, duke zënë 24.3% të tepricës totale të kredisë. Ruajtja e stimujve për përdorimin më të lartë të monedhës vendase, në sistemin financiar dhe në sektorin real të ekonomisë, është e nevojshme për uljen e këtij rreziku.

Rreziku i përqendrimit sipas aktiviteteve dhe produkteve që ofron sektori bankar, vijon të mbetet i ulët. Në fund të tremujorit të tretë të vitit 2018[22], Banka e Shqipërisë miratoi bashkimin me përthithje të Bankës Intesa Sanpaolo Albania sh.a. me Veneto Banka sh.a. dhe të Bankës Amerikane të Investimeve sh.a. me Bankën NBG Albania sh.a. Si Banka Veneto, ashtu edhe Banka NBG i përkisnin grupit të bankave të vogla dhe zinin përkatësisht 1.7% dhe 2.4% të aktiveve të përgjithshme të sektorit bankar. Përthithja e tyre prej përkatësisht një banke të madhe dhe një banke të mesme, konsolidon veprimtarinë bankare dhe pritet të shoqërohet me përmirësim të eficiencës së saj. Rënia e numrit të bankave nga 16 në 14 nuk solli ndryshime në treguesit e përqendrimit të sektorit bankar sipas zërave kryesorë të bilancit dhe aktivitetit të bankave, duke qenë se asnjëra nga bankat e përfshira në përthithje nuk kishte pozicion dominues në tregues ose aktivitete të veçanta.

[22] *Vendimet janë publikuar në Buletinin Zyrtar, vëllimi 20, numër 5, Tetor 2018. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 60, datë 06.09.2018, "Për dhënien e miratimit paraprak për bashkimin me përthithje të Bankës Intesa Sanpaolo Albania sh.a. me Veneto Banka sh.a."; Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 61, datë 06.09.2018, "Për dhënien e miratimit paraprak për bashkimin me përthithje të Bankës Amerikane të Investimeve sh.a. me Bankën NBG Albania sh.a.".*

HAPËSIRË INFORMUESE 6: MASAT E BANKËS SË SHQIPËRISË PËR FUQIZIMIN E PËRDORIMIT TË MONEDHËS VENDASE NË VEPRIMTARINË BANKARE

Në kuadër të Memorandumit të Bashkëpunimit me Ministrinë e Financave dhe me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, nënshkruar në datën 18 prill 2017, Banka e Shqipërisë ndërmori një paketë masash konkrete për të stimuluar përdorimin e monedhës vendase. Paketa e masave, e cila u miratua me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë në shkurt 2018, përbëhet nga këto elemente kryesore: i) adoptimi i një dokumenti politik lidhur me rritjen e përdorimit të monedhës vendase në veprimtarinë bankare dhe atë jobankare që mbikëqyret nga Banka e Shqipërisë, ii) diferencimi i rezervës së detyrueshme për detyrimet në valutë; iii) kërkesa më të larta për treguesit e likuiditetit në valutë; iv) ndërgjegjësimi i huamarrësve për rrezikun që paraqet kredia në valutë.

Më konkretisht:

i. U miratua Politika për Rritjen e Përdorimit të Monedhës Vendase në veprimtarinë e bankave dhe institucioneve financiare jobankare që mbikëqyren dhe rregullohen nga Banka e Shqipërisë;

ii. Për të rritur peshën e monedhës vendase dhe njëkohësisht zgjerimin e maturitetit në strukturën e detyrimeve të sektorit bankar, Banka e Shqipërisë vendosi të diferencojë normën e rezervës së detyrueshme[I], për kategoritë e detyrimeve të përfshira në bazën e rezervës së detyruar, si vijon:

- *7.5% (nga 10% që ishte më parë) për detyrimet në lekë që kanë një afat maturimi jo më të gjatë se 12 muaj;*
- *5% (nga 10% që ishte më parë) për detyrimet në lekë që kanë një afat fillestar më të gjatë se 12 muaj deri në 2 vjet;*
- *12.5% (nga 10% që ishte më parë) për detyrimet në valutë kur këto zënë nën 50% të totalit të detyrimeve;*
- *20% (nga 10% që ishte më parë) për pjesën e detyrimeve në valutë mbi 50% të totalit të detyrimeve.*

iii. Për administrimin më të kujdesshëm të rrezikut të likuiditetit, Banka e Shqipërisë vendosi të rrisë kërkesën minimale rregullative për raportin e aktiveve likuide në valutë[II] ndaj detyrimeve afatshkurtra në valutë, në nivelin 20%. Për lekun, niveli i minimal i kërkuar i raportit, u ruajt në 15%.

iv. Për rritjen e ndërgjegjësimit të huamarrësve në lidhje me rrezikun e kreditit për shkak të huamarrjes së pambrojtur në valutë, Banka e Shqipërisë i ka kërkuar bankave[III] që:

- *në rastet kur klienti aplikon për kredi në monedhë të ndryshme nga monedha që ka të ardhurat, bankat i propozojnë atij një kredi alternative në të njëjtën monedhë të të ardhurave të tij, si dhe e pajisin atë me një shembull konkret se si ndryshon kësti i kredisë në rastin e nënçmimit të lekut dhe/ose të rritjes së normës së interesit (me vlera të përcaktuara);*
- *të përfshijnë në kontratat e reja të kredisë në valutë (apo ato që ristrukturohen rishtas), opsionin për përdorimin e mekanizmave që zbusin rrezikun e tregut për kredimarrësin, në rastin kur plotësohen kushtet e dakorduara nga banka dhe huamarrësi.*

Masat hynë në fuqi gradualisht deri në qershor 2018. Prej asaj periudhe, për të vlerësuar ndikimin e masave, Banka e Shqipërisë publikon çdo gjashtë muaj një raport të posaçëm.

[I] *Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 13, datë 07.02.2018, "Për miratimin e normës së rezervës së detyruar mbajtur në Bankën e Shqipërisë nga bankat".*
[II] *Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.14, datë 07.02.2018, "Për një ndryshim në rregulloren për administrimin e rrezikut të likuiditetit".*
[III] *Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 15, datë 07.02.2018, "Për disa ndryshime në rregulloren mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare".*

2.4. MBIKËQYRJA

Funksioni mbikëqyrës mbetet një instrument i rëndësishëm i Bankës së Shqipërisë në kryerjen e misionit të saj ligjor dhe institucional. Si një nga shtyllat kryesore të institucionit, ky funksion mban në vëzhgim zhvillimet e sistemit financiar dhe të operatorëve të tij. Rëndësi primare mbetet ruajtja e shëndetit financiar të institucioneve financiare, atyre bankare dhe jobankare, duke mbajtur në konsideratë peshën e madhe që zënë këta aktorë në stabilitetin financiar të vendit. Ky qëllim synohet të arrihet duke e shtrirë kontrollin e tyre që nga licencimi deri në krijimin e infrastrukturës rregullative e mbikëqyrjen në vend të veprimtarisë.

Banka e Shqipërisë mbetet e angazhuar në ushtrimin e këtij funksioni duke mbajtur në vëmendje të gjitha zhvillimet, si në nivel mikro dhe në nivel makro, brenda dhe jashtë vendit, për të vlerësuar ndikimin mbi shëndetin e aktorëve vendas dhe ndërhyrjen në kohë për adresimin e problematikave.

2.4.1. ZHVILLIMET KRYESORE

Banka e Shqipërisë nënshkroi një memorandum mirëkuptimi me Bankën Qendrore Evropiane (BQE) për fushën e mbikëqyrjes bankare. Nënshkrimi i tij i jep mundësi Bankës së Shqipërisë të vendosë një marrëdhënie bashkëpunimi më të strukturuar dhe të formalizuar me institucionin më të rëndësishëm financiar të Bashkimit Evropian (BE). Ai përcakton mënyrën e bashkëpunimit të ndërsjellë midis dy institucioneve, duke parashikuar shkëmbimin e informacioneve dhe kryerjen e një mbikëqyrjeje efektive, si dhe hap rrugën për pjesëmarrjen me të drejta të plota në kolegjet mbikëqyrëse të bankave të rëndësishme evropiane të pranishme në Shqipëri.

Në kuadër të bashkëpunimit me autoritetet homologe, Banka e Shqipërisë ka marrë pjesë në tre kolegje mbikëqyrëse të organizuara për grupet bankare evropiane të pranishme edhe në Shqipëri. Edhe pse ajo mori pjesë me statusin e vëzhguesit në kolegj, vlerësimet e ngritura për aktivitetin e filialeve në Shqipëri janë konsideruar dhe janë përcjellë në kuadër të menaxhimit të rreziqeve në

nivel grupi. Gjithashtu, gjatë vitit 2018, ka pasur një fluks të rregullt informacioni mbi vlerësimin e planit të rimëkëmbjes së grupit, si dhe përcaktimit të kërkesave për kapital. Në kuadër të bashkërendimit të aktiviteteve mbikëqyrëse, edhe këtë vit, u zhvillua një ekzaminim i përbashkët (i targetuar) me mbikëqyrësit e BQE-së në një nga bankat me origjinë nga BE-ja.

Gjatë vitit 2018, mund të përmendim disa zhvillime strukturore të pronësisë në sistemin bankar, që lidhen me konsolidimin e strukturës së pjesëmarrësve në tregun bankar, duke e çuar numrin e bankave në sistem në 14 dhe, me materializimin e ndryshimeve tashmë në proces finalizimi, potencialisht në 12. Në këtë kontekst u materializuan këto ngjarje:

- procesi i bashkimit me përthithje për dy prej bankave të sistemit. Më shumë se një nevojë e brendshme e tregut, procesi u diktua nga zhvillimet në vendin e origjinës së kapitalit të të dy bankave. Për rrjedhojë, Banka Intesa SanPaolo mori në pronësi dhe u bashkua me Bankën Veneto, pasi Banka Veneto shpalli falimentin dhe u ble nga Banka Intesa SanPaolo në Itali;
- Banka Amerikane e Investimeve mori pronësinë dhe u bashkua me Bankën NBG Shqipëri. Kjo ngjarje u mbështet nga plani i ristrukturimit të sistemit bankar në Greqi për uljen e ekspozimit jashtë Greqisë, të dakordësuar ndërmjet autoriteteve greke dhe partnerëve ndërkombëtarë, si pjesë e paketës së zgjidhjes së krizës ekonomike në Greqi;
- Banka Union ka përmbyllur marrëveshjen për blerjen e aksioneve të Bankës Ndërkombëtare Tregtare. Kjo ngjarje u përcaktua nga vendimi i aksionerëve të kësaj të fundit për t'u larguar nga tregu shqiptar, si dhe nga ambiciet e hershme të Bankës Union për t'u zgjeruar në tregun vendas, nëpërmjet përthithjes së një banke ekzistuese;
- Banka Tirana, ish-pjesë e Grupit Pireu, për të njëjtat arsye si në rastin e Bankës NBG, përmbylli shitjen e aksioneve të saj tek Grupi Balfin sh.p.k. dhe Banka Commercijalna A.D. Shkup. Ky transaksion mori miratimin nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë në muajin shkurt 2019 dhe do të hyjë në fuqi pas marrjes së miratimit nga Fondi Helenik i Stabilitetit Financiar;
- Banka Societe Generale Albania realizoi shitjen tek banka OTP Bank Nyrt me origjinë kapitali nga Hungaria, si pjesë e strategjisë së bankës mëmë për t'u tërhequr në përgjithësi nga rajoni i Ballkanit;
- Së fundi, aksionerët e Bankës së Kreditit të Shqipërisë kanë vendosur likuidimin vullnetar të bankës, proces i cili pritet të finalizohet gjatë pjesës së parë të vitit 2019.

Ngjarjet e përmendura më sipër janë materializim i tendencave të shfaqura në vitet e fundit për konsolidim të tregut bankar dhe pjesa më e rëndësishme e ndryshimeve të pritshme ka ndodhur. Këto ndryshime sjellin një rritje të peshës në treg të kapitalit vendas, interes ky që pritet të sjellë një rigjallërim të aktivitetit bankar, por njëkohësisht edhe një rrezik më të lartë, duke kërkuar që vëmendja mbikëqyrëse të përqendrohet në ruajtjen e cilësisë së administrimit të rreziqeve dhe të treguesve të shëndetit financiar.

Ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë, që identifikohet si rreziku kryesor mbi bazën e volumit dhe të peshës së aktivitetit, ndikimit në pozicionin financiar të bankave dhe kërkesës dominuese për kapital, pësoi një rënie të konsiderueshme. Treguesi kryesor i kredive me probleme ndaj totalit të portofolit të kredisë arriti në 11.1% në fund të vitit 2018, duke u përafruar në këtë mënyrë me të njëjtën periudhë të një dekade më parë. Treguesi u ul me 2.15 pikë përqindje, në kushtet kur portofoli i kredive me probleme u ul me rreth 15.2 miliardë lekë apo rreth 20%, si pasojë e ngjarjeve që lidhen në masën më të madhe me shitjen e portofoleve të kredive me probleme dhe fshirjen e tyre nga bilancet e bankave. Përtej sa tregojnë vlerat e treguesit të kredive me probleme, në 2 vitet e fundit ka pasur një rënie të ndjeshme të vlerës absolute të kredive me probleme. Kështu, në vitin 2017, kreditë me probleme kanë rënë me rreth 30 miliardë lekë, dhe në vitin 2018 me rreth 15 miliardë lekë, një total prej rreth 45 miliardë lekësh për 2 vite ose 41.3%.

Për vitin 2019, është duke u vlerësuar marrja e një mase tjetër mbikëqyrëse – ajo e uljes së kërkesës rregullative për fshirjen e detyruar të kredive të klasifikuara të humbura prej 3 vitesh, e cila është aktualisht në 2 vite. Megjithë uljen e vazhdueshme të rrezikut ndaj këtij ekspozimi, Banka e Shqipërisë, si pjesë të qasjes së saj për adresimin e problematikave në mënyrë të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, mbetet e angazhuar të realizojë të gjitha detyrimet e saj në kuadër të **planit kombëtar për reduktimin e kredive me probleme**. Në funksion të këtij qëllimi, ajo ka hartuar edhe një projektrregullore për **adresimin jashtëgjyqësor të kredimarrësve**, të cilën e ka diskutuar gjatë vitit me bankat, nëpërmjet disa takimeve dhe komunikimit shkresor. Shkëmbimi i opinioneve dhe reflektimi i tyre në projektin e rregullores ka marrë kohë nga të gjitha palët, për shkak të natyrës komplekse të ngritjes së një forme bashkëpunimi të qëndrueshme e të rregulluar midis bankave. Ndërkohë, në takimet e organizuara me bankat, janë diskutuar edhe çështje të rëndësishme në funksion të administrimit të rrezikut të kredisë, siç janë përdorimi i **pasqyrave financiare zyrtare** të huamarrësve, si dhe studimi i shoqërisë Deloitte mbi qëndrueshmërinë financiare të bizneseve më të mëdha në vend, studim ky i financuar nga projekti FinSAC i Bankës Botërore.

Një çështje e rëndësishme e planit kombëtar të masave për reduktimin e kredive me probleme ishte përdorimi i pasqyrave financiare zyrtare në vlerësimin e rrezikut të kredisë së huamarrësve. Ndërkohë që kjo çështje ishte adresuar për ekspozimet e mëdha të bankave me rregulloren "Për administrimin e rrezikut për ekspozimet e mëdha të bankave", në vitin 2018, kjo kërkesë u shtri për të gjithë llojet e huamarrësve. Duke qenë se bankat ishin paraprakisht në dijeni të kësaj mase, nëpërmjet një shkrese të Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, iu soll në vëmendje kjo kërkesë, dhe zbatimi i saj është ndjekur në vazhdimësi gjatë mbikëqyrjes në vend të subjekteve, nga ana e Departamentit të Mbikëqyrjes.

Një tjetër detyrë e Bankës së Shqipërisë në kuadër të planit kombëtar të reduktimit të kredive me probleme ishte ajo për përmirësimet në **Regjistrin e Kredive**. Përveç përmirësimeve të kryera në vitin 2016, brenda institucionit është ngritur

një grup pune për të zgjeruar bazën e të dhënave, me qëllim harmonizimin e raportimit të kredive në përputhje me standardet ndërkombëtare. Ndërkohë, Banka e Shqipërisë është pjesë e procesit të diskutimit për ngritjen e Byrosë së Kredisë, ku marrin pjesë Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Shoqata Shqiptare e Bankave.

Gjatë vitit 2018, një hapësirë më e gjerë i është lënë shqyrtimit dhe diskutimit të dokumentit të **"Vlerësimit të Brendshëm të Mjaftueshmërisë së Kapitalit"**, si dhe "Planit të Rimëkëmbjes", të paraqitur nga secila prej bankave. Këto dy dokumente përfaqësojnë një vetëvlerësim të plotë të aftësive të bankës, si për të kontrolluar dhe përballuar nivelet e rreziqeve që lindin gjatë aktivitetit të zakonshëm, ashtu edhe për t'u rimëkëmbur nga një situatë e vështirë financiare.

- Procesi i vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit është një risi, si për bankat ashtu dhe për mbikëqyrësit dhe kërkon një angazhim afatgjatë. Vlerësimi i parë i këtij dokumenti evidentoi efektet sasiore të llogaritura nga bankat, përputhshmërinë me kërkesat rregullative, si dhe disa mangësi për një përfshirje më të gjerë e më cilësore të rreziqeve me efekte të mundshme në nevojat për kapital.
- Planet e rimëkëmbjes gjatë vitit 2018 i janë nënshtruar kërkesave të zgjeruara rregullatore, ndërsa vlerësimi i tyre është kryer në komunikim të ngushtë me bankat, si dhe me asistencën e vlefshme të Bankës Botërore. Hartimi i planeve nga ana e bankave ka njohur një rritje cilësore, megjithëse ka ende elemente që duhet të përmirësohen për një integrim më të plotë me kuadrin e brendshëm të menaxhimit të rreziqeve, dhe me strategjitë e objektivat në nivel individual e në nivel grupi.

Në drejtim të përmirësimit të proceseve mbikëqyrëse, Banka e Shqipërisë mbetet e angazhuar drejt finalizimit të dy projekteve të asistuara nga BERZH-i dhe BB-ja. Më konkretisht, me asistencën e BERZH-it u krye një vlerësim i procedurave të brendshme mbikëqyrëse të vlerësimit të rreziqeve, kryesisht i rrezikut organizativ dhe atij të kredisë, si edhe i kuadrit rregullativ për këtë qëllim, i shoqëruar me propozime konkrete për ndryshim. Bazuar mbi vlerësimet mbi ndryshimet e propozuara është hartuar plani për zbatimin e tyre. Dokumenti tjetër është ai i komunikimit dhe shkëmbimit të informacionit dhe vlerësimit të auditorëve të jashtëm, me qëllim përmirësimin e cilësisë së kontrollit si të bankave, ashtu edhe të vetë auditorëve. Ky dokument është hartuar me asistencën e Bankës Botërore dhe të shoqërisë Grant Thornton.

Gjatë vitit 2018, mbi bazën e ndryshimeve rregullative tashmë të njohura lidhur me kërkesat shtesë për raportim nga subjektet financiare të të dhënave sasiore dhe cilësore, në zbatim të standardeve ndërkombëtare dhe rekomandimeve të lëna gjatë raundit të katërt të vlerësimit të Shqipërisë nga ekspertët e Moneyval, Banka e Shqipërisë ka vijuar me vlerësimin e **masës së ekspozimit të subjekteve ndaj rrezikut të pastrimit të parave (PPP) dhe financimit të terrorizmit (PFT).** Vlerësimi nga jashtë tregon një ekspozim të sistemit bankar përgjithësisht në nivel mesatar, ndërkohë që për subjektet e tjera ky rrezik vlerësohet më i lartë.

Rezultatet e këtij vlerësimi janë mbajtur në konsideratë në hartimin e planeve mbikëqyrëse për subjektet më të ekspozuara, të tilla si zyrat e këmbimit valutor. Gjatë vitit 2018, u inspektuan 23 të tilla për PPP/PFT, për 17 prej të cilave u morën masa mbikëqyrëse dhe administrative për mangësitë e konstatuara.

Në pjesën e parë të këtij viti, Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Masave kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (MONEYVAL) përfundoi **raundin e pestë të vlerësimit të Masave kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit,** proces i nisur dhe raportuar që në vitin 2017. Vlerësimi, ku Banka e Shqipërisë ka luajtur një rol të veçantë mbështetës në pozicionin e institucionit mbikëqyrës për pjesën më të madhe të tregut financiar, u mbyll në muajin korrik 2018, me kalimin e raportit vlerësues në seancë plenare të Moneyval-it. Sipas këtij raporti, subjektet financiare u vlerësuan në nivelin "*substantial*/i konsiderueshëm" të efektivitetit, në kushtet kur veçanërisht bankat paraqesin një njohje të mirë të rreziqeve të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe të detyrimeve ligjore, si dhe kanë marrë përgjithësisht masat e duhura, në raport të drejtë me nivelin e vlerësuar të rrezikut, për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Procesi i vlerësimit u shoqërua me një plan masash, me qëllim adresimin e problematikave kryesore të evidentuara në raport, përmbushja e të cilave do të vijojë edhe përgjatë vitit 2019.

Bashkëpunimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP), gjatë vitit ka vijuar në mënyrë më intensive. Ky bashkëpunim u materializua në kuadër të procesit të vlerësimit të Moneyval-it, inspektimeve të përbashkëta, si edhe kontributit në drejtim të rishikimit të kuadrit ligjor për çështje të parandalimit të pastrimit të parave.

Së fundi, në mbështetje të misionit të saj, Banka e Shqipërisë ka vijuar aktivitetin e saj normal me monitorimin e sistemit financiar, kryesisht të bankave, nëpërmjet: **inspektimeve në vend dhe analizave nga jashtë;** vlerësimit të masës së eskpozimit ndaj rreziqeve individuale dhe kontrollit për administrimin e tyre; si edhe në drejtim **të rishikimit/përmirësimit të kuadrit rregullativ dhe licencimit të subjekteve, apo veprimtarive shtesë.**

2.4.2. EKZAMINIMET NË VEND

Gjatë vitit 2018, janë zhvilluar ekzaminime të plota dhe të pjesshme në 7 banka, në 10 subjekte financiare jobanka dhe në 31 zyra të këmbimit valutor. Vëmendja dhe burimet kryesore janë përqendruar në ekzaminimet e bankave, të cilat zënë peshën kryesore në aktivitetin e tregut financiar. Fokus të veçantë ka pasur tek bankat në procese blerjesh/bashkimi, apo bankat me ritëm të lartë rritjeje. Ndërkohë, ndër ekzaminimet e përmendura më lart për 5 banka, për 7 subjekte financiare jobanka dhe për 8 zyra të këmbimit valutor, ekzaminimet janë kryer në bashkëpunim me DPPPP dhe në një bankë është kryer në bashkëpunim me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare.

Tabelë 6. Numri i ekzaminimeve sipas viteve dhe sipas tematikës

Inspektime të kryera në subjekte	Rreziku Strategjik	Rreziku Organizativ	Rreziku i Kredisë	Rreziku i Likuiditetit	Rreziku i Normës së Interesit	Rreziku i Tregut	Teknologjia e Informacionit dhe e Komunikimit	Rreziku Operacional	Rreziku Reputacional	Përfitueshmëria	Kapitali
2016*	6	7	8	6	7	7	7	7	8	6	8
2017	9	12	13	10	10	9	11	8	11	10	11
2018	8	10	9	8	8	8	9	8	48	9	8

* *Në vitin 2016 janë kryer edhe 14 inspektime të përbashkëta me Agjencinë e Sigurimit të Depozitave (ASD) në shoqëri të kursim-kreditit, ku prania e Bankës së Shqipërisë ka qenë në mbështetje të ASD-së.*

Fushat kryesore në të cilat janë përqendruar rekomandimet e ekzaminimeve, gjatë vitit 2018, mund të përmblidhen si më poshtë.

- Rritja e rolit të Këshillit Drejtues gjatë hartimit të planeve strategjike (përfshirë planifikimin e nevojave për kapital), si dhe gjatë mbikëqyrjes së zbatimit të tyre.
- Sigurimi i raportit të duhur mes anëtarëve të varur dhe të pavarur të Këshillit Drejtues.
- Përshtatja dhe plotësimi i strukturës organizative, në përputhje me ritmet e rritjes së aktivitetit, dhe sigurimi i sistemeve të përshtatshme të motivimit dhe shpërblimit.
- Forcimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm, rritja e cilësisë së punës dhe pavarësisë së strukturave të kontrollit.
- Zbatimi i kujdesshëm i politikave të investimeve, duke shmangur instrumentet komplekse dhe që nuk kanë renditje të njohur.
- Trajtimi i kujdesshëm i grupeve të kredimarrësve të lidhur, si dhe forcimi i kritereve të pranueshmërisë gjatë analizave financiare të kredive; riklasifikimi i kredimarrësve dhe krijimi i fondeve rezervë shtesë.
- Thellimi i analizave lidhur me rrezikun e likuiditetit dhe rrezikun e normave të interesit.
- Rritja e mbështetjes nga Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit, forcimi i programit të sigurisë, vlerësimi i rregullt i rreziqeve, rishikimi i planit të vazhdimësisë së punës, shtimi i stafit etj.
- Zbatimi i saktë i kërkesave rregullative për llogaritjen e treguesve të kapitalit.
- Rritja e vëmendjes në drejtim të masave për PPP-në, aplikimi i sistemeve të automatizuara të kontrollit, trajnimi i stafit etj.

Bankat, në përgjithësi, kanë reaguar në kohën e duhur ndaj rekomandimeve, duke marrë masat përkatëse për të siguruar përputhshmërinë me kërkesat rregullative në çdo kohë.

Në lidhje me subjektet financiare jobanka, vëmendja gjatë vitit 2018 është përqendruar tek subjektet që janë pjesë e grupeve bankare, në funksion të vlerësimit të këtyre grupeve në mënyrë gjithëpërfshirëse. Rezultatet, në përgjithësi, kanë qenë pozitive, duke evidentuar një menaxhim të kujdesshëm të rreziqeve përmes të gjithë grupit, në përputhje me kufizimet rregullatore për palët e lidhura. Në fokusin mbikëqyrës, gjatë këtij viti, kanë qenë edhe subjektet e mikrokredisë dhe ato që ofrojnë shërbime të pagesave. Çështjet e evidentuara gjatë ekzaminimeve lidhen me riklasifikimin e portofolit të kredive dhe efektet përkatëse në pasqyrat financiare, menaxhimin e rrezikut nga pozicionet e hapura valutore, përmirësimin e kuadrit të brendshëm të qeverisjes, sistemeve të kontrollit të brendshëm etj. Procesi mbikëqyrës në vend për këto subjekte është fokusuar edhe në vlerësimin e nivelit të transparencës me klientët ku është konstatuar se subjektet me eksperiencë të konsoliduar në treg përgjithësisht paraqesin një nivel më të lartë transparence dhe vëmendjeje ndaj ankesave të klientëve. Subjektet më të reja, edhe pse janë kujdesur për respektimin e kërkesave ligjore dhe rregullatore, kanë hapësira për të përmirësuar nivelin e transparencës. Në përfundim të ekzaminimeve janë lënë rekomandime për përmirësimet e nevojshme.

Pjesë e procesit mbikëqyrës është edhe ndjekja e zbatimit të rekomandimeve, si dhe reagimi i shpejtë në rastet e identifikimit të rreziqeve potenciale apo të shkeljeve të treguesve të raportuar nga subjektet banka dhe jobanka. Edhe gjatë vitit 2018, krahas ekzaminimeve në vend, ka pasur korrespondenca e kontakte të shpeshta me të gjitha subjektet, në përgjigje të ngjarjeve apo zhvillimeve me potencial ndikimi në gjendjen financiare të tyre, shoqëruar me masa dhe kërkesa specifike mbikëqyrëse. Banka e Shqipërisë ka qenë e vëmendshme edhe ndaj zhvillimeve ndërkombëtare ku, për vitin e kaluar, evidentohet kriza e Turqisë, për të cilën janë marrë masa kufizuese e parandaluese për bankat me ekspozime në këtë vend.

2.4.3. RISHIKIMI I KUADRIT RREGULLATIV DHE METODOLOGJIK

Nëpërmjet rishikimit të kuadrit rregullativ mbikëqyrës, edhe gjatë vitit 2018, Banka e Shqipërisë synoi plotësimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të tij, me qëllim sigurimin e një mbikëqyrjeje më efektive dhe në zbatim të kërkesave ligjore. Rishikimi i kuadrit rregullativ u bazua në përafrimin e zhvillimeve më të fundit në aktet ligjore e rregullative të Bashkimit Evropian (BE) dhe të dokumenteve të Bazelit, si dhe duke konsideruar çështjet e identifikuara nga mbikëqyrësit, gjatë mbikëqyrjes së subjekteve, dhe sugjerimet e sjella nga këto të fundit, në kuadër të komunikimit të vazhdueshëm me to.

Në vijim paraqiten disa nga ndryshimet kryesore rregullative gjatë vitit 2018.

- U miratuan disa ndryshime në rregulloren "Për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekare", me qëllim përshtatjen e mëtejshme me kërkesat e

Direktivës 2014/17 të BE-së, të cilat synuan forcimin në vazhdimësi të kërkesave mbikëqyrëse për mbrojtjen e konsumatorëve. Ndryshimet përcaktuan kërkesa shtesë respektivisht për ekzistencën e së drejtës së konsumatorit për zëvendësimin e kolateralit me një kolateral tjetër, kundrejt plotësimit të disa kushteve; për ofrimin nga banka të mundësive/alternativave (nëse ekzistojnë), për zbutjen e rrezikut të kursit të këmbimit për konsumatorin; për parashikimin e së drejtës së konsumatorit për të kërkuar konvertimin e kredisë në monedhën në të cilën gjeneron të ardhurat, nëse plotësohen kushtet bazuar në analizat apo vlerësimet e bankës; për paraqitjen e një shembulli ilustrues për konsumatorin, si pjesë të informacionit parakontraktor, për ta ndërgjegjësuar atë për rrezikun e kursit të këmbimit etj.

– Në kuadër të nismës së Bankës së Shqipërisë për rritjen e përdorimit të monedhës kombëtare dhe uljen e përdorimit të valutave (deeuroizimin) në sistemin financiar shqiptar, u miratuan disa ndryshime në rregulloret e mbikëqyrjes:
  - në rregulloren "Për administrimin e rrezikut të likuiditetit", ndryshimi konsistoi në rritjen e nivelit minimal të kërkuar, për treguesin e aktiveve likuide ndaj pasiveve afatshkurtra në monedhë të huaj, nga 15% në 20%, ndërkohë që mbeti i pandryshuar niveli minimal i këtij treguesi, për monedhën kombëtare (15%) dhe për totalin (20%); dhe
  - në rregulloren "Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare", ndryshimet konsistuan në shtimin e kërkesës për ofrimin nga ana e bankës të një kredie alternative dhe të krahasueshme në monedhën në të cilën klienti gjeneron të ardhurat, për klientin që aplikon për një kredi në monedhë të ndryshme, bazuar në vlerësimin e bankës mbi pamjaftueshmërinë e kapaciteteve të tij për t'u mbrojtur nga rreziku i kursit të këmbimit, si dhe në paraqitjen e një shembulli ilustrues për kredimarrësin (në momentin e aplikimit për kredi). Kjo e fundit i shërben ndërgjegjësimit të klientit mbi rrezikun që paraqet për të, huamarrja në valutë.

– Disa ndryshime u miratuan në rregulloren "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit", të cilat lidhen me shfuqizimin e pjesës së mbetur të paketës së masave kundërciklike të vendosura për bankat në vitin 2013.
– Departamenti i Mbikëqyrjes, me qëllim përafrimin në vazhdimësi me direktivën dhe rregulloren evropiane për veprimtarinë e institucioneve të kreditit dhe me standardet e Komitetit të Bazelit për mbikëqyrjen efektive, ka përfunduar hartimin e projektrregullores së re "Për raportin e mbulimit me likuiditet", e cila synon prezantimin e një treguesi të ri për likuiditetin në kuadrin rregullativ të Bankës së Shqipërisë. Projektrregullorja u konsultua edhe me sistemin bankar dhe pritet të miratohet në fillim të vitit 2019.
– Në kuadrin e iniciativave rregullative që synojnë reduktimin e kredive me probleme, u hartua projektrregullorja "Për trajtimin jashtëgjyqësor nga bankat të kredimarrësve në vështirësi financiare", së bashku me

disa ndryshime në rregulloren "Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja". Këto dokumente u diskutuan edhe me industrinë bankare. Banka e Shqipërisë mbetet e angazhuar të vijojë më tej me miratimin e tyre në vitin 2019.

- Gjatë vitit u punua për hartimin e udhëzimit "Mbi stres-testet e bankave". Projekti i parë i dokumentit, i përmbyllur në fund të vitit 2018, është aktualisht në fazën e konsolidimit dhe dërgimit për opinion pranë sistemit bankar brenda 3-mujorit të parë të vitit 2019. Ky dokument përcakton kërkesat dhe metodologjitë për kryerjen e stres-testeve nga bankat, si pjesë e rëndësishme e procesit të administrimit të rrezikut dhe në kuadër të procesit të vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit. Hartimi i këtij udhëzimi bazohet në dispozitat e udhëzuesit të Autoritetit Bankar Evropian (EBA) mbi përgatitjen e stres-testeve nga bankat.
- Gjatë vitit 2018, u realizuan edhe disa ndryshime rregullative në rregulloren "Për kapitalin rregullator të bankës", të cilat synonin përafrimin e kërkesave të Bankës së Shqipërisë me kërkesat e Bazel III për raportet e kapitalit, që do t'i paraprijnë vendosjes në të ardhmen nga autoriteti, të kërkesave për rezervat shtesë të kapitalit të bankave. Gjithashtu, në vazhdimësi të plotësimit të akteve nënligjore për ndërhyrjen e hershme në zbatim të detyrimeve të ligjit për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, janë finalizuar projektet e akteve rregullative që parashikojnë kërkesat e autoritetit mbikëqyrës "Për përcaktimin e kushteve për dhënien e miratimit paraprak për marrëveshjen e mbështetjes financiare brenda grupit bankar" dhe "Për përcaktimin e kushteve kur zbatohen masat e ndërhyrjes së hershme dhe të kushteve dhe mënyrës së kryerjes së administrimit të përkohshëm", të cilat janë në proces konsultimi me ekspertët e Bankës Botërore (*FinSAC project*), ndërsa po rishikohen dhe kërkesat rregullative për bankën urë.

2.4.4. KUADRI LICENCUES DHE MIRATIMET

Edhe gjatë vitit 2018, sektori bankar shqiptar vazhdoi të mbizotërohet nga filialet e grupeve të huaja bankare, me origjinë të kapitalit nga Bashkimi Evropian. Krahasuar me vitin 2017, numri i bankave u reduktua në 14 nga 16 banka që operonin në fund të vitit të kaluar, si rezultat i revokimit të licencave të dy bankave, pas përfundimit të procesit të bashkimit me përthithje të tyre nga dy banka ekzistuese të sistemit.

Tabelë 7. Struktura e pronësisë së bankave (numri i bankave, fund i periudhës)

	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Bankat në Shqipëri, prej të cilave:	16	16	16	16	16	14
Degë të bankave të huaja	-	-	-	-	-	-
Struktura e pronësisë së bankave, sipas origjinës së kapitalit, prej të cilave:						
Me kapital privat në shumicën e pronësisë të huaj[1]	14	14	13	13	13	11
- nga vendet e Bashkimit Evropian	10	10	9	9	9	7[2]
- nga Turqia	1	1	1	1	1	1[3]
- nga një institucion financiar ndërkombëtar (Arabia Saudite)	1	1	1	1	1	1[4]
- nga Kuvajti	1	1	1	1	1	1[5]
- nga Konfederata e Zvicrës	1	1	1	1	1	1[6]
Me kapital privat me shumicën e pronësisë vendase	2	2	3	3	3	3[7]

1 *"Shumicë" është në çdo rast shumica e thjeshtë e 50% të votave plus 1 votë.*
2 *Bankat me origjinë kapitali nga vendet e BE-së janë nga: Italia (Banka Intesa Sanpaolo Albania), Austria (Banka Raiffeisen), Gjermania (Banka Procredit), Franca (Banka Societe Generale Albania), Greqia (Banka Tirana, Banka Alpha Albania), Bullgaria (Banka e Parë e Investimeve, Albania).*
3 *Banka Kombëtare Tregtare.*
4 *Banka e Bashkuar e Shqipërisë.*
5 *Banka e Kreditit të Shqipërisë.*
6 *Banka Ndërkombëtare Tregtare.*
7 *Bankat me shumicë kapitali vendas, në fund të vitit 2017, janë: Banka Union, Banka Credins dhe Banka Amerikane e Investimeve.*

Banka e Shqipërisë dha miratimet paraprake respektivisht për: transferimin e 100% të pronësisë së aksioneve të Bankës NBG Albania tek Banka Amerikane e Investimeve sh.a.; riorganizimin juridik të dy bankave nëpërmjet bashkimit me përthithje; hapjen e filialit të Bankës Credins sh.a. në Kosovë; shtimin e veprimtarisë financiare për një bankë për tregtimin e letrave me vlerë të transferueshme për llogari të saj; ndryshimet e statuteve të nëntë bankave; emërimet e auditorëve ligjorë të të gjitha bankave; dhe për emetimin ose shlyerjen e borxhit të varur të tre bankave etj.

Në zbatim të ndryshimeve të rregullores së administratorëve të bankave që lidhen, ndër të tjera, edhe me miratimin e administratorëve të bankave, përfshirë dhe rastet e zgjatjes së afatit të emërimit (riemërimit) në të njëjtin pozicion, gjatë vitit që analizojmë, pati një rritje në numrin e aplikimeve të bankave për miratime të administratorëve. Banka e Shqipërisë dha miratimin për 59 administratorë të bankave, të cilët sipas pozicioneve renditen respektivisht në: 31 anëtarë të këshillave drejtues;13 anëtarë të komiteteve të kontrollit; dhe 15 drejtues ekzekutivë dhe drejtues të kontrollit të brendshëm të bankës.

Gjatë vitit 2018, rrjeti i bankave brenda territorit të Republikës së Shqipërisë u zgjerua me 5 degë të reja, ndërkohë që bankat kanë sjellë njoftime për reduktimin e numrit të degëve/agjencive brenda vendit (nëpërmjet mbylljes, bashkimit) për 30 degë/agjenci brenda vendit, dhe për transformimin e degës në Kosovë të Bankës Kombëtare Tregtare në filial të saj. Në fund të vitit 2018,

bankat ushtrojnë veprimtarinë e tyre nëpërmjet 447 degëve/agjencive bankare nga 473 degë/agjenci që rezultonin në fund të vitit 2017.

Mbështetur në aplikimet e paraqitura, Banka e Shqipërisë pajisi me licencë një institucion të parasë elektronike (Unioni Financiar Tiranë), revokoi licencën e dy subjekteve financiare jobanka - respektivisht të Vodafone M-Pesa, sipas kërkesës së vetë subjektit, dhe të Unionit Financiar Tiranë, pas licencimit si Institucion i Parasë Elektronike - dhe dha miratime paraprake për subjektet financiare jobanka. Në fund të vitit 2018 ushtrojnë veprimtari financiare 30 subjekte financiare jobanka të licencuara. Ndërkohë, pjesë e miratimeve për subjektet financiare jobanka kanë qenë miratimet paraprake për 10 administratorë, miratimet për ushtrimin e veprimtarive financiare shtesë për tre subjekte dhe miratimi për transferimin e pjesëmarrjes influencuese të kuotave të kapitalit tek një subjekt financiar jobankë.

Në fund të vitit 2018 numërohen 13 shoqëri të kursim-kreditit dhe një union i shoqërive të kursim-kreditit.

Licencimi i zyrave të këmbimit valutor vijoi edhe në vitin 2018, me dhënien e 58 licencave të reja dhe revokimin e licencës për 21 zyra të këmbimit valutor për arsye të statusit joaktiv të tyre në Qendrën Kombëtare të Biznesit, të pezullimit të veprimtarisë për më shumë se dy muaj dhe të moszbatimit të kërkesave raportuese pranë Bankës së Shqipërisë, apo edhe me kërkesë të subjekteve për arsye të mbylljes së aktivitetit. Në fund të vitit 2018, në tregun e këmbimeve valutore ushtrojnë aktivitetin 463 zyra të këmbimit valutor.

Tabelë 8. Numri i bankave, subjekteve financiare jobanka, shoqërive të kursim – kreditit dhe zyrave të këmbimit valutor të licencuara nga Banka e Shqipërisë (fund i periudhës)

	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Banka dhe degë të bankave të huaja	16	16	16	16	16	14
Subjekte financiare jobanka	21	22	27	28	31	30
Zyra të këmbimit valutor	333	356	397	428	426	463
Unione të shoqërive të kursim-kreditit	2	2	2	2	1	1
Shoqëri të kursim-kreditit	121	113	111	13	13	13

Burimi: Banka e Shqipërisë.

2.5. NDËRHYRJA E JASHTËZAKONSHME

Mbështetur në ligjin nr. 133/2016 "Mbi rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë", Banka e Shqipërisë është Autoritet i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme për bankat dhe degët e bankave të huaja që ushtrojnë aktivitetin e tyre në vend.

Në cilësinë e Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, gjatë vitit 2018, Banka e Shqipërisë ka përmbushur mandatin e saj në këtë funksion, duke plotësuar objektivat e përcaktuar në përputhje me kërkesat ligjore. Në këtë drejtim është hartuar kuadri rregullator dhe procedural për planifikimin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, duke synuar harmonizimin me standardet teknike ndërkombëtare. Nga ana tjetër, ka filluar faza e parë e hartimit të planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, duke përcaktuar strategjinë e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, që mundëson vazhdimësinë e funksioneve kritike të bankës dhe ruajtjen e stabilitetit financiar.

Kuadri rregullator është plotësuar edhe me dy rregullore të reja të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë për arritjen e objektivave operacionalë të vendosur si prioritete për funksionin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Gjithashtu, gjatë vitit 2018 është themeluar Fondi i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme dhe është ngritur procedura për monitorimin e administrimit të tij duke thelluar marrëdhëniet e bashkëpunimit me Agjencinë e Sigurimit të Depozitave. Banka e Shqipërisë ka zgjeruar marrëdhëniet bashkëpunuese edhe me institucionet evropiane nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit me Bordin e Përbashkët të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme – SRB.

2.5.1. PLOTËSIMI I KUADRIT RREGULLATOR DHE METODOLOGJIK

Në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr.133/2016 "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë", gjatë vitit 2018 është miratuar:

a. Rregullorja nr. 31/2018 "Për planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme". Rregullorja përcakton përmbajtjen e planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme që hartohen nga Banka e Shqipërisë si Autoritet i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, për çdo bankë apo grup bankar që vepron në vend. Gjithashtu, ajo identifikon tërësinë e informacionit dhe të dhënat e nevojshme që bankat duhet të dërgojnë pranë Bankës së Shqipërisë, për mbështetjen e planifikimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Në këtë drejtim, Banka e Shqipërisë përpiloi disa formularë të standardizuar, si dhe një udhëzues të detajuar për të lehtësuar procesin e mbledhjes së të dhënave;
b. Rregullorja nr. 43/2018 "Për bashkëpunimin ndërmjet Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Departamentit për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme".

Banka e Shqipërisë është njëherazi Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme dhe Autoriteti Mbikëqyrës për bankat që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Shqipëri. Këto dy funksione, ajo i ushtron nëpërmjet dy njësive organizative të ndryshme brenda saj, me linja të veçanta raportimi dhe varësie, duke siguruar pavarësinë e tyre në vendimmarrjet përkatëse. Punonjësit e njësive organizative, të cilat përgjigjen për ushtrimin e funksionit mbikëqyrës dhe funksionit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, bashkëpunojnë në mënyrë efektive për hartimin, planifikimin dhe zbatimin e vendimeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Rregullorja përcakton mënyrat e bashkëpunimit ndërmjet këtyre dy njësive, shkëmbimin e informacionit, si dhe detyrat e përgjegjësitë përkatëse në përmbushjen e objektivave për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka.

c. Gjatë vitit 2018 është hartuar dhe është në proces konsultimi rregullorja "Vlerësimi për qëllime të ndërhyrjes së jashtëzakonshme", në të cilën përcaktohen kushtet dhe mënyra e përzgjedhjes së vlerësuesit të pavarur për qëllime të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, si dhe metodologjitë përkatëse të vlerësimit dhe të përcaktimit të vlerës së detyrimeve që rrjedhin nga produktet derivative.

Hartimi i metodologjive për përmbushjen e objektivave të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, gjatë vitit 2018, është plotësuar me:

a. Udhëzuesin "Për identifikimin e funksioneve me rëndësi kritike dhe veprimtarive kryesore nga sektori bankar". Identifikimi i funksioneve me rëndësi kritike dhe veprimtarive kryesore që kryen banka, është mjaft i rëndësishëm në procesin e hartimit të planeve të rimëkëmbjes dhe të ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Plani i rimëkëmbjes (që hartohet nga banka) përfshin identifikimin e funksioneve me rëndësi kritike dhe veprimtarive kryesore përmes vetëvlerësimit të bankës, ndërsa plani i ndërhyrjes së jashtëzakonshme që hartohet nga Banka e Shqipërisë, përshkruan se si funksionet me rëndësi kritike dhe veprimtaritë kryesore mund të ndahen ligjërisht dhe ekonomikisht nga funksionet e tjera, në mënyrë që të sigurohet vazhdimësia e tyre edhe pas ndërhyrjes në bankë. Ky udhëzues synon të specifikojë kriteret për përcaktimin dhe identifikimin e funksioneve kritike përmes vetëvlerësimit të bankave, si dhe kriteret për përcaktimin e veprimtarive kryesore dhe shërbimeve të lidhura sipas të njëjtës përqasje.

b. "Udhëzimet për plotësimin e kërkesës për mbledhjen e informacionit të nevojshëm për hartimin e planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme". Kërkesat mbi mbledhjen e informacionit si dhe udhëzimet e trajtuara në këtë dokument, janë hartuar në zbatim të rregullores "Mbi planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme". Përmes formularëve të hartuar për këtë qëllim, synohet të mblidhet informacion lidhur me qeverisjen dhe menaxhimin e bankës, veprimtaritë kryesore të saj, strukturën e pasiveve, kolateralet e vendosura, zërat jashtë bilancit, sistemet e përdorura nga banka për kryerjen e pagesave, klerimit dhe shlyerjes, sistemet e informacionit, ndërlidhjet dhe ndërvarësitë financiare dhe të tjera, si

dhe marrëveshjet kontraktuale që mund të ndikojnë dhe ndikohen nga veprimet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

2.5.2. THEMELIMI DHE MONITORIMI I FONDIT TË NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME

Në zbatim të kërkesave ligjore dhe të dispozitave të rregullores nr. 56/2017 "Mbi Fondin e Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme dhe procedurat për administrimin e tij", Banka e Shqipërisë përllogariti nivelin e synuar të fondit dhe kontributin vjetor të çdo banke, bazuar në pasqyrat financiare të vitit 2016.

- Niveli i synuar i "Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme", i llogaritur me të dhënat e bilanceve të audituara të sektorit bankar për periudhën dhjetor 2016, është 6 miliardë lekë.
- Niveli vjetor i "Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme", për vitin e parë të kontributit, është 632 milionë lekë dhe i llogaritur proporcionalisht sipas peshës së secilës banke në detyrimet e sektorit bankar, të përcaktuara si diferencë midis aktiveve dhe kapitalit rregullator.

Fondi i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme u themelua në janar 2018 me kryerjen e pagesës së pjesës së parë të kontributit vjetor nga ana e sektorit bankar. Në muajin prill 2018, u finalizua edhe pagesa e këstit të dytë të kontributit. Fondi administrohet nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave në përputhje me dokumentin "Politika e Administrimit të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme". Ai monitorohet mbi baza tremujore nga Banka e Shqipërisë kundrejt kufijve të vendosur në dokumentin e mësipërm për likuiditetin, afatin e maturimit të instrumenteve, agjencive emetuese, monedhave të investimit, për të siguruar likuiditetin e nevojshëm dhe sigurinë e Fondit në përputhje me kërkesat ligjore.

2.5.3. PLANIFIKIMI I NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME

Si një nga shtyllat kryesore të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme synojnë të lehtësojnë përdorimin efektiv të instrumenteve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme nga ana e Bankës së Shqipërisë. Banka e Shqipërisë ka filluar procesin e hartimit të planeve individuale të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe përcaktimin e strategjisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme për bankat individuale dhe grupet bankare që veprojnë në Shqipëri. Në këtë kuadër, është realizuar hapi i parë i planifikimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme nëpërmjet identifikimit të funksioneve me rëndësi kritike. Identifikimi i funksioneve me rëndësi kritike për çdo bankë është një detyrë e rëndësishme në procesin e planifikimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, pasi ruajtja e vazhdimësisë së funksioneve kritike përbën një nga objektivat kryesorë të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

HAPËSIRË INFORMUESE 7: FUNKSIONET ME RËNDËSI KRITIKE

Bankat kryejnë një tërësi funksionesh ekonomike, të cilat janë të rëndësishme për tregjet financiare dhe ekonominë reale në tërësi. Këtu mund të përmendim funksionin e pranimit të depozitave, atë të dhënies së kredisë, shlyerjen e pagesave etj. Identifikimi i funksioneve ekonomike, të cilat janë kritike për ruajtjen e stabilitetit financiar, është një ndër objektivat kryesorë të ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Sipas përkufizimit të dhënë në ligjin nr. 133/2016 "Funksionet me rëndësi kritike" janë veprimtaritë, shërbimet ose operacionet e një banke, ndërprerja e të cilave mund të sjellë ndërprerjen e shërbimeve thelbësore për ekonominë reale ose mund të cenojë stabilitetin financiar për shkak të madhësisë dhe pjesës së tregut që ajo zë, ndërlidhjes së brendshme dhe të jashtme, kompleksitetit apo veprimtarive ndërkufitare të saj, duke marrë në konsideratë veçanërisht pamundësinë e zëvendësimit të këtyre veprimtarive, shërbimeve apo operacioneve në treg.

Sipas këtij përkufizimi, një funksion ekonomik konsiderohet me rëndësi kritike, nëse përmbush dy elementet e mëposhtme:

a. funksioni ofrohet nga një bankë ose një grup bankar, për palët e treta që nuk janë të lidhura me vetë bankën ose grupin bankar;
b. ndërprerja e papritur e funksionit mund të ketë ndikim të rëndësishëm në palët e treta, mund të krijojë efektin zinxhir negativ ose mund të dëmtojë besimin e përgjithshëm të pjesëmarrësve të tregut për shkak të rëndësisë sistemike që ka funksioni ekonomik për palët që e përdorin atë ose për shkak të rëndësisë sistemike që ka vetë banka ose grupi bankar që ofron funksionin.

Për vlerësimin e dy elementeve të prezantuara më lart, Banka e Shqipërisë ka hartuar metodologjinë e identifikimit të funksioneve kritike, që përfshin dy hapa.

1) Analiza e ndikimit të ndërprerjes së papritur të funksionit synon të vlerësojë sa ndikohet tregu financiar apo ekonomia reale nga ndërprerja e papritur e funksionit si në vijim.
a. Ndikimi në palët e treta që mbështeten në atë funksion: nëse ndërprerja e funksionit ka ndikim të drejtpërdrejtë negativ në një numër të vogël palësh të treta, të cilat nuk janë sistemike, atëherë funksioni nuk konsiderohet me rëndësi kritike.
b. Ndikimet sistemike dhe ndërlidhja: nëse ndërprerja e funksionit ka efekte negative të rëndësishme mbi ekonominë reale dhe tregjet financiare, përkatësisht në terma të efektit zinxhir dhe ndikimit në besimin e tregut, atëherë analiza orientohet si më poshtë:

- *nëse ndërprerja e funksionit ekonomik nga banka dëmton tregun përkatës ose pjesëmarrësit e tjerë të ekspozuar në atë treg apo të ndërlidhur me bankën, funksioni është kritik;*
- *nëse ndërprerja e funksionit ka ndikim në një gamë të gjerë dhe numër të lartë pjesëmarrësish të tregut dhe vetë tregu është i rëndësishëm për funksionimin e një tregu tjetër, funksioni është kritik. Në këtë rast është e rëndësishme të vlerësohet edhe sa mund të preket tregu nga humbja e përgjithshme e besimit në pjesëmarrësit e tij për shkak të ndërprerjes së funksionit. Humbja e besimit të tregut është më e mundshme në rastin e funksioneve më "të dukshme" ose të njohura publikisht tek klientët apo publiku (p.sh. shërbimet e pagesave për individët), duke rritur në këtë rast, kritikalitetin e këtij funksioni.*

2) Analiza e ofertës synon të vlerësojë nëse ka ofrues të ngjashëm në treg, të cilët mund ta zëvendësojnë funksionin kritik të ndërprerë nga banka. Nëse funksioni ekonomik dhe roli i tij mund të zëvendësohen lehtësisht nga pjesëmarrësit e tjerë të tregut (duke përfshirë ata që mund të hyjnë në treg), në madhësi dhe cilësi të krahasueshme, me kosto të pranueshme dhe brenda një afati të arsyeshëm kohor, atëherë ai nuk konsiderohet me rëndësi kritike. Kriteret bazë për vlerësimin e «zëvendësueshmërisë» janë struktura e tregut për funksionin ekonomik, si dhe disponueshmëria e ofruesve zëvendësues, që përfshin:

- *strukturën e përqendrimit të tregut, d.m.th numrin e pjesëmarrësve në treg (duke përfshirë peshën e tregut, numrin e konkurrentëve ose pjesëmarrësve të ngjashëm, të cilët janë në gjendje të ndërmarrin ofrimin e funksioneve kritike);*
- *vlerësimin nëse ekzistojnë funksione dhe tregje të tjera që ofrojnë një funksion ekonomik të barasvlershëm me veprimtarinë apo funksionin ekonomik të ndërprerë nga banka.*

Në bazë të modelit të biznesit të sektorit bankar në Shqipëri, bankat ofrojnë pesë funksione ekonomike, të cilat shërbejnë si pikënisje për vlerësimin e kritikalitetit të tyre. Këto funksione ekonomike janë:

a) pranimi i depozitave;
b) huadhënia dhe shërbimi i huasë;
c) pagesat, shlyerjet dhe kujdestaria;
d) aktivitetet e tregjeve të financimit me shumicë;
e) tregjet e kapitalit dhe investimi në instrumente të borxhit publik.

Gjatë vitit 2018, Banka e Shqipërisë ka identifikuar funksionet kritike për secilën bankë, duke përcaktuar edhe strategjinë e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, e cila mbështet vijueshmërinë e këtyre funksioneve dhe ruajtjen e stabilitetit financiar.

2.5.4. BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONE TË TJERA NDËRKOMBËTARE

Në cilësinë e Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, Banka e Shqipërisë hyn në marrëveshje bashkëpunimi me autoritetet e tjera përgjegjëse për ndërhyrjen e jashtëzakonshme të grupeve bankare ndërkufitare që veprojnë në Shqipëri. Nisur nga pesha e rëndësishme e bankave evropiane në aktivet e sektorit bankar shqiptar, në tetor 2018, u nënshkrua Marrëveshja e bashkëpunimit midis Bankës së Shqipërisë dhe Bordit të Përbashkët të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme - SRB[23], i cili është Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme për bankat dhe grupet bankare në Bashkimin Evropian.

Kjo marrëveshje ofron një platformë bashkëpunimi dhe shkëmbimi të informacionit për të dy institucionet, në lidhje me planifikimin dhe zbatimin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme për grupet bankare ndërkufitare. Marrëveshja e bashkëpunimit do të mbështesë dhe hartimin e planeve të koordinuara të ndërhyrjes së jashtëzakonshme për filialet e bankave evropiane që veprojnë në Shqipëri.

[23] *SRB – Single Resolution Board.*

Në muajin nëntor, Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim me Qendrën Këshilluese për Sektorin Financiar (FinSAC[24]) të Bankës Botërore, organizuan Konferencën Rajonale me temë "Planifikimi i rimëkëmbjes dhe ndërhyrjes së jashtëzakonshme". Në konferencë morën pjesë përfaqësues të nivelit të lartë të autoriteteve mbikëqyrëse dhe të ndërhyrjes së jashtëzakonshme të Bashkimit Evropian, të vendeve të rajonit dhe të bankave tregtare të vendit tonë. Diskutimet trajtuan çështje të tilla si zhvillimet e deritanishme të rimëkëmbjes dhe ndërhyrjes së jashtëzakonshme në Bashkimin Evropian, sfidat për zbatimin e tyre në rajon, eksperiencat e bankave qendrore dhe autoriteteve të ndërhyrjes në hartimin dhe vlerësimin e planeve të rimëkëmbjes dhe të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, si dhe bashkëpunimi dhe koordinimi midis autoriteteve përgjegjëse.

2.6. EMETIMI I MONEDHËS

Banka e Shqipërisë ka të drejtën ekskluzive të nxjerrjes e të qarkullimit të monedhës kombëtare "Lek". Ajo përcakton format, peshat, masat, modelin dhe karakteristikat e tjera të kartëmonedhave dhe monedhave metalike shqiptare me kurs ligjor brenda vendit, si edhe të monedhave e kartëmonedhave që shtypen për qëllime numizmatike.

KARTËMONEDHA NË QARKULLIM[25]

Në fund të vitit 2018, në qarkullim rezultuan 136,447,888 copë kartëmonedha me vlerë rreth 281.3 miliardë lekë. Në krahasim me vitin 2017, numri i kartëmonedhave në qarkullim është rritur me rreth 1.6%, ndërsa në vlerë është rritur me 4.1%. Ndryshimi i këtyre treguesve vjen si pasojë e trendit që vazhdon të ndjekë struktura e parasë në qarkullim, në favor të kartëmonedhave me vlerë nominale 5000 Lekë dhe 2000 Lekë. Vlera mesatare e një kartëmonedhe në

Grafik 29. Struktura e kartëmonedhës në qarkullim



Burimi: Banka e Shqipërisë.

[24] *FinSAC – Financial Sector Advisory Center.*
[25] *Është numri dhe vlera e kartëmonedhave të hedhura në qarkullim nga Banka e Shqipërisë.*

qarkullim në fund të vitit 2018 arriti në 2,062 lekë, nga 2,012 lekë që ishte në fund të vitit 2017.

Monedha metalike në qarkullim

Në fund të vitit 2018, në qarkullim rezultuan 198,670,092 copë monedha metalike me vlerë 4.8 miliardë lekë. Në krahasim me vitin 2017, rezulton një rritje e numrit të monedhave metalike me 7.9% dhe një rritje e vlerës së tyre me 8.6%.

Grafik 30. Struktura e monedhës metalike në qarkullim



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tregues të qarkullimit të parasë

Raporti i parasë në qarkullim ndaj agregatit M2 ishte 39.741%[26] në fund të vitit 2018, nga 37.173% në fund të vitit 2017. Koeficienti i qarkullimit të parasë[27] rezultoi 0.404 në vitin 2018, ndërkohë që ky koeficient ishte 0.432 për vitin 2017.

Riciklimi i cash-it dhe cilësia e kartëmonedhës në qarkullim

Gjatë vitit 2018, u përpunuan rreth 106.9 milionë kartëmonedha, të cilat u kontrolluan për autenticitet dhe përshtatshmëri për riqarkullim. Nga përpunimi rezultuan rreth 25.9 milionë kartëmonedha të papërshtatshme, të cilat u tërhoqën nga qarkullimi. Norma e sortimit[28] ishte 24.3%. Kartëmonedhat e papërshtatshme për qarkullim janë zëvendësuar me kartëmonedha të reja të përshtatshme për qarkullim.

---

[26] *Sqarim: është përdorur vlera për agregatin M2 bazuar në të dhënat paraprake zyrtare të publikuara deri në fund të vitit 2018.*

[27] *Është raporti i numrit të kartëmonedhave dhe monedhave metalike të arkëtuara në sportelet e Bankës së Shqipërisë mbi gjendjen mesatare vjetore të numrit të kartëmonedhave dhe monedhave në qarkullim.*

[28] *Është raporti i numrit të kartëmonedhave dhe monedhave metalike të papërshtatshme për qarkullim, mbi numrin total të kartëmonedhave të përpunuara gjatë një viti.*

Koeficienti i qarkullimit të kartëmonedhës[29] për vitin 2018 rezultoi në vlerën 0.80, që do të thotë se një kartëmonedhë kthehet mesatarisht më pak se një herë në vit në sportelet e Bankës së Shqipërisë. Ky koeficient është më i lartë për prerjet 500 Lekë, 1000 Lekë (përkatësisht, rreth 1.51 dhe 1.17) dhe më i vogël për prerjet 5000 Lekë dhe 2000 Lekë (rreth 0.164 dhe 0.728).

Studimi i strukturës dhe tematikave të parasë në qarkullim

Objektivat e Bankës së Shqipërisë në fushën e emisionit përfshijnë përmirësimin e cilësisë së kartëmonedhave në qarkullim, rritjen e angazhimit për mbrojtjen nga falsifikimi, si dhe rishikimin e tematikave, dizenjos dhe elementeve të sigurisë në serinë e kartëmonedhave shqiptare me kurs ligjor. Gjatë vitit 2018, ka vazhduar puna me konkretizimin e përcaktimit të dizajnit dhe elementeve të sigurisë të serisë së kartëmonedhave.

Mbrojtja e kartëmonedhës dhe monedhës metalike nga falsifikimi

Në kuadër të mbrojtjes së monedhave nga falsifikimi, edhe përgjatë vitit 2018, Banka e Shqipërisë ka vlerësuar të nevojshëm rritjen dhe përforcimin e mëtejshëm të kapaciteteve tekniko-administrative të strukturës së saj të dedikuar për ushtrimin e funksioneve në këtë fushë. Përveç kësaj, kanë vijuar të organizohen aktivitete të ndryshme me natyrë parandaluese, të fokusuara kryesisht në trajnimin e vazhdueshëm të stafeve profesioniste të *cash*-it, inspektimet, procesin e testimit dhe monitorimit të makinave/pajisjeve autentifikuese dhe sortuese të përdoruara nga stafi etj.

Gjatë vitit 2018, sasia e kartëmonedhave dhe e monedhave metalike të falsifikuara, të zbuluara në qarkullim ka pësuar ulje të konsiderueshme me 21% krahasuar me vitin 2017. Sasia e falsifikimeve mbetet e papërfillshme krahasuar me sasinë e kartëmonedhave dhe monedhave metalike të rregullta në qarkullim. Sa i përket strukturës së kartëmonedhave të falsifikuara, ndryshe nga vitet e kaluara, në pjesën më të madhe të totalit të tyre mbizotëron prerja 2000 Lekë, e pasuar nga prerja 1000 Lekë dhe prerja 500 Lekë. Ndër monedhat metalike të falsifikuara, identifikohet prerja 50 Lekë (113 copë), me tendencë zvogëlimi krahasuar me vitet e mëparshme.

Grafik 31. Trendi i kartëmonedhave të falsifikuara në vite (për copë)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Nga aspekti teknik dhe/ose teknologjik, fenomeni i falsifikimit të kartëmonedhave kombëtare, mbizotërohet nga riprodhimet me teknikë bazë printimet digjitale me ngjyra, kryesisht ink-jet, të shoqëruara me aplikimin e metodave artizanale shtesë për imitimin e elementeve dhe/ose tipareve të sigurisë, kryesisht për publikun, me natyrë vizuale dhe ato të prekjes. Indeksi i vlerësimit të ngjashmërisë me kartëmonedhat e vërteta me kurs ligjor është i ulët, që do të

[29] *Është raporti i numrit të kartëmonedhave të arkëtuara në sportelet e Bankës së Shqipërisë mbi gjendjen mesatare vjetore të numrit të kartëmonedhave në qarkullim.*

thotë se kartëmonedhat e falsifikuara vlerësohen me rrezikshmëri të ulët për t'u pranuar si të vërteta. Imitime të elementeve të sigurisë të lexueshme nga pajisjet autentifikuese/sortuese tek kartëmonedhat e falsifikuara ndeshen në pak raste.

2.7. SISTEMET E PAGESAVE

Në përmbushje të përgjegjësisë së saj ligjore në fushën e sistemeve të pagesave, Banka e Shqipërisë i ka kushtuar vëmendje të veçantë garantimit të sigurisë dhe efikasitetit të infrastrukturës bazë të pagesave në lekë, si nëpërmjet rolit të saj si operator i sistemit, ashtu edhe nëpërmjet rolit si mbikëqyrës dhe katalizator. Përtej konsolidimit të rolit mbikëqyrës në sistemet dhe shërbimet e pagesave dhe shtrirjes së proceseve mbikëqyrëse edhe në fushën e sistemeve të shlyerjes së titujve, gjatë vitit 2018, përpjekje të veçanta i janë kushtuar dhe rolit reformator. Në këtë kuadër, Banka e Shqipërisë nëpërmjet Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave ka miratuar Strategjinë Kombëtare për Pagesat me Vlerë të Vogël në Shqipëri (2018-2023).

2.7.1. MBIKËQYRJA E SISTEMEVE TË PAGESAVE

Banka e Shqipërisë, në kuadër të rolit mbikëqyrës të sistemeve të pagesave dhe instrumenteve të pagesave si pjesë përbërëse e këtyre sistemeve, ka ndërmarrë një sërë masash për përmirësimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor dhe rregullativ përgjatë vitit 2018. Me qëllim përafrimin me praktikat evropiane në treg është rishikuar rregullorja "Për instrumentet e pagesave elektronike". Ky rishikim synon të akomodojë inovacionin në fushën e pagesave me kartë dhe kryesisht mënyrën e shpërndarjes së PIN me mjete elektronike të komunikimit. Për më shumë, nëpërmjet miratimit të Rregullores "Politika e mbikëqyrjes së sistemeve të pagesave dhe të shlyerjes" synohet zbatimi i praktikave evropiane mbi klasifikimin e sistemeve, duke krijuar hapësira për iniciativat private dhe duke shmangur kërkesa mbikëqyrëse tejet kërkuese për sistemet, të cilat nuk paraqesin rëndësi sistemike për tregun shqiptar.

Në kuadër të zhvillimeve në tregun e titujve, përgjatë vitit 2018, Banka e Shqipërisë ka hartuar dhe nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, me qëllim licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e infrastrukturave për klerim dhe shlyerje të titujve. Kjo marrëveshje ka krijuar parakushtet për hartimin e projektrregullores "Për rregullimin, licencimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve për shlyerjen e titujve", e cila parashikohet të miratohet brenda gjashtëmujorit të parë të vitit 2019.

Në drejtim të përmirësimit të kuadrit ligjor, si një nga boshtet e objektivave të strategjisë së Bankës së Shqipërisë dhe Strategjisë Kombëtare për Sistemin e Pagesave me Vlerë të Vogël (2018-2023), Banka e Shqipërisë ka punuar për transpozimin e direktivës së rishikuar të Bashkimit Evropian 2015/2366 në

projektligjin "Për shërbimet e pagesave" (PSD2). Miratimi dhe zbatimi i këtij projektligji vlerësohet se do të ndikojë drejtpërdrejt në nxitjen e konkurrencës dhe inovacionit në fushën e pagesave me vlerë të vogël, duke promovuar kështu efikasitetin e tyre dhe reduktimin e kostove, që mbart përdorimi i tyre. Projektligji në fjalë synon të balancojë hapësirat për ofrimin e shërbimeve të pagesave midis bankave dhe institucioneve financiare jobanka, duke i lejuar këto të fundit të hapin llogari pagese dhe të emetojnë instrumente elektronike pagesash. Projektligji vlerësohet të rrisë transparencën në shërbimet e ofruara nga tregu dhe të krijojë një kuadër të konsoliduar për mbrojtjen e konsumatorit. Banka e Shqipërisë ka finalizuar hartimin e këtij akti dhe konsultimin me aktorët e tregut përgjatë vitit 2018, dhe është duke vijuar me hapat e tjerë proceduralë deri në miratimin e tij nga Kuvendi.

2.7.2. ROLI REFORMATOR - KOMITETI KOMBËTAR I SISTEMIT TË PAGESËS

Me qëllim promovimin e zhvillimeve në fushën e sistemeve të pagesave, Banka e Shqipërisë, edhe gjatë vitit 2018, ka luajtur një rol tejet aktiv në zhvillimin e aktiviteteve të cilat nxisin thellimin e njohurive dhe veprimet e aktorëve të ndryshëm në treg. Ndër aktivitetet më të rëndësishme në këtë drejtim përmendim:

1. Projektin Greenback. Banka Botërore, në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë, ka organizuar dy aktivitete në kuadër të prezantimit (mars 2018) dhe zbatimit (dhjetor 2018) të Projektit Greenback në qytetin e Beratit, i financuar nga SECO (*Swiss State Secretariat for Economic Affairs*) si pjesë e programit për Remitancat dhe Pagesat;
2. pjesëmarrjen në datën 4 maj 2018 në Forumin e Kartave, organizuar nga Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB), me temë: *"Rritja e përdorimit të kartës si instrument pagese"*, me qëllim orientimin e aktorëve të tregut mbi zhvillimet e pritshme nga ana e Bankës së Shqipërisë në këtë treg;
3. organizimin e mbledhjes IV të Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave, në datën 20 qershor 2018 (më shumë informacion gjendet në seksionin në vijim).
4. organizimin e Konferencës *"Modernizimi i Pagesave me Vlerë të Vogël në Shqipëri"*, në datën 21 qershor 2018, me qëllim promovimin e vizionit dhe të masave të Strategjisë Kombëtare për Tregun e Sistemeve të Pagesave me Vlerë të Vogël (2018-2023). Pjesëmarrës në konferencë ishin përfaqësues nga institucione me rëndësi, kryesisht nga banka qendrore homologe, si Banka Qendrore Evropiane (BQE), Banka e Italisë (BI), Banka Botërore (BB), Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQRK), Banka Qendrore e Serbisë (BQS), por edhe nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE), Shoqata Shqiptare e Bankave (SHSHB), kompani vendase të licencuara nga Banka e Shqipërisë në fushën e pagesave, si dhe kompani të tjera ndërkombëtare;

5. në bashkëpunim me Bankën Botërore, organizimin e *Workshop*-it *"Parimet e mbikëqyrjes së infrastrukturave të tregjeve financiare të Bankës Ndërkombëtare për Rregullim"* (qershor 2018), në të cilin morën pjesë edhe përfaqësues nga Banka Qendrore e Kosovës dhe nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Shqipërisë dhe Kosovës;
6. *Workshop*-in rajonal për Ballkanin Perëndimor me temë *"Promovimi i harmonizimit të kuadrit ligjor dhe rregulativ me legjislacionin e BE-së për pagesat me vlerë të vogël"*.

Mbledhja IV e Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave

Roli i Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave ka qenë tejet aktiv gjatë vitit 2018. Kështu, në datën 20 qershor 2018, u mbajt mbledhja e katërt e Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave, në të cilën u finalizuan dhe u bënë publike një sërë projektesh të ndërmarra nga ky komitet, ku mund të përmendim:

- zgjerimin e pjesëmarrjes së Komitetit me institucionet finaciare jobanka të përfshira në fushën e pagesave dhe operatorët e sistemeve të pagesave, sipas rekomandimeve të Bankës Botërore;
- raportin e vlerësimit *"Një pasqyrë e tregut të remitancave në Shqipëri"* bazuar në Parimet e Përgjithshme për Shërbimet e Remitancave Ndërkombëtare, me qëllim identifikimin e nevojave për ndërhyrje, të cilat janë adresuar në planveprimin e strategjisë;
- analizën *"Mbi përfshirjen efektive financiare në Shqipëri: Perspektiva e pagesave"*, e cila identifikon qartazi nevojën e rritjes së përqindjes së popullsisë që zotëron një llogari bankare, si dhe nevojën për nxitjen e përdorimit të këtyre llogarive;
- studimin *"Kostot dhe kursimet e pagesave me vlerë të vogël në Shqipëri"*. Përtej identifikimit të kostove të larta që mbart përdorimi i *cash*-it në ekonomi (rreth 1% e PBB-së), u identifikuan dhe kostot e përballuara nga secili aktor ekonomik, ku interes të veçantë paraqesin kostot për ofruesit e shërbimeve të pagesave (banka dhe jobanka);
- miratimin e Strategjisë Kombëtare për Pagesat me Vlerë të Vogël në Shqipëri (2018-2023).

HAPËSIRË INFORMUESE 8: STRATEGJIA KOMBËTARE PËR PAGESAT ME VLERË TË VOGËL NË SHQIPËRI (2018-2023)

Strategjia e miratuar nga Komiteti Kombëtar i Sistemeve të Pagesave (KKSP) në mbledhjen e tij të katërt, është rezultat i një pune disavjeçare të Bankës së Shqipërisë dhe institucioneve anëtare në KKSP-së, me asistencën e Bankës Botërore për identifikimn e nevojave të tregut dhe masave për ndërhyrje.

Strategjia përcakton një vizion të qartë afatmesëm për tregun e pagesave me vlerë të vogël, i cili konsiston në "krijimin e një tregu bashkëkohor dhe gjithëpërfshirës të pagesave me vlerë të vogël, të mbështetur nga infrastruktura të sigurta dhe efikase, dhe nga një gamë e gjerë instrumentesh dhe shërbimesh të pagesave, që përmbushin nevojat e përdoruesve të aftë financiarisht për të kryer pagesa në të gjithë vendin".

Qëllimi i strategjisë është përmirësimi i tregut të pagesave me vlerë të vogël, duke u dhënë qytetarëve shqiptarë më shumë mundësi zgjedhjeje për të kryer transaksionet e tyre të përditshme, në mënyrë të lehtë dhe me kosto efektive, duke mbështetur objektivin e një përfshirjeje më të gjerë financiare. Më konkretisht, strategjia synon dyfishimin e popullsisë që zotëron një llogari (nga 38% në vitin 2014, në 70% në vitin 2022) dhe rritjen e numrit të pagesave elektronike për frymë nga 4.3 në 2016, në 10 në vitin 2022.

Strategjia përmban edhe një planveprimi të detajuar për arritjen e objektivave, masat kryesore të të cilit konsistojnë në: a) përmirësimin e kuadrit ligjor dhe rregullativ në zbatim; b) zhvillimin dhe përmirësimin e infrastrukturave për shërbimet financiare; c) rritjen e zotërimit të llogarive të pagesave dhe përdorimit të shërbimeve të tyre; d) shtimin e pikave të aksesit të këtyre shërbimeve; e) rritjen e edukimit dhe ndërgjegjësimit financiar; f) rritjen e volumeve të transaksioneve të procesuara nga sistemet e pagesave; si dhe g) angazhimin ndërinstitucional si të sektorit publik, ashtu edhe të atij privat, i cili është tejet i rëndësishëm për zbatimin e rekomandimeve.

Zbatimi i strategjisë dhe materializimi i efekteve të saj kërkon një angazhim nga të gjithë aktorët e tregut. Për këtë qëllim, strategjia parashikon role dhe objektiva konkretë për secilin institucion të përfshirë.

2.7.3. ECURIA E SISTEMEVE AIPS DHE AECH

Sistemi AIPS, i cili konsiderohet si infrastruktura bazë për shlyerjen e pagesave në monedhën kombëtare dhe shlyerjen e transaksioneve të tregjeve financiare, ka funksionuar në mënyrë të sigurt dhe efikase gjatë vitit 2018, duke reflektuar një disponueshmëri të lartë (mbi 99.9%)[30]. Në të njëjtën linjë, edhe sistemi AECH, i cili akomodon klerimin e transaksioneve ndërbankare të klientëve të bankave (individë dhe biznese) ka operuar në përputhje të plotë me rregullat e sistemit, duke garantuar një disponueshmëri maksimale (99.4%) për tregun dhe duke shmangur incidente e vonesa. Pjesëmarrja e bankave në sistemin AIPS dhe AECH ka rezultuar në ulje, nga 16 banka në 14 në fund të vitit 2018,

[30] *Disponueshëria e sistemit tregon se sa funksional ka qenë sistemi gjatë orarit të punës të shpallur në rregulloret e funksionimit të tij.*

si rrjedhojë e procesit të përthithjes së dy bankave nga dy banka të tjera të sistemit. Realizimi i daljes nga sistemet AIPS dhe AECH i dy pjesëmarrësve është administruar me sukses, duke mos reflektuar problematika në operimin e sistemeve.

SISTEMI I SHLYERJES SË PAGESAVE NDËRBANKARE ME VLERË TË MADHE (AIPS)

Në vitin 2018, aktiviteti i sistemit AIPS ka paraqitur një rritje të lehtë të numrit të transaksioneve me 0.3% në terma vjetorë, duke arritur një volum prej 126,038 transaksionesh. Rritja e numrit është shoqëruar me rritje të vlerës së procesuar (8% në terma vjetorë, duke arritur vlerën 9,141 miliardë lekë), duke pasqyruar një rritje në raportin e vlerës së transaksioneve të procesuara në AIPS ndaj PBB-së. Ky raport rezulton në 5.6 herë, nga 5.4 herë që ka qenë në vitin 2017 dhe tregon për një përdorim gjithnjë e më të lartë të këtij sistemi nga aktorët e tregut. Prirja në rritje e përdorimit të sistemit AIPS vlerësohet të shumëfishohet me zhvillimin dhe thellimin e tregjeve financiare në Shqipëri, si dhe me përfshirjen financiare të popullsisë shqiptare, duke synuar nivelet e tregjeve të zhvilluara[31].

Grafik 32. Ecuria e sistemit AIPS sipas numrit dhe të vlerës së transaksioneve të procesuara në AIPS



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Një thellim i analizës së përdorimit të këtij sistemi për tipologji të ndryshme transaksionesh tregon se zëri "Pagesa për klientë" (një zë ky me peshën kryesore të pagesave në terma të numrit, 55.93%) vijon të paraqesë ritme rritëse si në numër ashtu dhe në vlerë, përkatësisht me 4.95% dhe 6.48%, krahasuar me vitin e kaluar. Nga ana tjetër, zëri kryesor në terma të vlerës: "Shlyerje nga sistemi AFISaR" (41.05%) ka reflektuar rënie me pothuaj 3.94% në numër transaksionesh dhe rritje me 9.74% në vlerë, krahasuar me një vit më parë.

[31] *Target 2- shlyen brenda një jave një vlerë të barabartë me PBB-në e Bashkimit Evropian, duke diktuar rëndësinë që ka ky sistem për tregjet evropiane.*

Gjatë vitit 2018, në sistemin AIPS janë disbursuar rreth 17.41% më shumë Kredi Brenda Ditës (KBD)[32]. Megjithatë, vlera e KBD-së ka pasqyruar rënie me 3.71%, kryesisht si pasojë e rënies së vlerës mesatare për transaksion. Kjo prirje nënkupton se ekspozimi i sistemit ndaj rrezikut të likuiditetit paraqitet në nivele shumë të ulëta.

Grafik 33. Raporti i Kredisë Brenda Ditës ndaj totalit të AIPS në miliardë lekë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

SISTEMI I KLERIMIT TË PAGESAVE ME VLERË TË VOGËL (AECH)

Sistemi AECH ka vijuar të paraqesë rritje të numrit dhe të vlerës së transaksioneve përkatësisht me 14.36% dhe 11.15% në terma vjetorë, gjatë vitit 2018. Më në detaje, në sistemin AECH, gjatë vitit 2018, janë procesuar 632,923 pagesa, me një vlerë mesatare për transaksion prej rreth 172,000 lekësh. Rritja e përdorimit të sistemit AECH tregon familjarizimin e publikut me instrumentet e pagesave dhe përdorimin e tyre në nivel ndërbankar. Kjo rritje konfirmon edhe efikasitetin e masave të marra nga Banka e Shqipërisë, që në vitin 2011, mbi komisionet e aplikuara nga bankat në përdoruesit fundorë me synim zgjerimin e përdorimit të këtij sistemi.

Grafik 34. Ecuria e numrit dhe vlerës së transaksioneve të kleruara në AECH në vite (majtas) dhe raporti i transaksioneve të procesuara në AECH në raport me popullsinë mbi moshën 15 vjeç* (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Me qëllim rritjen e përdorimit të këtij sistemi, Banka e Shqipërisë, në periudhën afatmesme-afatgjatë, ka parashikuar një sërë masash, si nga pikëpamja e

[32] *KBD – lehtësi që i akordohet një pjesëmarrësi në sistemin e pagesave nga banka qendrore/operatore e sistemit për të kryer pagesa/shlyerje në bazë të akteve dhe ligjeve të aplikueshme. Banka qendrore ofron likuiditetin brenda ditës (KBD) për bankat pjesëmarrëse në sistem, i cili trajtohet në formën e një kredie të kolaterizuar me interes zero. Instrumentet financiare të pranueshme për garantimin e kredisë brenda ditës përcaktohen dhe monitorohen nga Departamenti i Operacioneve Monetare.*

zhvillimeve infrastrukturore, ashtu dhe atyre ligjore e rregullative. Një mbështetje të konsiderueshme në këtë drejtim vlerësohet se do të ketë dhe zbatimi i projektligjit "Për shërbimet e pagesave", si dhe zbatimi i Projektit të Debitimit Direkt ndërbankar dhe zgjerimi i pjesëmarrësve në sistem përtej pjesëmarrësve tradicionalë, bankave tregtare.

Nga pikëpamja e shmangies së rreziqeve në sistem, shpërndarja e transaksioneve të kleruara në AECH sipas seancave dëshmon për një përqendrim më të lartë në seancën e parë të klerimit. Zhvillimi i sipërcituar shmang mbingarkesat në flukset e pagesave në seancën e fundit të klerimit, duke minimizuar rreziqet e mbartura nga këto mbingarkesa dhe duke promovuar sigurinë dhe efikasitetin e këtij sistemi[33].

2.7.4. INSTRUMENTET E PAGESAVE

Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim dhe me aktorët e tregut, po ndërmerr reforma të cilat synojnë modernizimin e këtij tregu për t'i ofruar qytetarëve dhe bizneseve, shërbime sa më efikase dhe me kosto të ulëta. Nxitja e përdorimit të instrumenteve elektronike të pagesave synon përfshirjen financiare të popullsisë nga pikëpamja e pagesave, e cila shërben si një hap i parë në përfshirjen financiare edhe të produkteve më të sofistikuara bankare e financiare. Objektivat e synuar - rritja e përqindjes së popullsisë që zotëron një llogari nga 40% në vitin 2017 në 70% në vitin 2022, si dhe dyfishimi i përdorimit të këtyre llogarive (nga 4.3 pagesa për frymë në 10 pagesa për frymë) - vlerësohet të materializohen nëpërmjet përmirësimit të kuadrit rregullativ e ligjor, nëpërmjet përmirësimeve infrastrukturore dhe edukimit financiar.

Rritja e përdorimit të instrumenteve të pagesave në ekonominë shqiptare ka vijuar edhe përgjatë vitit 2018, e reflektuar në një rritje vjetore të numrit të pagesave me 13.23%, duke kapur nivelin e rreth 15 milionë pagesave për individë dhe biznese.

Analiza e pagesave sipas instrumenteve të përdorura tregon për një zgjerim të vazhdueshëm të pagesave elektronike, ku mund të përmendim kartat bankare, transfertat e kreditit në formë elektronike (*home banking*), si dhe rishtazi prezantimin e parasë elektronike - kartave të parapaguara. Rritja e peshës së pagesave elektronike është reflektuar në një tkurrje të vazhdueshme të transfertave të kreditit në formë letër, të cilat në vitin 2018, zunë një peshë rreth 38%, nga rreth 90% në vitin 2008.

[33] *Kjo sjellje reflekton masat e marra nga Banka e Shqipërisë në vitin 2011 për të diferencuar tarifimin e seancave, duke favorizuar kështu përdorimin e seancës së parë.*

Grafik 35. Ecuria e numrit të instrumenteve të pagesave në vite (majtas) dhe përdorimi në numër i instrumenteve të pagesave, gjatë 2018, nga individët dhe bizneset (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

HOME BANKING

Inicimi i transfertave të kreditit në formë elektronike realizohet nëpërmjet shërbimeve "*home banking*[34]", të cilat ofrohen nga 12 banka[35] prej 14 bankave të sistemit. Këto shërbime po gjejnë një përdorim gjithnjë e më të gjerë në tregun shqiptar, duke u përdorur gjithnjë e më shumë për kryerjen e pagesave, përtej shërbimeve bazike të informimit mbi llogarinë. Më konkretisht, në vitin 2018, vihet re një rritje e konsiderueshme e vëllimit të pagesave "*home banking*" prej 28.64%, dhe e vlerës së këtyre transaksioneve prej 61.02%, krahasuar me një vit më parë. Kontribut në rritjen e përdorimit të "*home banking*", vlerësohet të ketë zhvillimi i infrastrukturës, si edhe përhapja e mundësive për të aksesuar internetin edhe përmes zotërimit të një "*smart phone*". Rol pozitiv vlerësohet të kenë luajtur edhe politikat e bankave, përmes promovimit të mënyrave alternative të pagesave, çka është reflektuar në shtimin e llogarive të aksesueshme në distancë ndaj totalit të llogarive nga rreth 1% në vitin 2008, në rreth 12.81% në vitin 2018. Nga pikëpamja e përdorimit/shfrytëzimit të këtyre llogarive, pavarësisht zhvillimeve pozitive (rreth 13 transaksione në vit për llogari) potenciali për rritje mbetet ende i lartë.

Grafik 36. Ecuria e përqindjes së llogarive të aksesueshme nga interneti ndaj totalit të llogarive, dhe ecuria e raportit të shfrytëzimit të llogarive të aksesueshme nga interneti*



Burimi: Banka e Shqipërisë.

*Raporti i utilizimit tregon sa përdoret mesatarisht një llogari me akses nga interneti për kryerje transaksionesh.

Transfertat e kreditit në formë elektronike rezultojnë të jenë instrumenti më efikas dhe me më pak kosto në ekonominë shqiptare. Në këto kushte, reformat

[34] *Këto produkte mundësojnë aksesimin e llogarisë bankare në distancë, nëpërmjet një linje interneti, linje telefoni apo një software-i që banka i vë në dispozicion klientit të saj.*

[35] *Në fund të vitit 2018, sistemi bankar përbëhet nga 14 banka të nivelit të dytë (nga 16 në fund të vitit 2017).*

e synuara nga Banka e Shqipërisë nëpërmjet ndërhyrjeve ligjore (projektligji "Për shërbimet e pagesave") dhe atyre infrastrukturore (*instant payment*) pritet të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në përdorimin e mëtejshëm të këtyre shërbimeve për kryerjen e pagesave në përditshmërinë e shqiptarëve.

KARTAT BANKARE

Në Republikën e Shqipërisë, në fund të vitit 2018, rezultojnë 13 banka të licencuara si emetuese kartash, 7 nga të cilat janë të licencuara edhe si pranuese kartash. Infrastruktura e ofruar nga këto banka ka rezultuar në rritje. Numri i terminaleve POS, i llogaritur në raportin POS për 1,000,0000 banorë, rezulton në 3,692, nga 2,541 në vitin 2017. Pavarësisht prirjes pozitive të shtimit në numër të terminaleve POS, përqendrimi i tyre vijon të jetë i lartë në zonat urbane dhe kryesisht në qarkun e Tiranës[36] (83.19%).

Ndërkohë, numri i ATM-ve është ulur me 3.21%, krahasuar me vitin 2017[37]. Megjithatë, vlen të theksohet se në tregun shqiptar ATM-të përdoren kryesisht për tërheqje *cash*, dhe jo për inicimin e pagesave. Në këto kushte, ekzistenca e ATM-ve nuk mund të lidhet drejtpërdrejt me zgjerimin e mundësive për kryerjen e pagesave elektronike.

Grafik 37. Zhvillimet e ATM-ve dhe POS-eve (lart); dhe zhvillimet e kartave të debitit dhe të kreditit (poshtë)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Zhvillime pozitive kanë shënuar dhe terminalet për përdorimin e kartave me para elektronike, të cilat vijojnë të paraqesin ritme rritëse në masën 22.21%, krahasuar me fundin e vitit 2017. Nxitja e përdorimit të instrumenteve të parasë elektronike vlerësohet të ketë ndikim në përfshirjen financiare të popullsisë duke mundësuar aksesin në shërbime bankare (hapjen e një llogarie paraje elektronike dhe zotërimin e një karte të parapaguar) nga kategori të popullsisë pa akses në shërbime të tjera, si për shembull nuk janë pagamarrës.

[36] *Ndarja e qarqeve bëhet sipas degëve të Bankës së Shqipërisë.*

[37] *Vlen të theksohet edhe konsolidimi i bankave nga 16 të tilla në fund të 2017, në 14 në fund të vitit 2018.*

Gjatë vitit 2018, vihet re një rritje me 4.46% e emetimit të kartave të debitit dhe me 9.47% e kartave të kreditit. Gjithashtu, përdorimi në treg i kartave me funksion paraje elektronike ka paraqitur ritme të shpejta rritëse, gjatë vitit përkatësisht, me 24.67%.

Nga përdorimi i kartave bankare në terminalet ATM dhe POS, rezulton se, peshën kryesore të transaksioneve të procesuara me karta e zënë tërheqjet *cash* nga ATM-të, tregues ky i një ekonomie ende me përdorim të lartë të *cash*-it. Gjatë vitit 2018, ndryshe nga viti i kaluar, vërehet një rritje në numrin dhe vlerën e pagesave me karta në POS-e fizike dhe virtuale, përkatësisht me 22.40% dhe me 15.82%. Në terma relativë, numri i pagesave të kryera me karta të parapaguara arrin deri në 5.60% të pagesave me karta debiti dhe krediti, dhe krahasuar me vitin e kaluar ka një rritje të pagesave me këto karta prej 20.57%. Përdorimi i ulët i kartave si mjet pagese në terminale reflekton nivelin e familjarizimit të publikut, edukimin e ulët financiar, si dhe infrastrukturën e kufizuar të POS-eve nga ana e bizneseve.

Produktet e parasë elektronike, bazuar në kuadrin ligjor dhe rregullativ të Bankës së Shqipërisë, ofrohen dhe nga institucionet financiare jobanka të licencuara si Institucione të Parasë Elektronike. Aktualisht, në tregun shqiptar operojnë dy institucione të tilla. Gjatë periudhës mars[38]- dhjetor 2018, këto institucione së bashku kanë kryer një volum prej afërsisht 1.78 milionë pagesash me para elektronike, me një vlerë prej 4,578 milionë lekësh.

TRANSAKSIONET ME PARA FIZIKE

Në transaksionet me para fizike (cash) të kryera nga klientët në sportelet e bankave, për vitin 2018, vihet re një ulje në numër krahasuar me një vit më parë. Këtë vit është shënuar një ulje e lehtë e transaksioneve në arkë me 5.48% në terma të numrit dhe një rritje e lehtë me 0.82% në terma të vlerës, krahasuar me një vit më parë.

Grafik 38. Numri (majtas) dhe vlera (djathtas) e transaksioneve cash në sportelet e bankave



Burimi: Raportimet e bankave sipas "Metodologjisë për raportimin e instrumenteve të pagesave".

[38] *Meqenëse institucioni i dytë i parasë elektronike u licencua në muajin shkurt 2018, raportimi i agreguar i këtyre institucioneve fillon në mars 2018.*

Pavarësisht uljes së përdorimit të parasë fizike, nga perspektiva e tërheqjeve dhe depozitimeve në sportelet e bankave në vitin 2018, përdorimi i parasë fizike në ekonominë shqiptare është një fenomen mbizotërues dhe me kosto të larta për aktorët e ndryshëm dhe ekonominë në përgjithësi. Në këtë kuadër, bashkërendimi i përpjekjeve në nivel tregu për nxitjen e përdorimit të instrumenteve sa më efikase dhe me kosto të ulëta paraqet një rëndësi të veçantë dhe përbën një nga prioritetet e Bankës së Shqipërisë.

2.8. ADMINISTRIMI I REZERVËS VALUTORE

Banka e Shqipërisë është autoriteti përgjegjës për mbajtjen dhe administrimin e rezervave valutore të Shqipërisë. Ajo shfrytëzon maksimalisht mundësitë e saj për të arritur dhe ruajtur një nivel të caktuar të rezervës valutore, e cila mbështet qëndrueshmërinë financiare të vendit dhe është në përputhje me politikën monetare.

Rregullorja "Për politikën dhe mënyrën e administrimit të rezervës valutore", miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës, përcakton qartë qëllimet për të cilat mbahet rezerva valutore. Në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare, në qëllimet e mbajtjes së rezervave citohet, krahas zbatimit dhe mbështetjes së politikës monetare dhe politikës së kursit të këmbimit, edhe ruajtja e stabilitetit financiar. Objektivat e procesit të administrimit të rezervës valutore miratohen nga Këshilli Mbikëqyrës. Si objektiva parësorë janë përcaktuar likuiditeti dhe siguria, ndërkohë që sigurimi i të ardhurave nga administrimi i rezervës përfaqëson objektivin e tretë, për sa kohë nuk cenohen dy objektivat e parë. Emrat e lejuar në të cilët investohet rezerva valutore miratohen nga Komiteti i Investimit. Këta emra përfshijnë qeveritë e SHBA-së, Japonisë, Britanisë së Madhe, Kanadasë, Australisë dhe Eurozonës, të cilat përgjithësisht janë të renditura të paktën A- (për qeveritë e Eurozonës renditja minimale e pranuar është BBB-[39]). Në emrat e lejuar për investim përfshihen dhe agjenci apo institucione të lidhura me qeveritë, institucione shumëpalëshe apo të tjera subjekte të renditura të paktën AA-.

Grafik 39. Ecuria e rezervës valutore në Bankën e Shqipërisë (mln Eur)



*Shënim: Në 31 dhjetor 2018, stoku i rezervës valutore rezultoi 3,395.92 milionë EUR, ku përfshihet edhe ari monetar, në një shumë prej 56.58 milionë EUR ose 1.7% e totalit.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

PËRBËRJA E PORTOFOLIT TË REZERVËS SIPAS AFATIT TË MATURIMIT

Në fund të vitit, rezerva valutore e administruar nga Departamenti i Operacioneve Monetare është e investuar në aktive likuide, kryesisht me afat maturimi 0-3 vjet. Pesha e instrumenteve të borxhit me afat mbi 5 vjet nuk tejkalon 2.1% të portofolit të rezervës. Portofoli i administruar nga administratori i jashtëm

[39] *Emrat/instrumentet e renditura deri në BBB- përfshihen në kategorinë "Për investim" (investment grade).*

(Banka Botërore) është investuar kundrejt një portofoli referencë 1-3 vjet, kryesisht në instrumente borxhi të emetuara nga qeveri dhe agjenci qeveritare.

PËRBËRJA E PORTOFOLIT TË REZERVËS SIPAS MONEDHAVE

Përbërja sipas monedhave e rezervës valutore bruto, në fund të vitit 2018, paraqitet në grafikun më poshtë.

Ekspozimi në monedhat Aud (dollari australian) dhe Rmb (renminbi kinez) pasqyron vendimin e Këshillit Mbikëqyrës për investimin e një pjese të rezervës sipas shportës së SDR-së. Pesha e monedhës RMB shpërndahet në dy monedha, RMB dhe AUD, sipas një raporti që miratohet nga Komiteti i Investimit.

PËRBËRJA E PORTOFOLIT TË REZERVËS SIPAS RENDITJES DHE LLOJIT TË EMETUESVE/ KUNDËRPALËVE

Rreth 84% e portofolit të rezervës valutore rezulton e investuar me emra me renditje të cilësisë së lartë (klasa AAA dhe AA, duke përfshirë edhe ekspozimet në llogari rrjedhëse). Ekspozimet sipas llojit të emetuesit/kundërpalës përfaqësohen nga qeveri/ banka qendrore (76.3%), ndjekur nga institucione shumëpalëshe (8.1%), banka/institucione të tjera financiare (10.1%), agjenci (4.5%), institucione të garantuara nga qeveritë (0.8%) dhe autoritete qeveritare/organe publike (0.2%).

Grafik 40. Shpërndarja e rezervës sipas afatit të maturimit të investimit



*Në grafik nuk pasqyrohen fondet e mbajtura në llogari rrjedhëse.

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 41. Pesha e monedhave përbërëse të rezervës valutore bruto (në %)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 42. Peshat sipas llojeve të emetuesve/kundërpalëve dhe klasave të renditjes në fund të vitit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

KTHIMI NGA INVESTIMI I PORTOFOLIT TË REZERVËS

Kthimi absolut i rezervës në total (përjashtuar fondin e administruar nga Banka Botërore si administrator i jashtëm), ka rezultuar rreth 0.218% për vitin 2018, krahasuar me -0.029% për vitin paraardhës. Norma e ulët e kthimit, reflekton mjedisin sfidues ndërkombëtar, ku normat e interesit për emetimet e thesarit në euro, vijojnë të qëndrojnë në terren negativ, për shkak të politikës monetare të ndjekur nga BQE-ja (norma e depozitës së BQE-së vijon të jetë -0.40%). Për rrjedhojë, mundësitë e investimit me një normë pozitive kthimi për pjesën e portofolit të euros, duke ruajtur nivelin e pranuar të rrezikut të kreditit, vijojnë të jenë ende të ulëta. Kjo situatë është pasqyruar dhe në ndërtimin e portofoleve strategjikë në monedhën euro ku gjatë vitit 2018, pesha e *cash*-it është rritur krahasuar me vitin paraardhës. Në mbyllje të vitit 2018, gjendja në llogari rrjedhëse është rreth 52% e portofolit total të rezervës, në pasqyrim të përpjekjeve për minimizimin e kostove nga investimi, në kushtet e vijimit të normave negative të interesit për monedhën euro. Përsa i takon investimeve në tituj në portofolin e euros, ato rezultojnë me një normë negative interesi që varion nga -4 pikë bazë në -69 pikë bazë.

HAPËSIRË INFORMUESE 9: NDIKIMI I AMBIENTIT TË HUAJ NË INVESTIMIN E REZERVËS VALUTORE

Viti 2018 tregoi divergjenca në zhvillimin e ekonomive kryesore dhe shtim të frymës proteksioniste. Gjatë pjesës më të madhe të vitit, SHBA-të u karakterizuan nga një rritje reale ekonomike mbi mesataren (rreth 2.9%), e shtyrë kryesisht nga politikat fiskale të Shtëpisë së Bardhë, ndërkohë që Eurozona, Japonia dhe Britania e Madhe patën një rritje më të moderuar (përkatësisht 1.9%, 0.8% dhe 1.4%). Ngjarje si kriza politike në Itali, lufta tregtare SHBA-Kinë, si dhe dalja e Britanisë së Madhe nga Bashkimi Evropian dominuan lajmet, duke sjellë volatilitet dhe lëvizje drejt investimeve më të sigurta. Normat e interesit u rritën në SHBA, lehtësisht në Mbretërinë e Bashkuar, ndërkohë që mbetën në territore negative dhe thuajse në nivelet e fillimvitit në Eurozonë dhe Japoni.

Grafik 43. Ecuria e normave të interesit dhe kthimi nga normat e interesit në tregjet e SHBA-së dhe të Eurozonës



Burimi: Bloomberg, ecuria e normës 2-vjeçare të interesit për emetimet e qeverive me peshë të rëndësishme në portofolin e rezervës. Indekset e publikuara nga ICE Data Indices. Kthimi i portofoleve në emetime thesari me renditje AAA - AA, me afat maturimi 1-3 vjet.

Kthimi absolut i rezervës valutore sërish në nivele të ulëta pasqyron vijueshmërinë e një mjedisi ende me norma të ulëta interesi, në monedhat/tregjet kryesore në të cilat investohet portofoli i rezervës valutore (paneli majtas) dhe ecuria e performancës së tregjeve në dy monedhat kryesore ku investohet rezerva valutore, EUR dhe USD (djathtas).

Kontributi në kthim i monedhës EUR, e cila përbën më shumë se 60% të portofolit të rezervës, ishte negativ, në pasqyrim të situatës së normave negative të interesit në Eurozonë. Kontributi në kthim i monedhës USD dhe monedhave të tjera të rezervës ishte pozitiv, si rrjedhojë e bazës më të lartë të normave të interesit në këto monedha mesatarisht gjatë vitit.

Kthimi i krijuar nga administrimi aktiv i portofolit të rezervës gjatë vitit 2018 ishte pozitiv. Peshën më të madhe të kontributit në këtë kthim e pati monedha EUR.

ZHVILLIME TË TJERA NË FUNKSIONIN E ADMINISTRIMIT TË REZERVËS VALUTORE

Gjatë vitit 2018 ka vijuar bashkëpunimi i Bankës së Shqipërisë me Bankën Botërore, në kuadër të marrëveshjes "Për administrim dhe konsulencë në investimin e rezervës valutore" (RAMP). Banka Botërore ka vijuar të ofrojë trajnime dhe programe edukimi të specializuara, me qëllim konsolidimin dhe rritjen e shkallës së profesionalizmit të punonjësve të angazhuar në procesin e administrimit të rezervës valutore, të stafit që mbështet ose monitoron ecurinë e këtij procesi, si dhe të stafit të Bankës në përgjithësi. Banka Botërore ka ofruar asistencë edhe në drejtim të integrimit të rrezikut të kreditit në procesin e përzgjedhjes së portofolit strategjik, me qëllim ndërtimin e një metodologjie më të konsoliduar për ndërtimin e portofoleve që mbartin ekspozim ndaj rrezikut të kreditit.

Në kuadër të marrëdhënieve të biznesit me kundërpalët, gjatë vitit 2018, u finalizua lidhja e marrëveshjes me Bankën për Rregullime Ndërkombëtare (BIS) për sigurimin e një linje krediti, në shumën 500 milionë euro, me këtë institucion. Marrëveshja i shërben administrimit të nevojave për likuiditet në valutë në shuma të konsiderueshme, duke përdorur si kolateral tituj investimi nga portofoli i rezervës valutore. Në përputhje të plotë me qëllimet e mbajtjes së rezervës valutore, marrëveshja është një mekanizëm i rëndësishëm në dispozicion të Bankës së Shqipërisë, krahas marrëveshjes Swap të lidhur me Bankën Popullore të Kinës, për të vepruar në situata të nevojave emergjente për likuiditet në valutë. Ekzistenca e kësaj marrëveshjeje krijon më shumë fleksibilitet për një administrim më eficient të rezervës valutore në kohë, veçanërisht në kushtet kur pjesa kryesore e saj në monedhën euro investohet me normë negative interesi.

Në kuadër të diversifikimit të instrumenteve për investimin e portofolit të rezervës, vlen të përmendet fillimi i zbatimit të investimit për herë të parë në obligacione të mbuluara (*covered bonds*), si dhe analiza e instrumenteve të reja potenciale

për investim, tituj të kolateralizuar nga hua hipotekare (*mortagage backed securities*).

HAPËSIRË INFORMUESE 10: FLUKSET QË NDIKUAN REZERVËN VALUTORE, GJATË VITIT 2018

Gjatë vitit 2018 rezerva valutore bruto, e vlerësuar dhe e raportuar në monedhën euro, është rritur me rreth 401.64 milionë euro, duke regjistruar në fund të muajit dhjetor vlerën 3,395.92 milionë euro. Viti 2018 është karakterizuar sërish nga një luhatshmëri e lartë e nivelit të rezervave të tepërta të bankave të nivelit të dytë pranë Bankës së Shqipërisë.

A. Veprimet e lidhura me aktivitetin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë kanë pasur ndikim negativ në shumën 15.21 milionë euro, sipas zërave të mëposhtëm:

- *hyrje neto nga lëvrimi i huave të dhëna në shumën 123.2 milionë euro;*
- *hyrje nga emetimi i borxhit në valutë në tregun e jashtëm në shumën 268.09 milionë euro;*
- *transferta, përfshirë dhe shërbimin e borxhit 406.50 milionë euro.*

B. Veprimet e bankave të nivelit të dytë dhe subjekteve të tjera kanë pasur ndikim negativ në shumën 48.82 milionë euro, sipas zërave të mëposhtëm:

- *derdhje nga bankat e nivelit të dytë në llogarinë e tyre pranë Bankës së Shqipërisë 1,829.23 milionë euro;*
- *transferta 1,890.10 milionë euro;*
- *hyrje neto për llogari të subjekteve të tjera (ASD, etj.) 12.05 milionë euro.*

C. Veprimet e Bankës së Shqipërisë kanë pasur ndikim pozitiv në shumën 454.13 milionë euro, sipas zërave të mëposhtëm:

- *blerje e valutës nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, bankat dhe institucione të tjera në shumën 427.24 milionë euro:*
  - *nga bankat e nivelit të dytë 307.85 milionë euro,*
  - *nga institucione të tjera 117.96 milionë euro,*
  - *nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë 1.42 milionë euro[I];*
- *hyrje nga interesa, kupona, etj. (të llogaritura në bazë cash-i) të krijuara nga investimi i rezervës valutore llogariten në rreth 31.34 milionë euro;*
- *shlyerja e detyrimeve të Bankës së Shqipërisë ndaj FMN-së 1.32 milionë euro;*
- *transferta rreth 3.12 milionë euro.*

D. Faktorët e tregut kanë pasur ndikim pozitiv në shumën 11.54 milionë euro, sipas zërave të mëposhtëm:

- *luhatjet në kursin e këmbimit të monedhave në përbërje të rezervës valutore kanë ndikuar pozitivisht vlerën e rezervës bruto të raportuar në euro, duke regjistruar një efekt rreth 30.70 milionë euro;*
- *efekti i rivlerësimit për portofolin, si rrjedhojë e luhatjes së normave të interesit, llogaritet në një vlerë negative prej rreth 19.16 milionë euro[II].*

[I] Vëllimi i veprimeve Swap të realizuara me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për vitin 2018, është 514.38 milionë euro.

[II] Kjo vlerë ka në përmbajtje dhe efektin e krijuar nga derdhja e kuponave të titujve dhe është e korrigjuar për veprimet e blerjes/shitjes/maturimit të titujve në baza cash-i.

2.9. STATISTIKAT

Në përputhje me përcaktimet në ligjin "Për Bankën e Shqipërisë", Programin Zyrtar të Statistikave, si dhe Ligjin për Statistikat Zyrtare, funksioni i statistikave në Bankën e Shqipërisë synon nxjerrjen e statistikave të paanshme, objektive dhe të besueshme, në shërbim dhe në përmbushje të objektivave ligjorë të Bankës, si bankë qendrore e Republikës së Shqipërisë dhe si agjenci statistikore brenda Sistemit Kombëtar Statistikor.

Banka e Shqipërisë harton dhe publikon statistika për nevoja të politikës monetare, mbikëqyrjes së tregut financiar, stabilitetit financiar dhe të tjera detyra të Bankës së Shqipërisë. Këto statistika janë në dispozicion të publikut në seksionin "Statistikat" në faqen zyrtare të internetit të Bankës së Shqipërisë.

Në funksion të vizionit strategjik, Banka e Shqipërisë ka intensifikuar punën për plotësimin e standardeve sasiore të metodologjive ndërkombëtare dhe të legjislacionit të Bashkimit Evropian, lidhur me përmbajtjen dhe raportimin e statistikave pranë organizmave evropiane dhe ndërkombëtare. Njëkohësisht, vëmendje ka marrë ndërtimi i databazave me të dhëna të grimcuara për të rritur konsistencën mikro-makro dhe për të lejuar ndërtimin e treguesve të rinj, në përgjigje të evolucionit të nevojave analitike. Nxitja dhe thellimi i dialogut me përdoruesit e të dhënave për të identifikuar më mirë nevojat e tyre mbetet në fokusin tonë.

Banka e Shqipërisë përmbush edhe detyrimet raportuese pranë institucioneve ndërkombëtare, FMN, BB, si dhe Eurostat e BQE, në kuadër të integrimit evropian të vendit. Banka e Shqipërisë është anëtare në Sistemin e Përmirësuar të Shpërndarjes së të Dhënave të Përgjithshme (e-GDDS) dhe në sisteme të ndryshme raportimi të drejtuara nga FMN-ja.

Që prej 1 nëntorit 2018, Banka e Shqipërisë është pranuar si anëtare me të drejta të plota në *Irvin Fisher Committee* (IFC) për Statistikat e bankave qendrore. IFC-ja nxit shkëmbimin e ideve ndërmjet ekonomistëve, statisticienëve, politikëbërësve, si dhe përfaqësuesve të tjerë, në diskutimin e çështjeve statistikore të lidhura me stabilitetin financiar dhe monetar. Në veçanti, IFC-ja synon forcimin e marrëdhënieve midis hartuesve të statistikave dhe komunitetit të përdoruesve e analistëve të informacionit statistikor, brenda dhe jashtë institucionit të bankës qendrore.

PËRAFRIMI I METODOLOGJIVE ME STANDARDET NDËRKOMBËTARE

Banka e Shqipërisë ka vijuar punën për përafrimin metodologjik të statistikave me standardet ndërkombëtare dhe harmonizimin e tyre sipas acquis communitare. Përpjekje konkrete janë ndërmarrë për hartimin e treguesve të rinj, si dhe për të përmirësuar sistemin e përpunimit të të dhënave, në drejtim të plotësimit të detyrimeve që rrjedhin nga "Plani i Veprimit për Statistikat Ekonomike, Monetare dhe Financiare për vendet kandidate dhe kandidatët potencialë në Bashkimin Evropian".

Në fushën e statistikave monetare dhe financiare, në kuadër të përafrimit me standardet ndërkombëtare të hartimit (BQE, FMN), si dhe në zbatim të rekomandimeve të raportit të ekspertëve të BQE-së, është bërë progres në drejtimet e mëposhtme.

- Në publikimet e muajit dhjetor 2018, Banka e Shqipërisë, për herë të parë, ofroi për publikun statistikën e Llogarive Financiare Kombëtare[40] në përputhje me standardin e hartimit - Sistemit Evropian të Llogarive, ESA 2010. Llogaritë financiare përbëjnë një shtyllë të rëndësishme statistikore për analiza të politikës monetare dhe stabilitetit financiar.
- Vëmendje i është kushtuar zgjatjes në kohë të serive, domosdoshmëri dhe kërkesa që rrjedhin nga detyrimet në kuadër të llogaritjes dhe raportimit të treguesve MIP (*Macroeconomic imbalances procedure*)[41]. Hartimi i këtij blloku të ri statistikor në Bankën e Shqipërisë, ka marrë ekspertizën dhe vlerësimin e disa misioneve të drejtuara nga ekspertë të FMN-së dhe Eurostat-it.
- Projekti për statistikat e financave të qeverisë - Procedura e Deficitit të Tejkaluar (EDP) dhe llogaritë financiare të qeverisë sipas standardeve metodologjike dhe praktikave më të mira ndërkombëtare, ka qenë prioritet i vitit 2018. Procedura e Deficitit të Tejkaluar përfaqëson një bllok të rëndësishëm statistikor për monitorimin e shëndetit të financave publike në vendet anëtare dhe vendet kandidate, në drejtim të respektimit të dy kritereve të Maastricht-it.
- Zhvillimi dhe hartimi i statistikave të normave të interesit në përputhje me rregulloren e BQE-së (EU) Nr. 1072/2013, datë 24.9.2013 (ECB/2013/33). Statistikat e normave të interesit janë baza e analizës së mekanizmit të transmetimit monetar. Ato mundësojnë edhe monitorimin e zhvillimeve strukturore në sistemin bankar dhe financiar, si dhe analizën e aspekteve të stabilitetit financiar, të tilla si marzhi i normave të interesit të bankave, ndryshimet në përfitueshmërinë e këtyre të fundit etj.
- Në shtator 2017, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi rregulloren "Mbi raportimet në Bankën e Shqipërisë për statistikat e normave të interesit", e cila përafron plotësisht rregulloren (EU) Nr. 1072/2013 të BQE-së.
- Plotësimi i kuadrit të Treguesve të Shëndetit Financiar (FSI). Që prej fundit të vitit 2017, Banka e Shqipërisë publikon në faqen e Shqipërisë në FMN (http://fsi.imf.org) Treguesit e Shëndetit Financiar. FSI-të përfshijnë informacion të agreguar mbi institucionet financiare, si dhe indikatorë përfaqësues të tregjeve, në të cilat këto institucione operojnë.
- Në fushën e statistikave të sektorit të jashtëm, përafrimi metodologjik ka prekur kryesisht llogarinë korrente të bilancit të pagesave. Progresi është mbështetur nga projekte bashkëpunimi/asistence me Eurostat-in. Koha

[40] *Në përputhje me Programin e Statistikave Zyrtare 2017-2021 dhe Kalendarin e Publikimit të Statistikave të Bankës së Shqipërisë.*

[41] *Për Shqipërinë, plotësimi i MIP është projekti i mbështetur nga BQE-ja dhe Eurostat-i dhe koordinohet nga Banka e Shqipërisë. Treguesit më të shumtë të përfshirë në të janë tregues që harton BSH-ja, dhe duhet të raportohen në një shtrirje kohore 10-vjeçare.*

e publikimit dhe e transmetimit të treguesve të Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare është reduktar, në përputhje me afatin e transmetimit të të dhënave në Eurostat.

– Nën projektin IPA 2015 MB PP1.2: Tregtia Ndërkombëtare e Shërbimeve, synohet përmirësimi dhe harmonizimi i metodologjive statistikore që lidhen me statistikat e tregtisë ndërkombëtare të shërbimeve (ITSS), me qëllim përafrimin gradual me acquis dhe përmirësimin e transmetimit të të dhënave në Eurostat, sipas kërkesave të propozuara në *BoP Vademecum* dhe në rregulloret e Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian.
– Banka e Shqipërisë ka koordinuar me sukses punën për zhvillimin e treguesve të disbalancave makroekonomike (*MIP indicators*) për Shqipërinë, në bashkëpunim me INSTAT-in dhe mbështetur me ekspertizë nga Bashkimi Evropian. Procedura e Disbalancave Makroekonomike (*Macroeconomic Imbalance Procedure - MIP*) është një sistem për monitorimin e politikave ekonomike dhe zbulimin në kohë të rreziqeve të mundshme në funksionimin normal të ekonomisë së Bashkimit Evropian. MIP është pjesë e EU acquis për t'u përshtatur nga vendet kandidate deri në datën e aderimit.
– Gjatë vitit 2018 është punuar për realizimin e objektivave të projektit "Burimet e të dhënave të nevojshme për llogaritjen e treguesve të Procedurës së Disbalancës Makroekonomike" (shtator 2017 - gusht 2019). Çdo tremujor raportohen në Eurostat përditësimet më të fundit dhe progresi i bërë për secilin nga treguesit e përfshirë në procedurën e disbalancave makroekonomike. Projekti është parashikuar të përfundojë në gusht 2019 dhe përfshin gjithashtu përgatitjen dhe raportimin në Eurostat të dokumentit "*Data Quality Report*" dhe Raportin Final të projektit në vitin 2019.
– Në gjysmën e dytë të vitit 2018, filloi projekti "Përmirësimi i Regjistrit të Kredive në funksion të rritjes së shkallës së përdorimit të tij dhe harmonizimit me standardet metodologjike të BQE-së". Banka e Shqipërisë po punon për implementimin e rregullores nr. 2016/867 të Bankës Qendrore Evropiane, për mbledhjen e të dhënave të detajuara lidhur me kredinë dhe rrezikun e kredisë. Kjo do të mundësojë zbatimin e kërkesave të reja raportuese nga sistemi bankar, në kuadër të Regjistrit të Kredive, dhe ndërtimin e një baze të dhënash të harmonizuar me informacion të detajuar për kreditë dhënë personave fizikë dhe juridikë.

RRITJA E CILËSISË DHE INTEGRITETIT TË STATISTIKAVE

Përmbushja e kritereve të cilësisë së statistikave, sipas kërkesave të kodeve të praktikave dhe standardeve ndërkombëtare të cilësisë së të dhënave, ka qenë në fokusin e funksionit statistikor. Gjatë vitit 2018, një grup ekspertësh nga Eurostat-i, kreu një mision vlerësues të Sistemit Statistikor në Shqipëri (*Peer Review*). Ky mision vlerëson përputhshmërinë me Parimet e Kodit të Praktikave të Statistikave Evropiane (CoP). Ai vlerësoi se statistikat e Bankës së Shqipërisë janë në përputhje me parimet e Kodit.

BASHKËPUNIMI NË NIVEL INSTITUCIONAL

Pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit me INSTAT-in dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në shtator 2016, bashkëpunimi me këto institucione është shtrirë në disa drejtime, ku më kryesoret janë ngritja e dy grupeve ndërinstitucionale të punës, respektivisht me fokus në: (i) llogaritë kombëtare, statistikat monetare dhe bilancin e pagesave; dhe (ii) procedurën e deficitit të tepërt EDP e llogaritë financiare të qeverisë.

Banka e Shqipërisë dhe INSTAT-i kanë intensifikuar bashkëpunimin në drejtim të harmonizimit të statistikave të llogarive financiare me statistikat vjetore të llogarive kombëtare dhe pozicionit ndërkombëtar të investimeve.

Është forcuar bashkëpunimi me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare (AMF) për sigurimin e informacionit statistikor për sistemin financiar jobankar nën juridiksionin e tij. Në kuadër të rritjes së cilësisë së statistikave të prodhuara për nënsektorët e kompanive të sigurimit dhe fondeve të investimeve dhe pensionit vullnetar, gjatë vitit 2018, ka filluar raportimi i formave të reja nga fondet e pensionit dhe të investimit. Në dhjetor 2018, kompanitë e sigurimit kanë raportuar për herë të parë brenda standardeve të nevojshme për hartimin e të dhënave fluks për këtë nënsektor. Përfitimet që do të rezultojnë nga ky bashkëpunim do të përdoren për të mbyllur dhe adresuar disa boshllëqe në informacionin e nevojshëm për vendimmarrjen e politikave, si dhe për të përmirësuar afatet kohore, duke rritur njëkohësisht transparencën në treg.

Në aspektin ndërkombëtar, Banka e Shqipërisë vazhdon të mbajë marrëdhënie korrekte raportimi të statistikave, në kohë dhe në përputhshmëri me standardet metodologjike dhe të transmetimit (platformave) me FMN-në, Eurostat-in, BQE-në, CEFTA-n, marrëdhënie që pritet të intensifikohen nëpërmjet bashkëpunimeve me projekte të ndryshme, të financuara nga programi IPA 2015 dhe FMN-ja.

2.10. KËRKIMI SHKENCOR

Banka e Shqipërisë synon të mbështesë procesin e saj vendimmarrës në themele të forta dijesh dhe njohurish të testuara mbi ekonominë shqiptare. Investimi në krijimin e kapaciteteve të shëndosha kërkimore ndihmon në rritjen cilësore të punës, të reputacionit dhe të besueshmërisë së Bankës së Shqipërisë, si një institucion që zotëron metodologjitë dhe njohuritë e nevojshme për të garantuar ekuilibrat makroekonomikë të vendit. Për këto arsye, zhvillimi aktiv i kërkimit shkencor zë një vend parësor në strategjinë e zhvillimit të Bankës së Shqipërisë.

Fokusi i hulumtimit shkencor në Bankën e Shqipërisë ka qenë i orientuar kryesisht drejt objektivit të politikës monetare, çështjeve që lidhen me ruajtjen e stabilitetit financiar dhe mbikëqyrjen bankare, bashkërendimit midis këtyre objektivave, dhe më pak mbi operacionet monetare apo fusha të tjera. Në përputhje

me strategjinë afatmesme të kërkimit shkencor, puna kërkimore ka vijuar të mbështesë procesin vendimmarrës për hartimin dhe zbatimin e politikave të Bankës së Shqipërisë, zhvillimin e metodologjive të reja të analizës empirike dhe pasurimin e portofolit të modeleve ekonometrike mbi të cilat mbështetet vendimmarrja.

Në fokus të veçantë të projekteve kërkimore në vitin 2018 ishin studimet me të dhëna mikro, të cilat mbuluan aspekte të ndryshme të ndërmarrjeve, familjeve, tregut të punës dhe të tjera sociale.

Këto dhe studime të tjera janë bërë objekt diskutimi në aktivitetet dhe konferencat e organizuara nga Banka e Shqipërisë apo institucione të tjera, ku janë marrë komente e vërejtje që kanë shërbyer për përmirësimin e mëtejshëm të tyre, përpara se të ofrohen për qëllime të vendimmarrjes në Bankën e Shqipërisë. Në këtë kuadër, për të dymbëdhjetin vit radhazi, Banka e Shqipërisë organizoi Takimin Rajonal të Kërkimeve për Evropën Juglindore, në datat 6-7 dhjetor 2018. Qëllimi i këtij aktiviteti është të shërbejë si një platformë prezantimi dhe diskutimi i punimeve kërkimore shkencore ndërmjet kërkuesve, akademikëve dhe politikëbërësve, të kontribuojë në thellimin e kërkimit ekonomik, si dhe të zgjerojë njohuritë mbi tipare të caktuara të zhvillimeve ekonomike dhe metodologjive të kërkimit shkencor. Këtë vit, u prezantuan 34 punime nga banka qendrore të vendeve të ndryshme, si Austri, Bullgari, Greqi, Hungari, Itali, Lituani, Rumani, Turqi dhe Banka Qendrore Evropiane, si dhe nga institucionet akademike të tilla si Universiteti Bujqësor i Tiranës, Universiteti "Luigj Gurakuqi" në Shkodër, Universiteti Chieti-Pescara në Itali, Universiteti i Kilit në Gjermani, Universiteti Staffordshire dhe Universiteti LSE në Angli, Universiteti Halmstad në Suedi, Universiteti Poznan në Poloni, Universiteti i Shtetit të Pensilvanisë dhe Universiteti Drexel në SHBA. Tematikat e prezantuara trajtonin euroizimin dhe implikimet e tij për inflacionin dhe stabilitetin financiar; bashkërendimin e politikës monetare me atë makroprudenciale; implikimet e inovacioneve financiare për ushtrimin e politikës monetare dhe mbikëqyrjen bankare; flukset e kapitalit, produktivitetin dhe tregun e punës pas krizës globale; vlerësimin e rrezikut në sektorin financiar; dhe ndërtimin e modeleve makroekonomike.

Në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë, nën kategorinë "Botime/Botime kërkimore" gjendet informacion më i detajuar dhe i plotë mbi të gjitha punët kërkimore të Bankës së Shqipërisë. Punë të tjera kërkimore publikohen në formën e artikujve në Revistën Ekonomike të Bankës së Shqipërisë. Revista me frekuencë gjashtëmujore "Të rejat shkencore në Bankën e Shqipërisë" ka për qëllim informimin në lidhje me materialet studimore të sapopërfunduara apo ato në proces, materialet e prezantuara në aktivitetin "Seminaret e së Premtes" apo në aktivitete të tjera të organizuara nga Banka e Shqipërisë.

HAPËSIRË INFORMUESE 11: TEMAT KRYESORE TË STUDIMEVE GJATË VITIT 2018

Ecuria e kursit të këmbimit të lekut ishte një nga temat më të diskutuara gjatë vitit 2018. Forcimi i shpejtë i lekut ndaj euros, veçanërisht në gjysmën e parë të vitit, nxiti një numër analizash dhe përpjekjesh kërkimore. Përfundimi i përbashkët i tyre ishte se kursi i këmbimit luan përgjithësisht rolin e "përthithësit të goditjeve" në ekonomi, duke stabilizuar shmangiet e treguesve nga ekuilibri, ndërkohë që ai nuk rezulton të jetë shkaktar kryesor i çregullimeve në ekonomi.

Angazhimi i qeverisë për vijimin e konsolidimit të buxhetit në periudhën afatmesme nxiti vlerësimin e ndjeshmërisë së rritjes ekonomike ndaj stimulit fiskal. Gjetjet empirike sugjerojnë se të ardhurat tatimore kanë efekt më të ndjeshëm në aktivitetin ekonomik sesa shpenzimet publike. Ato ndjehen më tepër në periudhën afatshkurtër dhe shuhen përgjatë horizonteve më të gjata kohore. Konsumi dhe investimet publike shfaqen me efekte të ngjashme në rritjen ekonomike, por impakti i investimeve vlerësohet më i shtrirë në kohë.

Programet e lehtësimit sasior monetar të bankave qendrore kanë qenë objekt studimi jo vetëm për vlerësimin e efekteve në vendet e origjinës, por edhe për shkak të përhapjes së ndikimit në vendet e tjera. Lehtësirat sasiore të Bankës Qendrore Evropiane vlerësohen të kenë influencuar në mënyrë të konsiderueshme kushtet financiare në Shqipëri. Megjithatë, sektori real i ekonomisë nuk dëshmon të ketë përfituar ndjeshëm nga politikat e jashtme lehtësuese. Përçimi pozitiv i tyre nëpërmjet kanalit financiar duket se është neutralizuar nga efektet negative të përcjella nëpërmjet kanalit të ribalancimit të portofolit. Diferenca e normave të interesit me afat 12-mujor në Shqipëri kundrejt normave në Eurozonë influencon investimet dhe rritjen ekonomike në vend, duke vepruar nëpërmjet kanaleve të ribalancimit të portofolit, remitancave, si dhe kanalit të huadhënies bankare.

Në fushën e stabilitetit financiar, vlerësimet empirike mbështesin marrëdhënien midis sjelljes së kujdesshme bankare dhe nevojës për kapitalizimin e tyre, me qëllim ruajtjen e stabilitetit financiar, duke u fokusuar më shumë ndaj aktiveve të ponderuara sipas rrezikut. Megjithatë, duket se kjo marrëdhënie është jolineare. Pra, të qenit i kujdesshëm mbi një nivel të caktuar mund të bëhet i dëmshëm për kapitalizimin e bankave. Së fundmi, përshtatja dhe kapitalizimi i bankave sipas kërkesave rregullative paraqitet më i ndjeshëm tek bankat me kapital të ulët.

Një metodë e re alternative për matjen e sjelljes së kujdesshme të bankave sipas analizës së komponentit kryesor nxjerr në pah se ndryshimet e sjelljes bankare kanë qenë përgjithësisht të moderuara. Ndryshimet më të ndjeshme në sjelljen e kujdesshme të tyre janë të lidhura me luhatjet e (pa)sigurisë në mjedisin ekonomik. Gjatë periudhës para krizës financiare, bankat e mëdha u kanë kushtuar më shumë vëmendje çështjeve të lidhura me përqendrimin e sistemit, si dhe me likuiditetin e pozicionin e hapur neto. Ndërsa, bankat e vogla paraqiten më të fokusuara në provigjionimin e kredisë, si dhe në raportet e kapitalit e të përqendrimit. Në periudhën pas krizës financiare globale, karakteristikat e kësaj sjelljeje paraqiten më homogjene, ku bankat duken t'i kenë kushtuar vëmendje më të madhe provigjionimit dhe hendekut të maturimit. Së fundi, vërehet një rritje në vetëdijen e bankave për të qenë më të kujdesshme pas krizës financiare, sidomos pas krizës së borxhit grek.

Anketa e realizuar për vlerësimin e gjendjes financiare dhe huamarrëse të ndërmarrjeve mikroekonomike në sektorin bujqësor evidenton nivelin e ulët të përfshirjes financiare të këtij sektori, ku më pak se 20% e ndërmarrjeve pohojnë se janë mbështetur tek huaja si burim financimi.

Një studim me fokus në ndryshimet e shportës së konsumit të familjeve sugjeron se me rritjen e të ardhurave, individët tentojnë të rrisin më tepër shpenzimet për argëtim, transport dhe të mira luksi, dhe të reduktojnë raportin e shpenzimeve për ushqime dhe mallra të tjera jetike. Ndërkohë, rritja e çmimeve të administruara nuk e prek ndjeshëm përbërjen e shportës së shpenzimeve të familjeve.

Një tjetër studim me të dhëna mikro nga LSMS[1] tregon se konsumi i familjeve është i ndjeshëm ndaj ecurisë së të ardhurave dhe pasurisë së matur nga çmimi i banesave. Këto përfundime nxirren për katër percentile të ndryshme të të ardhurave të familjeve. Në linjë me pritjet teorike mikroekonomike, vlerësimet tregojnë se ndryshimet në konsum janë më të ndjeshme për familjet me nivel më të ulët të ardhurash, se sa për ato që ndodhen në percentilen e katërt të të ardhurave. Ndërkohë, po punohet për realizimin për herë të parë të një anketimi mbi të ardhurat, pasurinë reale dhe financiare, kredinë, punësimin, konsumin dhe përbërjen familjare, i cili do të sigurojë një standardizim dhe harmonizim të pyetësorit dhe metodologjisë së tij me pyetësorin e zhvilluar nga BQE-ja për vendet e Bashkimit Evropian.

Vrojtimi për matjen e nivelit të kulturës financiare të popullatës, i zhvilluar për herë të dytë nga Banka e Shqipërisë, sugjeron për vëmendje dhe përpjekje të vazhdueshme për edukimin financiar të publikut. Punimi analizon të dhënat e vitit 2015 në nivel vendi, si dhe krahason të dhënat me rezultatet e vrojtimit të vitit 2011, fokusuar në çështje që kanë të bëjnë me përfshirjen, njohuritë, sjelljet dhe qëndrimet financiare të individëve.

Përdorimi i indekseve Gini dhe Rawlsian për matjen e pabarazisë së familjeve shqiptare me të dhënat e anketës LSMS për periudhën 2002-2012, arrin në përfundimin se pabarazia është ulur si pasojë e efektit rishpërndarës mes familjeve me të ardhura më të larta, ndërkohë që magnituda e pabarazisë ka mbetur pothuajse konstante.

Punonjësit me arsim të lartë duket se janë mesatarisht më të mirëpaguar sesa ata me arsim të mesëm e të ulët. Ndërkaq, sipas analizës, profesionet e paguara nën mesatare duken të jenë: punonjësit e kualifikuar në sektorin e bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit; punonjësit e shitjeve dhe shërbimeve; si dhe ata në profesione elementare.

[1] *Anketa e matjes së nivelit të jetesës (Living Standard Measurement Survey), i publikuar nga INSTAT-i.*

2.11. INTEGRIMI EVROPIAN

Shqipëria ka vazhduar të zbatojë detyrimet e dala nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA) si dhe nga takimet e përbashkëta BE-Shqipëri. Në muajin nëntor 2016, Komisioni Evropian rekomandoi hapjen e kushtëzuar të negociatave për Shqipërinë, duke u bazuar në zhvillimin e zbatimit të reformës në drejtësi.

Banka e Shqipërisë ka vijuar të japë kontributin e saj në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, Raport Progreset e Komisionit Evropian, nënkomitetet e përbashkëta BE-Shqipëri, si dhe Plani

Kombëtar për Integrimin Evropian. Ajo koordinon dhe përgatit raportet përkatëse për kapitullin 4 "Lëvizja e lirë e kapitalit" dhe kapitullin 17 "Politika ekonomike dhe monetare". Nga ana tjetër, ajo është kontribuuese edhe në 6 kapituj të tjerë të *acquis* së Bashkimit Evropian.

Banka e Shqipërisë ka marrë pjesë në takimin e Komitetit të Stabilizim-Asociimit, si dhe në takimet e radhës të nënkomitetit për tregun e brendshëm dhe konkurrencën, si dhe për çështjet ekonomike, financiare dhe statistikat.

Në datën 17 prill 2018, Komisioni Evropian publikoi Raport Progresin për Shqipërinë. Ky dokument vlerëson progresin e bërë gjatë periudhës tetor 2016 deri në shkurt 2018, me një fokus të veçantë në drejtim të përmbushjes së pesë prioriteteve kyçe dhe kapitujve të tjerë të acquis.

Në këtë raport vlerësohet puna e Bankës së Shqipërisë në ruajtjen e stabilitetit të çmimeve dhe të stabilitetit financiar. Raporti nënvizon në veçanti përparimin e arritur në fushën e sistemit të pagesave, nëpërmjet ndryshimit të rregulloreve dhe zbatimit të strategjisë afatmesme të Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave. Gjithashtu, raporti nënvizon përmirësimin e proceseve të brendshme për forcimin e mbikëqyrjes së bankave dhe institucioneve financiare jobanka, duke aplikuar politikën e mbikëqyrjes së bazuar në risk. Banka e Shqipërisë ka vazhduar të harmonizojë më tej rregulloren bankare dhe manualin mbikëqyrës me Bazel II dhe Bazel III, me acquis relevante të BE-së. Shqipëria ka në fuqi një sistem identifikimi të bankave me rëndësi sistemike, të ngjashëm me praktikën e BE-së. Në fushën e politikës monetare, Banka e Shqipërisë ka vazhduar punën për përafrimin e ligjit të vitit 1997 "Për Bankën e Shqipërisë", me statutin e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore (ESCB), sipas kërkesave të acquis.

Në deklaratën e konkluzioneve të përbashkëta të dialogut ekonomik e financiar (maj 2018), Komisioni Evropian i rekomandon Bankës së Shqipërisë: të rrisë transparencën e politikës monetare, nëpërmjet publikimit të serive të inflacionit bazë dhe të pritjeve inflacioniste; vijimin e zbatimit të masave në planin kombëtar për uljen e kredive me probleme dhe zbatimin e masave, në përputhje me Memorandumin e Bashkëpunimit për zgjerimin e përdorimit të monedhës kombëtare në sistemin financiar dhe në ekonominë shqiptare.

Në zbatim të rekomandimit të parë, Banka e Shqipërisë publikoi seritë e inflacionit bazë dhe të pritjeve inflacioniste në faqen e vet të internetit, në janar 2019. Në përmbushje të planit ndërinstitucional për uljen e kredive me probleme, ajo ka punuar për hartimin e projektrregullores për adresimin jashtëgjyqësor të kredimarrësve, për përdorimin e pasqyrave financiare zyrtare në vlerësimin e rrezikut të kredisë së huamarrësve dhe për përmirësimin e Regjistrit të Kredive (për më shumë referoju nënkapitullit "Mbikëqyrja"). Gjithashtu, ajo ka miratuar paketën e masave rregullative të parashikuara në nismën për rritjen e përdorimit të monedhës kombëtare (nënkapitulli "Stabiliteti financiar").

2.12. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

MARRËDHËNIET ME FONDIN MONETAR NDËRKOMBËTAR

Republika e Shqipërisë vazhdon të qëndrojë në kuotën e 139.3 milionë SDR dhe zotëron 2.858 vota ose 0.06% të shumës së përgjithshme të votave të të gjithë anëtarëve të FMN-së. Ajo ndodhet në të njëjtën konstituencë me Italinë, Greqinë, Portugalinë, Maltën dhe San Marinon. Kjo konstituencë ka në total 207.948 vota ose rreth 4.13% të shumës së përgjithshme të votave të të gjithë anëtarëve të FMN-së. Shuma totale e akorduar dhe e lëvruar deri më tani është 295.42 milionë SDR (rreth 377.3 milionë euro).

Marrëdhëniet e Shqipërisë me Fondin Monetar Ndërkombëtar vijojnë të përqendrohen nën konsultimet e Artikullit IV, të cilat u përmbyllën në 20 nëntor nga Bordi Ekzekutiv i FMN-së.

Gjatë vitit 2018, Bankën e Shqipërisë e kanë vizituar disa misione të FMN-së për të ofruar asistencë teknike dhe konsultë në fusha të ndryshme si sistemi i pagesave, stabiliteti financiar, statistika, politika monetare, mbikëqyrja dhe kontabiliteti.

MARRËDHËNIET ME GRUPIN E BANKËS BOTËRORE

Grupi i Bankës Botërore mbështet Shqipërinë përmes Kuadrit të Partneritetit që mbulon periudhën 2015-2019, i cili synon të mbështesë aspiratat e Shqipërisë për të pasur rritje të barabartë dhe integrim në Bashkimin Evropian. Ndër vite, Grupi i Bankës Botërore ka ofruar mbi 2.2 miliardë dollarë asistencë për vendin. Aktualisht, numërohen 11 projekte me një total prej 718 milionë dollarësh kredi të IDA-s (35 milionë dollarë) dhe të IBRD-së (683 milionë dollarë).

Shqipëria bën pjesë në konstituencën e përbërë nga Greqia, Italia, Portugalia, Malta dhe Timori Lindor.

Në kuadër të programit "Për administrim dhe konsulencë në investimin e rezervës valutore" (RAMP), bashkëpunimi me Bankën Botërore ka vijuar me dhënien e asistencës teknike për vënien në zbatim të një modeli të integruar të rrezikut të kreditit dhe normës së interesit.

Përgjatë vitit 2018, Banka e Shqipërisë, me asistencën e Bankës Botërore, ka finalizuar një sërë projektesh ku mund të përmendim: studimin "Për matjen e kostove të instrumenteve të pagesave"; analizë e tregut shqiptar në lidhje me përfshirjen financiare të popullsisë nga pikëpamja e pagesave; si dhe analizën e tregut të remitancave. Bazuar në gjetjet e këtyre studimeve dhe analizave, Banka e Shqipërisë, e mbështetur dhe nga Banka Botërore, ka hartuar dhe miratuar "Strategjinë kombëtare për tregun e pagesave me vlerë të vogël (2018-2023)", në mbledhjen e katërt të Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave, të zhvilluar në muajin maj 2018.

Bashkëpunimi me Bankën Botërore ka vazhduar edhe në fushat e remitancave dhe pagesave, duke përfshirë ndërgjegjësimin dhe edukimin financiar, sistemet e pagesave, sistemet e shlyerjes së titujve, depozitarët qendrorë të titujve dhe kundërpartitë qendrore.

Për sa i përket rimëkëmbjes dhe ndërhyrjes së jashtëzakonshme, Banka e Shqipërisë ka vazhduar të përfitojë asistencën e Bankës Botërore për hartimin e akteve rregullatore, si dhe identifikimin e vlerësimin e funksioneve me rëndësi kritike.

MARRËDHËNIET ME INSTITUCIONET E TJERA NDËRKOMBËTARE

Përgjatë gjithë vitit 2018, Banka e Shqipërisë i ka kushtuar një vend të veçantë bashkëpunimit me bankat qendrore të Bashkimit Evropian. Më konkretisht, ky bashkëpunim është kanalizuar nëpërmjet pjesëmarrjes në Task Forcën e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore mbi Bashkëpunimin e Bankave Qendrore. Ky forum, ndër të tjera, i kushtohet edhe kooperimit teknik me vendet e Ballkanit Perëndimor, ku bën pjesë Shqipëria.

Më konkretisht, bankat e rajonit u njohën me projektin 2-vjeçar "Programi për forcimin e kapaciteteve të Bankave Qendrore në Ballkanin Perëndimor, me fokus integrimin në Sistemin Evropian të Bankave Qendrore". Projekti do të konsistojë në dy shtylla, ku komponenti i parë ka të bëjë me një seri trajnimesh nga ekspertët e bankave qendrore të SEBQ-së dhe BQE-së, ndërsa komponenti i dytë me bashkëpunimin dypalësh. Fushat në të cilat shtrihet ky projekt janë ato të mbikëqyrjes bankare, stabilitetit financiar, rimëkëmbjes dhe ndërhyrjes së jashtëzakonshme, politikës monetare, sistemeve të pagesave, statistikave, përputhshmërisë dhe integrimit në BE, politikave të qeverisjes, kontabilitetit dhe auditimit të brendshëm.

Gjatë vitit të kaluar ka vazhduar bashkëpunimi me Shkollën Ekonomike dhe të Shkencave Politike të Londrës (*London School of Economics and Political Science*). Në muajin nëntor u organizua konferenca vjetore me temë: "Politika monetare, integrimi ekonomik dhe normaliteti i ri".

Banka e Shqipërisë ka vijuar bashkëpunimin me FSVC-në, ku vlen të theksohet angazhimi i ekspertëve nga Bordi i Drejtorëve të FED-it në trajnimin e funksionarëve të Bankës së Shqipërisë, me qëllim përmirësimin dhe përditësimin e aftësive ekzekutive të drejtuesve të BSH-së.

Gjithashtu, gjatë vitit 2018 ka vazhduar bashkëpunimi në kuadër të mbështetjes nga ana e Sekretariatit për Çështjet Ekonomike të Shtetit Zviceran (SECO). Në qendër të këtij bashkëpunimi kanë qenë fusha të ndryshme si sistemi i pagesave, stabiliteti financiar, politika monetare dhe ajo kërkimore.

Banka e Shqipërisë ka vijuar të mbajë kontakte me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH). Ajo çka vlen të theksohet është diskutimi mbi

projektet potenciale mbi Bashkëpunimin Teknik të Bankës Qendrore në kuadër të reformave të reja të BERZH-it.

Pjesëmarrje në aktivitete ndërkombëtare si konferenca, forume e seminare
Më poshtë jepet një përmbledhje e aktiviteteve ndërkombëtare, ku titullarët e Bankës së Shqipërisë kanë marrë pjesë.

- Në datat 16-17 janar 2018, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, mori pjesë në Forumin për vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore në Vjenë, të organizuar nga Euromoney, Austri. Ky forum zhvillohet çdo vit dhe mbledh në një tryezë të përbashkët diskutimi personalitete të njohura ndërkombëtare nga fusha politike, ekonomike e financiare nga vendet e EQL-së.
- Më 13 prill 2018, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, mori pjesë në Konferencën e 7-të vjetore të Kërkimeve të organizuar nga Banka Kombëtare e Republikës së Maqedonisë, me temë "Rreth një dekadë pas krizës: drejt një cikli të ri global dhe normalizimit të politikës monetare", në Ohër, Maqedoni.
- Në datat 20-22 prill 2018, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, dhe Zëvendësguvernatorja e Parë, zj. Elisabeta Gjoni, morën pjesë në Mbledhjet e Pranverës të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe të Grupit të Bankës Botërore (BB), në Uashington.
- Në maj 2018, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, mori pjesë në Takimin e 39-të të Klubit të Guvernatorëve të bankave qendrore të vendeve të Azisë Qendrore, Rajonit të Detit të Zi dhe të Ballkanit.
- Në qershor 2018, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, mori pjesë në Samitin e vendeve të rajonit me temë ''Stabiliteti financiar dhe monetar në rajon, 10 vjet pas krizës financiare globale'', mbajtur në Becic, Mal i Zi.
- Në datat 20-21 shtator 2018, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, mori pjesë në takimin e 40-të të Klubit të Guvernatorëve të vendeve të Azisë Qendrore, Rajonit të Detit të Zi dhe Ballkanit. I zhvilluar në Bukuresht, Rumani, në të merrnin pjesë drejtuesit e bankave qendrore të vendeve anëtare të Klubit.
- Në datat 12-14 tetor 2018, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, në cilësinë e Guvernatorit të Republikës së Shqipërisë në FMN, mori pjesë në Mbledhjet Vjetore të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe të Grupit të Bankës Botërore (BB), të cilat u zhvilluan në Bali, Indonezi. Këto mbledhje përfaqësojnë një forum të nivelit të lartë, ku mblidhen për të diskutuar së bashku, mbi zhvillimet më të fundit të ekonomisë botërore, vendimmarrësit më të lartë të FMN-së dhe BB-së, së bashku me guvernatorët dhe ministrat e financave të vendeve anëtare të këtyre institucioneve ndërkombëtare financiare.

MEMORANDUME BASHKËPUNIMI

- Shqipëria nënshkroi me BERZH-in një memorandum për nxitjen e kreditimit në lekë dhe zhvillimin e tregut të kapitalit. Më 26 shkurt

2018, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, nënshkroi, në emër të Bankës së Shqipërisë, memorandumin e mirëkuptimit për nxitjen e bashkëpunimit për përdorimin e monedhës kombëtare dhe zhvillimin e tregut lokal të kapitalit në Shqipëri, midis Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

– Rinovimi i marrëveshjes SWAP midis Bankës së Shqipërisë dhe Bankës Qendrore të Republikës Popullore të Kinës. Më 3 prill 2018, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, dhe Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës Popullore të Kinës, z. Yi Gang, nënshkruan rinovimin e marrëveshjes dypalëshe SWAP për monedhat përkatëse, në shumën maksimale 2 miliardë yuan ose 34.2 miliardë lekë. Marrëveshja e re, sikurse ajo paraardhëse, është e vlefshme për një kohëzgjatje trevjeçare, e cila fillon nga data e nënshkrimit të saj.
– Zëvendësguvernatorja e Dytë e Bankës së Shqipërisë, zj. Natasha Ahmetaj, dhe Kryetarja e Bordit të Përbashkët të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme (Single Resolution Board - SRB), zj. Elke König, nënshkruan marrëveshjen dypalëshe për shkëmbimin e informacionit dhe bashkëpunimin në fushën e hartimit të Planeve të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, si dhe zbatimin e këtij planifikimi në lidhje me subjektet bankare ndërkufitare, që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë dhe anasjelltas.
– Në datë 23 nëntor 2018, u nënshkrua Memorandumi i Bashkëpunimit mes Bankës se Shqipërisë dhe Bankës Qendrore Evropiane (BQE). Në emër të BQE-së, memorandumi u nënshkrua nga Presidentja e Bordit Mbikëqyrës, zj. Danièle Nouy, dhe nga Zëvendëspresidentja e Bordit Mbikëqyrës, zj. Sabine Alice Lautenschläger. Në emër të Bankës së Shqipërisë, memorandumi u nënshkrua nga Guvernatori, z. Gent Sejko, dhe nga Drejtori i Departamentit të Mbikëqyrjes, z. Deniz Deralla. Nënshkrimi i këtij Memorandumi formalizon mekanizmat e bashkëpunimit dhe ndarjes së informacionit ndërmjet BQE-së dhe Bankës së Shqipërisë. Ky bashkëpunim është themelor për të siguruar një mbikëqyrje efektive dhe gjithëpërfshirëse të subjekteve nën juridiksionin e secilit prej autoriteteve të mësipërme.

2.13. TRANSPARENCA DHE KOMUNIKIMI ME PUBLIKUN

Komunikimi me publikun përbën një hallkë të rëndësishme në aktivitetin e Bankës së Shqipërisë, si në përmbushjen e detyrimit për të ofruar transparencë maksimale të vendimmarrjes dhe efektivitetit të saj, ashtu edhe për arritjen e objektivit të përhershëm të rritjes së besueshmërisë së këtij institucioni qendror. Në këtë kuadër, Banka e Shqipërisë e vlerëson komunikimin ndërveprues me publikun si një çështje parësore dhe me rëndësi strategjike, për të transmetuar tek opinioni publik, sa më drejt dhe kuptueshëm, politikën monetare të zbatuar prej saj.

NJË BANKË QENDRORE E HAPUR DHE TRANSPARENTE

Përtej detyrimeve ligjore, Banka e Shqipërisë i komunikon publikut një informacion të shumëllojshëm lidhur me rolin dhe veprimtarinë, nga vendimmarrja e Këshillit Mbikëqyrës deri te aktiviteti operacional i përditshëm i saj. Ky komunikim transparent ndihmon në rritjen e efektivitetit të politikave të ndjekura nga Banka e Shqipërisë, duke bërë që publiku të kuptojë, në kohë dhe si duhet, vendimet e marra prej saj dhe t'i vlerësojë drejt ato.

Banka e Shqipërisë përdor një sërë kanalesh komunikimi me qëllim shpjegimin sa më qartë të rolit, objektivit kryesor të saj - ruajtjes së stabilitetit të çmimeve - si dhe të mënyrës së përmbushjes së tij.

Strategjia e politikës monetare bazohet në një cikël vendimmarrjeje të përcaktuar në një kalendar vjetor prej 8 mbledhjesh të Këshillit Mbikëqyrës. Pas çdo mbledhjeje, zhvillohet konferenca për shtyp e Guvernatorit, i cili i shpjegon publikut vendimin e marrë nga Këshilli Mbikëqyrës dhe analizën e përdorur në mbështetje të këtij vendimi. Në përgjigje të këtij cikli, gjatë vitit 2018, u organizuan konferencat përkatëse për shtyp, gjatë të cilave Guvernatori i është përgjigjur edhe interesit të medias për çështje të ndryshme të lidhura me Bankën e Shqipërisë. Konferencat për shtyp janë shoqëruar me publikimin e fjalimeve të Guvernatorit dhe të zbardhjes së pyetje-përgjigjeve përkatëse, në gjuhën shqipe dhe angleze.

Gjithashtu, gjatë vitit 2018, pas çdo mbledhjeje vijoi publikimi i një përmbledhjeje të shkurtër me vendimet kryesore të marra nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë. Të gjitha vendimet publike të Këshillit Mbikëqyrës, si dhe urdhrat ose aktet e administratorëve, të zbatueshme nga subjektet e licencuara nga Banka e Shqipërisë, u botuan të plota në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë, në 6 numra të këtij botimi.

Komunikimi i Bankës së Shqipërisë plotësohet më tej, në mënyrë të vazhdueshme dhe në kohë reale, me një sërë raportesh periodike, vrojtimesh, analizash, të dhënash, vlerësimesh e opinionesh të Bankës së Shqipërisë, mbi gjendjen makroekonomike të vendit dhe rolin e Bankës në mbështetje të stabilitetit financiar.

Komunikimi me publikun i përgjigjet interesit, nivelit akademik dhe formimit profesional të grupeve të targetuara të Bankës së Shqipërisë, ndër të cilat një vend të rëndësishëm zë dhe media. Në këtë kuadër, media informohet dhe sensibilizohet në vazhdimësi mbi çështje që lidhen si me Bankën e Shqipërisë, ashtu edhe me ecurinë ekonomike dhe financiare të vendit. Komunikimi me median ka vijuar nëpërmjet konferencave për shtyp, fjalimeve, prezantimeve dhe kumtesave të mbajtura në aktivitete të organizuara nga Banka e Shqipërisë apo institucione të tjera vendase dhe të huaja, intervistave të dedikuara apo pjesëmarrjes në emisione televizive, shprehjes së qëndrimeve për çështje specifike me interes për Bankën e Shqipërisë apo aktiviteteve të tjera publike të Guvernatorit dhe përfaqësuesve të tjerë të saj. Gjatë vitit 2018, veprimtaria

e Bankës së Shqipërisë i është komunikuar publikut, kryesisht nëpërmjet 130 njoftimeve e deklaratave për shtyp, fjalimeve, intervistave e pjesëmarrjesh në emisione televizive. Ndërkohë që janë zhvilluar edhe 7 prezantime "*off the records*" të raporteve të saj periodike. Këto takime synojnë orientimin e medias në leximin e drejtë të vendimmarrjes së Bankës së Shqipërisë dhe vlerësohen si një mjet mjaft efikas komunikimi.

Për të rritur ndërveprimin me publikun, gjatë vitit 2018 kemi vazhduar komunikimin dixhital nëpërmjet rrjeteve sociale Twitter (informacion), Facebook (edukim financiar) YouTube (video) dhe Flickr (foto), duke transmetuar aktivitetin e përgjithshëm të Bankës së Shqipërisë tek opinioni publik, në një kohë sa më të shpejtë dhe në mënyrë të plotë.

HAPËSIRË INFORMUESE 12: AKTIVITETE TË DREJTUESVE TË BANKËS SË SHQIPËRISË

- *Në datën 13 shkurt 2018, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, priti në një vizitë zyrtare në ambientet e Bankës së Shqipërisë, Zëvendësdrejtorin e Përgjithshëm të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), z. Tao Zhang. Gjatë takimit, Guvernatori Sejko vlerësoi marrëdhëniet mjaft të mira të bashkëpunimit me Fondin, i cili ka mbështetur reformat ekonomike dhe financiare të vendit. Zëvendësdrejtori Zhang vlerësoi se politikat e ndërmarra nga Banka e Shqipërisë kanë kontribuuar në ruajtjen e stabilitetit makroekonomik dhe konsolidimin e sistemit financiar të vendit.*

- *Në datën 21 mars 2018, u prezantua Projekti Greenback 2.0 për Shqipërinë, si vend pritës i remitancave. Si një ndër komponentët e Programit të Remitancave dhe Pagesave (PRP) në Shqipëri, financuar nga Sekretariati i Shtetit Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO), ky projekt është një iniciativë e Bankës Botërore për promovimin e kanaleve të aksesueshme dhe instrumenteve të pagesave me kosto efektive për dërgimin dhe marrjen e remitancave. Banka Botërore dhe Banka e Shqipërisë kanë zgjedhur Beratin, si qytet kampion për zbatimin e projektit Greenback 2.0.*

- *Komiteti Kombëtar i Sistemeve të Pagesave zhvilloi mbledhjen e tij të katërt në datën 20 maj 2018, drejtuar nga Zëvendësguvernatorja e Parë e Bankës së Shqipërisë, zj. Elisabeta Gjoni, njëkohësisht edhe Kryetare e këtij Komiteti. Qëllimi i komitetit është të mbështesë dhe të kontribuuojë në rritjen e sigurisë, qëndrueshmërisë dhe efikasitetit të sistemit kombëtar të pagesave në Shqipëri. Përtej rolit këshillues, Komiteti synon të lehtësojë procesin e implementimit të masave të marra nga autoritetet përkatëse, përmes nxitjes së bashkëveprimit. Në këtë mbledhje, Komiteti miratoi strategjinë "Për zhvillimin e pagesave me vlerë të vogël" dhe paraqiti projektet e realizuara në kuadër të modernizimit të sistemeve të pagesave.*

- *Në datat 13-14 qershor 2018, Banka e Shqipërisë dhe Banka Qendrore Evropiane (BQE) organizuan seminarin rajonal në fushën e statistikave të bankës qendrore. Ky seminar organizohet rregullisht nga BQE-ja me një*

bankë qendrore dhe siguron një forum të rëndësishëm për shkëmbimin e pikëpamjeve mbi kërkesat statistikore, hartimin e politikave dhe diskutimin e risive më të fundit në çështjet statistikore të bankingut qendror. Qëllimi i tij është realizimi i diskutimeve dhe këmbimi i këndvështrimeve mbi statistikat, si një nga çështjet më sfiduese dhe themelore për bankierët qendrorë dhe politikëbërësit në përgjithësi.

- *Në datën 21 qershor 2018, nën drejtimin e Zëvendësguvernatores së Parë, zj. Elisabeta Gjoni, Banka e Shqipërisë zhvilloi konferencën me temë "Modernizimi i sistemeve të pagesave me vlerë të vogël". Në konferencë, pjesëmarrës ishin përfaqësues nga Banka Botërore, Banka Qendrore Evropiane, bankat qendrore të rajonit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Shoqata Shqiptare e Bankave dhe përfaqësues nga komuniteti i biznesit. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte përcjellja e qartë e objektivave të synuar, në kuadër të reformimit të tregut të sistemeve të pagesave me vlerë të vogël, te të gjithë aktorët e tregut, të cilët janë partnerë për arritjen e këtyre objektivave.*

- *Në datën 10 korrik 2018, Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim me Bankën Botërore, organizoi workshop-in me temë "Financat për rritje ekonomike". Workshop-i u përqendrua në prezantimin e studimit të Bankës Botërore "Aksesi në financim për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme". Në bazë të këtij studimi, Banka Botërore ka hartuar një raport të hollësishëm diagnostikimi dhe rekomandimesh, mbi mjedisin ekonomik ku zhvillojnë aktivitet ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme në Shqipëri.*

- *Në datën 1 nëntor 2018, nën drejtimin e Guvernatorit Sejko, Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim me Shkollën Ekonomike dhe të Shkencave Politike të Londrës (London School of Economics and Political Science), organizoi konferencën vjetore me temë "Politika monetare, integrimi ekonomik dhe "Normaliteti i ri". Punimet e konferencës u hapën me fjalët përshëndetëse të Guvernatorit Sejko; Drejtorit të Institutit për Çështjet Globale në Shkollën Ekonomike dhe të Shkencave Politike të Londrës, z. Erik Berglof; Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, z. Arben Ahmetaj; dhe Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, z. Edi Rama. Paneli përmbyllës i konferencës, ai i guvernatorëve, mblodhi në një tryezë të përbashkët diskutimi, guvernatorët dhe zëvendësguvernatorët e Bankës së Shqipërisë, Islandës, Kosovës, Bosnje-Hercegovinës dhe Kroacisë.*

- *Në datën 15 nëntor 2018, nën drejtimin e Zëvendësguvernatores së Dytë, zj. Natasha Ahmetaj, Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim me Qendrën FinSAC (Financial Sector Advisory Center) të Bankës Botërore, organizuan Konferencën Rajonale me temë "Planifikimi i rimëkëmbjes dhe ndërhyrjes së jashtëzakonshme", me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të autoriteteve mbikëqyrëse dhe të ndërhyrjes së jashtëzakonshme të Bashkimit Evropian, të vendeve të rajonit dhe të bankave tregtare të vendit tonë. Kjo konferencë kulmoi punën e 18 muajve të fundit të Bankës së Shqipërisë, drejt zhvillimit të një kuadri të plotë për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në sektorin bankar.*

- *Në datat 6-7 dhjetor 2018, Banka e Shqipërisë organizoi workshop-in e 12-të të Kërkimeve Ekonomike për Evropën Juglindore. Ky aktivitet synon të ofrojë një forum diskutimi të punëve kërkimore inovative mbi çështje të lidhura me bankingun qendror dhe të nxisë shkëmbimin e pikëpamjeve*

midis kërkuesve të Bankës së Shqipërisë, bankave qendrore simotra, akademisë dhe institucioneve të tjera kërkimore.

- *Në datën 14 dhjetor 2018, u zhvillua takimi i dytë i nivelit të lartë midis Bankës së Shqipërisë, Ministrit të Shtetit për Diasporën, bankave tregtare dhe subjekteve financiare jobanka të angazhuara në fushën e transfertave monetare që operojnë në vendin tonë. Takimi u mbajt në kuadër të Memorandumit të Mirëkuptimit "Për remitancat", të nënshkruar vitin e kaluar nga Banka e Shqipërisë, Ministri i Shtetit për Diasporën dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë.*

- *Në datën 20 dhjetor 2018, me rastin e mbylljes së vitit, Guvernatori Sejko zhvilloi një takim me publicistë, analistë të politikës dhe të ekonomisë, gazetarë të shtypit të shkruar e medias elektronike. Gjatë këtij aktiviteti, u ndanë dhe tre çmimet e konkursit të përvitshëm "Çmimi i Guvernatorit për Diplomën më të Mirë për vitin 2018": çmimi i parë për zj. Migena Musli, studente në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë; çmimi i dytë për z. Donald Vullnetari, student në Universitetin e Tiranës; dhe çmimi i tretë për z. Klisman Ndoje, student në Universitetin Libre de Bruxelles. Ky konkurs organizohet çdo vit nga Banka e Shqipërisë dhe i dedikohet studentëve shqiptarë të diplomuar gjatë periudhës, brenda dhe jashtë vendit, për punë kërkimore-shkencore në çështje të lidhura me ekonomiksin monetar e ndërkombëtar, stabilitetin e çmimeve dhe atë financiar, integrimin ekonomik etj.*

NJË BANKË QENDRORE E PËRGJEGJSHME DHE LLOGARIDHËNËSE

Banka e Shqipërisë e konsideron transparencën si një detyrim dhe instrument për rritjen e pavarësisë.

Marrëdhëniet institucionale me Kuvendin e Shqipërisë zhvillohen në disa drejtime, ku vend të rëndësishëm zënë seancat dëgjimore të Guvernatorit në Komisionin Parlamentar të Ekonomisë dhe Financave (KEF) dhe seancat plenare të Kuvendit. Në muajin maj 2018, Guvernatori prezantoi Raportin Vjetor të Bankës së Shqipërisë në KEF dhe më pas në Kuvendin e Shqipërisë, duke iu përgjigjur interesit të deputetëve për çështje të lidhura me të. Si çdo vit, Guvernatori prezantoi në muajin nëntor, në një seancë dëgjimore të dedikuar të KEF-it, opinionin e Bankës së Shqipërisë për projektbuxhetin e shtetit për vitin pasardhës.

Qytetarët mund të gjejnë informacion të plotë dhe të përditësuar mbi gjendjen ekonomiko-financiare dhe zhvillimet kryesore makroekonomike të vendit, si dhe rolin e kontributin e Bankës së Shqipërisë në këtë drejtim, në faqen zyrtare të internetit: www.bankofalbania.org.

Gjatë vitit 2018, Banka e Shqipërisë prezantoi faqen e re të internetit me qëllim përcjelljen sa më qartë të filozofisë së saj të komunikimit dhe përshtatjen me sjelljen gjithnjë në ndryshim të përdoruesve dixhitalë. Duke qenë se faqja e internetit përfaqëson një nga mjetet kryesore të komunikimit, Banka e Shqipërisë

i kushtoi rëndësi të veçantë cilësisë, paraqitjes vizuale dhe lehtësisë në përdorim të saj. Faqja e re u rikonceptua me një dizajn të ri, modern e tërheqës, duke lehtësuar shfletimin nga publiku. Me publikimin e faqes së re, Banka e Shqipërisë përmbushi një nga objektivat kryesorë të strategjisë afatmesme të zhvillimit për periudhën 2018-2020, që synon rritjen e transparencës mbi veprimtarinë e saj përmes një komunikimi të hapur me publikun. Gjatë këtij viti, faqja e internetit pati rreth 910 mijë vizitorë, të cilët e vizituan faqen tonë rreth 3 milionë herë dhe shfletuan në total rreth 5.6 milionë rubrika.

Kjo faqe ofron të gjitha botimet e Bankës së Shqipërisë, të cilat përmbledhin informacion të përditësuar mbi ekonominë shqiptare dhe atë botërore; mbi zhvillimet në sistemin bankar dhe atë financiar; stabilitetin financiar e paranë; ndryshimet e pasurimet e legjislacionit bankar dhe të kuadrit të tij rregullator; si dhe mbi çështje të tjera, duke u konsoliduar kështu si burim informacionesh të sakta dhe të besueshme për publikun.

Botimet e realizuara gjatë vitit 2018 janë, si çdo vit, periodike e joperiodike, dhe numërojnë rreth 5700 faqe analiza, statistika dhe studime në gjuhën shqipe dhe atë angleze, që përfaqëson edhe numrin më të lartë të faqeve të botuara nga Banka e Shqipërisë në dekadën e fundit. Seti i raporteve periodike edhe gjatë këtij viti ka ruajtur të njëjtën strukturë: Raporti Vjetor (vjetor), Raporti i Politikës Monetare (tremujor), Raporti i Stabilitetit Financiar (gjashtëmujor) dhe Raporti i Mbikëqyrjes (vjetor). Përveç raporteve periodike, kjo gamë pasurohet më tej me Buletinin Zyrtar (në varësi të mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës), Revistën "Bankingu Qendror" (gjashtëmujore), Revistën Ekonomike (gjashtëmujore), revistën "Të reja shkencore në Bankën e Shqipërisë" (gjashtëmujore), Librin e Konferencës Vjetore Shkencore 2017 "Zhvillimet në tregun bankar dhe infrastruktura e tregjeve financiare. Roli i strukturës, madhësisë dhe infrastrukturës së tregjeve në zbutjen e rreziqeve dhe ecurinë e ndërmjetësimit financiar", Librin e Konferencës I të Muzeut "Paraja dhe bankingu në Shqipëri, nga antikiteti në ditët tona", Librin e Konferencës BSH-FMN "Normat negative të interesit në Eurozonë dhe ndikimi i tyre në politikat dhe instrumentet e bankave qendrore të vendeve të Ballkanit Perëndimor", botimin "Remitancat: Një mbështetje për zhvillim", broshurën "25 vite banking qendror modern: shifra dhe fakte", si dhe materiale të ndryshme studimore dhe edukative.

Gjatë vitit 2018, Banka e Shqipërisë ka vijuar politikën e shpërndarjes falas të botimeve të saj, duke pasur në konsideratë edhe përqasjen në fushën e përgjegjshmërisë sociale të reduktimit të botimeve në letër.

Në funksion të informimit të publikut, Banka e Shqipërisë i përgjigjet edhe kërkesave të shumta për informacion të qytetarëve në formë të shkruar ose në formë elektronike, në varësi të përzgjedhjes së tyre. Gjatë vitit 2018, kanë marrë përgjigje 101 kërkesa zyrtare drejtuar koordinatorit për të drejtën e informimit, rreth 164 email-e drejtuar adresës elektronike të përgjithshme të Bankës së Shqipërisë dhe rreth 300 mesazhe me kërkesa për informacion ardhur në faqen tonë në Facebook.

2.14. EDUKIMI FINANCIAR DHE MUZEU I BANKËS SË SHQIPËRISË

Bankat qendrore i kushtojnë vëmendje dhe burime të veçanta edukimit financiar dhe ekonomik të publikut. Kjo për arsye se një publik i informuar ka më shumë mundësi të kuptojë dhe të pranojë vendimet komplekse që Banka qendrore merr. Prej mëse një dhjetëvjeçari, Banka e Shqipërisë është angazhuar në zgjerimin dhe thellimin e kulturës financiare të publikut në vend, e veçanërisht të brezit të ri. Programet, aktivitetet dhe botimet e veçanta edukative të përgatitura nga Banka e Shqipërisë në këtë drejtim, kanë dy objektiva kryesorë: prezantimin e rolit dhe funksioneve të Bankës Qendrore tek publiku dhe kultivimin e përforcimin e një kulture financiare në shoqërinë shqiptare. Në përmbushje të objektivit të rritjes së kulturës financiare në vend, gjatë vitit 2018, ka vijuar puna për edukimin e publikut në disa forma.

- **Botimet edukative.** Gjatë vitit 2018, ka vijuar shpërndarja e teksteve mësimore "Financat personale në duart tuaja" për 6 shkolla të mesme të vendit që kanë zgjedhur ta zhvillojnë lëndën (gjithsej 820 nxënës). Nga ana tjetër, ka vijuar shpërndarja e broshurave dhe materialeve edukative të përgatitura në vitet paraardhëse.
- **Java e Parasë.** Në datën 12 mars 2018, në ambientet e Bankës së Shqipërisë, u çel Java e Parasë për vitin 2018 nën sloganin "Paraja: Ç'të mbjellësh, do të korrësh!". Banka e Shqipërisë mori pjesë për herë të pestë në këtë kremtim, në bashkëpunim me Shoqatën Shqiptare të Bankave dhe me mbështetjen e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, dhe Agjencisë së Sigurimit të Depozitave. Përgjatë javës u organizuan aktivitete edukative dhe ndërgjegjësuese të shumta, duke përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë rreth 5000 fëmijë dhe të rinj, përfaqësues të rreth 55 shkollave 9-vjeçare, 14 shkollave të mesme, 8 universiteteve në 14 qytete. Aktivitetet e organizuara përfshinë: konkurse shkollore, leksione në auditoret e universiteteve dhe në qendra rinore, vizita të nxënësve në Muzeun e Bankës së Shqipërisë dhe në banka tregtare.
- **Faqja e Bankës së Shqipërisë në Facebook.** E krijuar në vitin 2014, me qëllim nxitjen dhe kultivimin e një kulture financiare, faqja e Bankës së Shqipërisë në Facebook, ka shërbyer si një tjetër mënyrë për t'iu afruar publikut, kryesisht atij më të ri në moshë. Gjatë vitit 2018, janë publikuar rreth 70 postime për ta njohur publikun me materiale edukative, kuriozitete numizmatike, aktivitetet dhe botimet e Bankës.
- **Analiza e kulturës financiare në Shqipëri.** Gjatë vitit 2018, Banka e Shqipërisë prezantoi analizën e vrojtimit mbi "Matjen e kulturës financiare: Rezultatet për Shqipërinë, 2015", në *Workshop*-in XII të Kërkimeve për Evropën Juglindore. Kjo analizë e përgjithshme e rezultateve të vrojtimit, përbën një instrument të rëndësishëm në identifikimin e çështjeve që kanë nevojë për vëmendje dhe formulimin e strategjisë e politikave të edukimit të publikut.

MUZEU I BANKËS SË SHQIPËRISË

Që prej tetorit 2015, Muzeu i Bankës së Shqipërisë ka shërbyer si një urë lidhëse mes Bankës dhe publikut. Ekspozitat dhe informacionet e tij ofrojnë për publikun njohuri numizmatike dhe historike, si dhe koncepte të edukimit financiar. Gjatë vitit 2018, Muzeu i Bankës së Shqipërisë është vizituar nga 3100 individë, ndër të cilët 1700 qenë fëmijë e nxënës dhe 1400 të rritur mbi moshën 18 vjeç.

Çdo vit, Muzeu i Bankës së Shqipërisë organizon aktivitete me qëllim tërheqjen e vizitorëve të rinj dhe rritjen e bashkëpunimit me studiues, akademikë, muze të ngjashëm dhe jo vetëm, si dhe me institucionet e specializuara në kërkimet ekonomike, historike dhe të trashëgimisë kulturore. Për vitin 2018, Muzeu zhvilloi një sërë aktivitetesh me karakter historik dhe edukativ, të përmbledhura më poshtë.

- **Ekspozita e përkohshme "Gjergj Kastrioti Skënderbeu në monedhën dhe kartëmonedhën shqiptare", 17 janar 2018.** Muzeu i Bankës së Shqipërisë, në përkujtim të 550-vjetorit të vdekjes së Heroit Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeut dhe Vitit Mbarëkombëtar kushtuar tij, çeli ekspozitën e përkohshme "Gjergj Kastrioti Skënderbeu në monedhën dhe kartëmonedhën shqiptare", e cila prezantoi figurën e heroit të pasqyruar në monedhën dhe kartëmonedhën shqiptare, prej vitit 1921 deri në vitin 1996, si dhe elemente të ndryshme të shtypit të këtyre prerjeve. Ajo qëndroi e hapur gjatë gjithë vitit 2018.
- **Cikli i leksioneve "Netët e Muzeut".** Qëllimi i ciklit me leksione "Netët e Muzeut" është bashkërendimi dhe integrimi i njohurive mbi monedhën në ekspozitën e Muzeut të Bankës së Shqipërisë me informacionin e gjendur në arkiva, biblioteka, koleksione private apo edhe atë të shfaqur përmes arkitekturës, skulpturës, arteve vizive dhe fotove të muzeve të tjera të vendit. Leksionet vijojnë me vizita të Muzeut. Për vitin 2018 u zhvilluan 2 leksione. Më 2 mars 2018, mjeku dhe filatelisti Prof. dr. Jovan Basho mbajti leksionin me temë "Gjergj Kastrioti Skënderbeu në pullën shqiptare". Më 17 prill, Dr. Dorian Koçi, Drejtor i Muzeut Historik Kombëtar, mbajti leksionin me temë "Marrëdhëniet financiare të Ali Pashë Tepelenës".
- **Seminari njëjavor "Monedhat antike që nga shfaqja e tyre (fillimi i shek. VII p.e.s.) deri në fundin e Perandorisë Romake (fundi i shek. V e.s.)", 30 prill - 7 maj 2018.** Seminari u drejtua nga Dr. Albana Meta, numizmate pranë Institutit të Arkeologjisë. Në këtë seminar morën pjesë rreth 30 persona, përfshirë studiues, koleksionistë dhe studentë të Universitetit të Tiranës, të cilët u pajisën me certifikata pjesëmarrjeje.
- **Dita Ndërkombëtare e Muzeve, 18 maj 2018.** Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Muzeve, Muzeu i Bankës së Shqipërisë qëndroi i hapur në datën 18 maj, nga ora 9:00 deri në 20:00.
- **Ekspozita e përkohshme "Gjergj Kastrioti Skënderbeu në monedhën dhe kartëmonedhën shqiptare" në Prizren, Kosovë, 10 – 12 qershor 2018.** Banka e Shqipërisë, e organizoi këtë ekspozitë në bashkëpunim

me Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, në kuadër të Vitit Mbarëkombëtar të Gjergj Kastrioti Skënderbeut. Ekspozita u çel në mjediset e Ndërtesës së Lidhjes së Prizrenit, më datë 10 qershor 2018, datë kjo që përkon me përvjetorin e 140-të të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

- **Konferenca II e Muzeut të Bankës së Shqipërisë me temë "Roli i parasë gjatë luftërave", 20 shtator 2018.** Konferenca II e Muzeut të Bankës së Shqipërisë mblodhi së bashku historianë, numizmatë, arkeologë, studiues të historisë monetare e ekonomike, kërkues me përvojë por dhe të rinj, vendas e të huaj, për të prezantuar e diskutuar gjetjet e studimeve të tyre për rolin që ka luajtur paraja përgjatë zhvillimit të luftërave dhe anasjelltas ndër shekuj. Konferenca u organizua në sesione të dedikuara, duke nisur nga periudha e lashtësisë deri në atë bashkëkohore.
- **Ekspozita e përkohshme "80-vjetori i ndërtesës së Bankës së Shqipërisë", 30 tetor 2018.** Më 30 tetor 2018, u çel ekspozita e përkohshme me temë "80-vjetori i ndërtesës së Bankës së Shqipërisë, 1938-2018". Ekspozita përmbante fotografi dhe skica të ndërtesës qendrore të Bankës së Shqipërisë në Tiranë dhe të ndërtesave të ish-degëve të saj në Durrës, Shkodër, Korçë, Vlorë, Sarandë e Elbasan.